

HEJZA

Rexhep Shahu, shkrimtar

**SHUMË NJERËZ SHALOJNË GOMARIN E NA
OFROHEN SI KALORËS**

Nën thjerrë

PËR POLITIKAT KULTURORE DUHET TË VENDOSIN VETËM ARTISTËT DHE KRIJUESIT

Subjektet politike shqiptare duhet ta kenë të qartë se pa një bazë të fortë infrastrukturore dhe mbështetje financiare në kulturë, gjithnjë do të ngulfatemi në antivlerë dhe në akulturimin e shoqërisë sonë shqiptare



Nga Avni HALIMI

Favorizimet kulturore janë dukuri që shprehen si pasojë e urdhrave politiko-partiake dhe të njëjtat mund të përjetojnë në Shqipëri dhe në Kosovë, pra, në shtetet që drejtohen nga qeveritë shqiptare. Ministria e Kulturës, përveç që ka obligim të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve nëpër institucionet kombëtare kulturore, është e obliguar që në programin e vet nacional vjetor të përfshijë edhe organizata e shoqata që merren me aktivitete kulturore. Pa dyshim, edhe kulturën e kemi komercializuar deri në përmasa të "firmave fitimprurëse" dhe, fatkeqësisht, për këtë poshtërsi përkujdesen partitë tona, pastaj individë nga legjislativi dhe ekzekutivi kombëtar, të cilët gjejnë mënyra se si t'u dalin nga borxhi militantëve dhe përkrahësve të vetë! Le të formohen sa më shumë shoqata e organizata, nga të gjitha fushat e kulturës se, fonde ka mjaftueshëm për të gjithë! Kjo është logjika e diletantëve dhe snobëve që nuk dinë se si të dëshmojnë si "intelektuale" dhe "akademike" të kombit! Jo gjithnjë ndahen të kënaqur të gjithë! Që të gjitha organizatat dhe shoqatat varen nga koalicionet qeveritare! Në të dyja shtetet tona, ministritë gjegjëse gjenden edhe nën presionin partiak të strukturave të ndryshme të pushtetit, por edhe nën presionin e favorizimeve të udhëheqësve (por edhe komisioneve!) të dikastereve përkatëse. Si rrjedhojë e këtyre qëndrimeve imorale në raport me jetën kulturore, kemi subjekte e persona të favorizuar dhe, të tjerët "të diskriminuar"! Këtu kemi ankesa e "protesta" nga ata që ngelin jashtë sferës së favorizimeve si pasojë e pozicionimit opozitar dhe, në raste të tilla, absolutisht nuk kemi kurrfarë "diskriminimi"! Jeta kulturore institucionale është në nivel dhe, përtej mundësive, subvencionohen

edhe dy-tri e më shumë ansamble, shoqata, organizata, botues etj! Për ta kuptuar diskriminimin kulturor, mjafton që të hidhet një sy në viset e tjera etnike, te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, të Luginës së Preshevës e të Malit të Zi! Çuditërisht, edhe nga këto vise shpesh kemi dëgjuar "për diskriminime kulturore", të cilat nuk vijnë nga subjektet politike, nuk vijnë nga institucionet dhe asociacionet që e llogarisin veten si bartës të jetës kulturore shqiptare. Fatkeqësisht, konstatime të tilla faktike vijnë nga individë që përfaqësojnë një shtëpi botuese, nga ndonjë "ansambël", nga ndonjë shoqatë jo-fitimprurëse, nga ndonjë artist që, thjesht, kanë ngelur jashtë "tavolinës së kekut" kulturor! Të tjerët që kanë marrë ndonjë kockë sa për ta lëpirë, ndahen të kënaqur me politikën nacionale kulturore si të dikasterit gjegjëse të qeverisë maqedonase, ashtu edhe të dikasterit kulturor qeveritar serb e malazës! Të pakënaqurit, nëse subvencionohen pas ndonjë ankese eventuale për diskriminim kulturor, shumë shpejt e harrojnë këtë shprehje që absolutisht duhet të jetë dukuri që brengos e jo vetë një fjalë goje!

Kjo lojë e ndytë e "artdashësve" dhe "kulturodashësve" si dhe mungesa e politikave të qarta kulturore që do të duhej të ishin diga të pakalueshme përgjatë formimit të koalicioneve qeveritare, na bëjnë të dukemi jo seriozë, qarramanë dhe politikisht të papjekur e të pangritur. Të hamë tortën e "Korridorit 8" e ta heshtim dhe ta fusim nën cergë tortën e turpit të gatuar me inferioritetin dhe diletantizmin tonë karshi jetës institucionale kulturore kjo flet për një primitivizëm të llojit të vetë! Pa dyshim, botës i duhen korridore e autostrada, por shqiptarëve të viseve etnike, mbi çdo gjë tjetër, i duhen institucione kulturore si dhe zhvillim të jetës kulturore institucionale. Diskriminimi kulturor shtetëror që i bëhet shqiptarëve të

Maqedonisë së Veriut, Luginës dhe Malit të Zi, nuk kompensohet me asnjë sukses në infrastrukturën rrugor. Për kulturën shqiptare nuk ka buxhet, sepse po e orientojmë në ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore! Ndërsa institucionet nacionale kulturore të maqedonasve, të serbëve apo malazezëve, duhet të funksionojnë, sepse ato ekzistojnë, nuk guxojnë të mbyllen! Shkurt, mosfinancimi i një libri, mosfinancimi i një shfaqje, i një koncerti, i një ekspozite etj., nuk është diskriminim kulturor por, thjesht politikë favorizuese apo disfavorizues subjektive e personave që drejtojnë ministritë për kulturë e që i kanë për ca shqiptarë "të mirë" e "të ndershëm" si dhe për ca shqiptarët opozitar "që kanë tipare të njerëzve të egër e të këqij", ndonëse këta mund të jenë përfaqësues reprezentativ apo ajka e kulturës shqiptare në viset ku jetojnë! Mospasja dhe moszhvillimi institucionalisht i jetës kulturore shqiptare ky po që është diskriminim politik shtetëror kundër kulturës nacionale të një etnie!

Politikat kulturore pa shpirt

Në një shoqëri e cila mëton që identitetin dhe kulturën ta ketë pjesë të jetës së përditshme dhe të zhvillimit shoqëror, roli i artistëve dhe krijuesve është jashtëzakonisht i çmueshëm. Pa dyshim, artistët dhe krijuesit janë pasqyra e shpirtit dhe mendjes së një kombi, ata kanë aftësinë të sjellin reflektim dhe kritikë ndaj zhvillimeve politike dhe shoqërore. Në shoqërinë shqiptare, gjithandaj viseve etnike, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, në Luginë të Preshevës, artistët dhe krijuesit shqiptarë janë kryesisht të margjinalizuar dhe të përjashtuar nga proceset politike dhe kulturore që formësojnë jetën publike. Do me thënë, pushtetet shqiptare, subjektet

politike shqiptare nuk angazhohet të sigurojë që ata të kenë një zë të fuqishëm dhe të drejtë në këto procese! Pse?

Pushtetet shqiptare, subjektet politike goftë në pushtet apo edhe në opozitë, deri më sot kanë dështuar të krijojnë mundësi të barabarta për artistët shqiptarë që të bëhen pjesë e politikës kulturore dhe shoqërore të vendit. Ky margjinalizim nuk është vetëm një problem social apo kulturor, por një problem politik dhe institucional. Për kulturën dhe artin vendosin subjektet politike që përplasen në mes vete duke u akuzuar se kanë lidhje të ngushtë me botën e kriminit, subjekte që nuk denjojnë që të përfshijnë krijues e artistë në proceset vendimarrëse që lidhen me kulturën dhe artin, me identitetin kulturor shqiptar. Institucionet kulturore dhe ato të qeverisjes, madje edhe partitë politike, asnjëherë nuk i përfshijnë ata në mënyrë aktive në hartimin e politikave kulturore, as në krijimin e mundësive (te shqiptarët jashtë Shqipërisë dhe Kosovës) që promovojnë artin shqiptar në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Pushtetet shqiptare dhe ato ku përfaqësohen shqiptarët, kanë dështuar të krijojnë hapësira ku artistët dhe krijuesit shqiptar të mund të shprehin mendimet dhe idetë e tyre, të kontribuojnë në zhvillimet shoqërore dhe të kenë një zë të fuqishëm për çështjet që i prekin. Debatet dhe diskutimet publike mbi kulturën, kryesisht zhvillohen nga politikanë, nga fytyra publike e jopublike që nuk kanë lidhje me artin dhe kulturën ndërsa artistët dhe krijuesit detyrohen t'u nënshtrohen vendimeve që vijnë nga ata "diskutime formale" jo kompetente e jo profesionale.

Në shumë raste, pushtetet që drejtojnë me fatin e shqiptarëve, kulturën e artin dhe, rrjedhimisht edhe ndonjë artist e krijues shqiptar, i kanë përdorur si një mjet për të konsoliduar pushtetet dhe për të nxjerrë në

pah identitetin politik të partive përkatëse me programe e "vizione" partiake universale! Mospërfshirja e artistëve dhe krijuesve shqiptarë në hartimin e politikave kulturore ka sjellë një lloj diskriminimi dhe vetëdiskriminimi të brendshëm kundër kulturës shqiptare. Që nga financimi i institucioneve kulturore deri te promovimi i eventeve të artit, artistët shqiptarë përjashtohen nga mundësitë që duhet të jenë të drejta dhe të domosdoshme për çdo pushtet. Në shtetet ku shqiptarët përfshihen si participantë qeveritarë, problemet janë edhe më të theksuara. Aty pastaj kemi një mungesë të plotë të transparencës dhe angazhimit për të siguruar që krijuesit shqiptarë të kenë mundësi të kontribuojnë në ndërtimin e një kulture të përbashkët. Vendimmarrësit joshqiptarë krijojnë politika që favorizojnë vetëm elementët e kulturave joshqiptare (serbe, malazeze, maqedonase), duke injoruar pasurinë kulturore që sjellin artistët shqiptarë. Pa përfshirjen aktive të artistëve, të krijuesve e kulturëbërësve, politikat kulturore gjithnjë do të mbeten të varfra dhe të ngushta, pa atë mundësi reale për të pasuruar dhe zhvilluar identitetin kulturor si kolonë gjenetike të çdo kombi.

Diskriminimi kulturor si mision institucional

Në Maqedoninë e Veriut, kultura dhe arti shqiptar kanë qenë gjithmonë një çështje delikate, kryekëput e marginalizuar. Pa dyshim, artistët dhe krijuesit shqiptarë japin shumë për trashëgiminë kulturore të vendit si dhe për larmishmërinë e saj kulturo-artistike. Përkundër kësaj, ata

gjithnjë po përballen me sfida të mëdha, sidomos në kontekstin e një shoqërie që ka jetuar nën ndikimin e një politike të diskriminimit kulturor. Në këtë kuadër, është e domosdoshme një analizë mbi atë se çfarë bëhet (dhe çka nuk bëhet) për krijuesin dhe artistin shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Dhe kjo analizë duhet të vijë pikërisht nga vetë këta artistë e krijues, pasi të ndërjegjësohen një herë e mirë mbi faktin që diskriminimi i tyre kulturor tashmë është një mision institucional maqedonas.

Promotor i këtij realiteti që flet për një një histori të gjatë të marginalizimit kulturor të popullit shqiptar, është strategjia nacionale e pushtetit maqedonas për të mos ofruar mbështetje minimale për zhvillimin e artit dhe, përgjithësisht, kulturës shqiptare. Pse ky ndërjegjësim duhet të pritet nga komuniteti artistik dhe jo nga komuniteti politik shqiptar i pushtetit maqedonas? Sepse subjektet politike shqiptare tashmë fare mirë e kanë kuptuar se janë të pafuqishëm karshi diskriminimit kulturor që nuk është vetëm rezultat i tendencave individuale, porse tashmë po kalon nëpërmjet institucioneve të shtetit dhe të politikës shtetërore, të cilat po e stimulojnë kultivimin e një kulture dominuese maqedonase si një mjet për forcimin e identitetit kombëtar maqedonas si i vetmi identiteti reprezentativ i shtetit të Maqedonisë së Veriut. Dhe kjo tendencë po vërehet nga infrastruktura kulturore, nga strategjia nacionale për kulturë si dokument, nga ligji përkatës, nga buxheti dhe fondet dhe nga mostrajtimi apo edhe keqtrajtimi i veprave dhe vlerave kulturore shqiptare.

Në këtë pushtet ku kasta politike përbëhet

nga "pronari dhe vasali", nga "perandori dhe robi", në këtë shoqëri ku identiteti dhe kultura nacionale (maqedonase) janë të lidhura ngushtë me pushtetin, kulturë-bërësit shqiptarë lihen jashtë procesit të vendimmarrjes kulturore dhe institucionalizimit të artit. Askush nuk i pyet: subjektet politike shqiptare nuk pyesin sepse janë kryekëput antikulturore, ndërsa subjektet politike maqedonase nuk pyesin, sepse atyre u intereson dhe angazhohen ekskluzivisht për kulturën maqedonase "që i jep shpirt" shtetit maqedonas. Institucionet kulturore dhe mediat janë të dominuar kryesisht nga ndikimi maqedonas i bazuar në "dokumentin e shenjtë" të strategjisë nacionale për kulturë, ndërsa përpjekjet e artistëve dhe krijuesve shqiptarë për të realizuar projekte mbështeten me lëmshë, apo edhe bllokohen nga mungesa e burimeve financiare dhe mbështetja institucionale.

Në këtë kontekst, çfarë duhet të bëjnë partitë shqiptare që "participojnë" në pushtet për krijuesin dhe artistin shqiptar në Maqedoninë e Veriut? Sa më parë duhet të hartojnë strategji nacionale për kulturë që duhet të jetë platformë politike mbi të cilën do të ngrihen programe partiake e marrëveshje politike me subjektet e pushtetit! Përfundimisht, çdo pushtet duhet të marrë masa të qarta dhe të drejta për të krijuar mundësi të barabarta për zhvillimin e artit dhe kulturës shqiptare. Në peshoren politike qartë duhet të shihet mbështetja e barabartë financiare dhe infrastrukturale për artin dhe kulturën shqiptare. Investimi në hapësira kulturore dhe mbështetje për organizimin e aktiviteteve artistike shqiptare duhet të jenë një prioritet për çdo qeveri të

shtetit të Maqedonisë së Veriut. Subjektet politike shqiptare duhet ta kenë të qartë se pa një bazë të fortë infrastruktururore dhe mbështetje financiare në kulturë, gjithnjë do të ngulfatemi në antivlerë dhe në akulturimin e shoqërisë sonë shqiptare. Më e pakta që duhet të ndodhë përgjatë konstituimit të qeverive dhe ndarjes së pushtetit është përfshirja e domosdoshme e krijuesve shqiptarë në proceset e politikës kulturore, sepse krijuesit shqiptarë duhet të kenë një zë në hartimin e politikave kulturore të vendit. Ata duhet të përfshihen në proceset e vendimmarrjes dhe të jenë pjesë e ngjarjeve dhe aktiviteteve të rëndësishme kulturore, duke pasur mundësinë për të sjellë një kontribut të vlefshëm dhe për të promovuar artin shqiptar në një nivel më të gjerë. Sepse, deri më sot është dëshmuar katërcipërisht që këtë detyrë kombëtare nuk po dinë dhe nuk po munden ta kryejnë përfaqësuesit politik të shqiptarëve të këtushëm.

Pa dyshim, edhe pala maqedonase duhet përfundimisht të bindet që mos ndërmarrja e hapave të qartë dhe të menjëhershëm për të mbështetur artin dhe kulturën shqiptare në Maqedoninë e Veriut, vetëm sa e dëmton rëndë zhvillimin e artit, kulturës dhe shoqërisë në tërësi. Nuk guxon që në një hapësirë ku shprehet angazhimi maksimal për një kulturë të mirëfilltë institucionale të lulëzojë "një kulturë" e padenjë për t'u kultivuar në asnjë cep të botës! Antivlera "kulturore" nuk është egjë që mund të harret porse është një barojë që e shkreteton tërë fushën. Diskriminimi kulturor institucional duhet të trajtohet njësoj siç trajtohen veprat e kimit, pa mëshirë dhe njëjtë për të gjithë.

Letër nga diaspora

MUZETË SI BURIM I ILUMINIMIT TONË

Iluminimi na ndihmon të dalim nga mendësia e kufizuar dhe të kuptojmë perspektiva të ndryshme, na ndihmon të jetojmë me më shumë kuptim, qetësi dhe lidhje me diçka më të madhe

Neviana SHEHI/ Itali

Iluminimi (ndriçimi i mendjes) është një proces i vlefshëm dhe i nevojshëm për rritjen tonë personale, shpirtërore dhe intelektuale. Nuk është vetëm një ide abstrakte, por një mënyrë për të kuptuar më mirë veten, botën dhe vendin tonë në të. Iluminimi na çliron nga padituria, frika dhe kufizimet mendore, duke na ndihmuar të jetojmë një jetë më të ndërjegjëshme, më të pasur dhe më të kuptimtë. Në fund të fundit, iluminimi nuk është një destinacion, por një udhëtim i vazhdueshëm. Çdo ditë kemi mundësinë të mësojmë, të rritemi dhe të jetojmë me më shumë kuptim. Iluminimi na ndihmon të zbulojmë kush jemi në të vërtetë dhe si funksionon bota përreth nesh. Na lejon të bëjmë zgjedhje më të informuara dhe autentike për jetën tonë.

Pse duhet të iluminohe mi? Thjeshtë, për të dalë nga errësira e paditurisë. Sokrati pati thënë: "E vetnija gjë që di, është se nuk di asgjë". Sa më shumë mësojmë, aq më të lirë jemi nga besimet e gabuara dhe keqkuptimet, dhe kjo na ndihmon për të fituar qetësi dhe harmoni të brendshme, për të fituar një ndjenjë paqeje dhe mirëkuptimi të thellë, për ta pranuar jetën ashtu siç është, pa anktë dhe vuajtje të panevojshme, për të zhvilluar mendimin kritik dhe kreativitetin.

Pra, një mendje e ndriçuar nuk pranon çdo gjë verbërisht, por analizon, pyet dhe kërkon të vërtetën. Njerëzit e iluminuar nuk mund të manipulohen lehtë dhe kontribuojnë në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të mençur. Historia ka treguar se civilizimet përparojnë kur njerëzit kërkojnë dituri dhe ndriçim. Iluminimi na ndihmon të dalim nga mendësia e kufizuar dhe të kuptojmë perspektiva të ndryshme, na ndihmon të jetojmë me më shumë kuptim, qetësi dhe lidhje me diçka më të madhe. Do theksuar se njerëzit e iluminuar shpesh gjejnë kënaqësi në art, filozofi, shkencë dhe



në eksplorimin e jetës në një nivel më të thellë.

Bashkatdhetarët tanë që jetojnë në shtetet perëndimore, fatkeqësisht fare pak i eksplorojnë mrekullitë që i kanë aty pranë. Janë të paktë ata që i vizitojnë muzetë, të cilat në një mënyrë janë dritare në historinë, kulturën, artin dhe shkencën e njerëzimit.

Ta vizitosh Luvrin në Paris, do të thotë se ke vizituar një nga muzetë më të famshëm në botë, i njohur për veprat ikonike, si Mona Liza dhe Venus de Milo. Është një muze i përsosur për ata që duan të eksplorojnë artin klasik dhe historinë e qytetërimeve të lashta. Muzeu Britanik i Londrës ofron një koleksion të pasur nga Egjipti i Lashtë, Greqia, Roma dhe

shumë kultura të tjera. Uffizi në Firence është një muze i mbushur me kryevepra të Rilindjes, si të Botticelli-t, Leonardo da Vinci-t dhe Michelangelo-s dhe është ideal për ata që kërkojnë të kuptojnë evoluimin e artit italian.

Pastaj është Muzeu i Amsterdemit, i njohur për pikturat e Rembrandt-it dhe Vermeer-it dhe i cili reflekton artin e artë holandez. Muzeu Pergamon në Berlin është një vend ku vjen në jetë historia e Lindjes së Lashtë. I jashtëzakonshëm është edhe Muzeu i Vatikanit në Romë, i cili përfshin Kapelën Sistine me afresket e mrekullueshme të Michelangelo-s, një përvojë kjo e fuqishme shpirtërore dhe artistike. Është edhe Muzeu i Vjenës, i cili përmban një koleksion të pasur të artit

grafik, me Dürer, Klimt dhe Picasso dhe ku hetohet ndërthurja e përsosur e artit klasik dhe modern.

Në këto muze arti dhe historia frymëzojnë dhe japin një kuptim më të thellë mbi veprat magjike, të cilat të krijojnë një ndjesi shpirtërore që nuk mund të përshkruhet me fjalë.

Përditshmërinë tonë nuk duhet vënë në kornizën e punës dhe fitimit. Përkundrazi, përmbajtjes së saj i jep bukuri edhe ana shpirtërore, e cila pasurohet me mrekullitë rreth nesh, siç janë edhe muzetë e shumtë që i kemi fare pranë e nuk i vizitojmë asnjëherë. Prandaj, të gjejmë pak kohë (që nuk na mungon asnjëherë) dhe t'i vizitojmë muzetë për ta zbuluar kapitalin shpirtëror të njerëzimit.

Rexhep Shahu, shkrimtar

SHUMË NJERËZ SHALOJNË GOMARIN E NA OFROHEN SI KALORËS

Ka nisë një ngutje në botimin e librave hutues të tipit si të jesh i suksesshëm, si të jesh kështu a ashtu, si të bëhesh milioner e pallavra me receta të tilla sa banale e vulgare dhe marketingu për këto libra le në errësinë letërsinë e vërtetë që nuk të mëson si të bëhesh milioner, po si të bëhesh njeri...



Shkëlzen HALIMI

Rexhep Shahu u lind në vitin 1960 në Bardhok të Kukësit afër Prizrenit ku bashkohen dy Drinat, Drini i Bardhë e Drini i Zi me malin e Pikëllimës në shpinë e atë të Pashtrikut në sy. Në Durrës kreu shkollën e mesme teknike-mekanike. Atje u mësua me det dhe lau ëndrrat në të. Universitetin për letërsi e kreu në Shkodër. Rexhep Shahu ka provuar gjithfarë lloj punësh e profesioneve në fusha e male, me bujq e blegtorë, kosëtarë e korrës gruri... Ka jetuar me mineral-kërkuesit, minatorët, vagonistët, ka punuar si motorist e xhenerik, ka punuar sekretar në prokurori, shpesh duke u dridhur për fatet e të tjerëve, ka qenë drejtues kulture, tregtar, ka themeluar një kompani ndërtimi, ka punuar gazetar në Radio Kukësi, korrespondent në Radio Tirana, korrespondent në Top Albania Radio e në organe të shumta shtypi të Tiranës e Prishtinës, zëdhënës në Qarkun e Kukësit, zëdhënës shtypi e këshilltar i ministrit për media e marrëdhënie publike në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Tiranë. Ka drejtuar si botues e kryeredaktor revistën kulturore "Dy Drina", revistën për fëmijë "Kallz", organe këto të Qendrës kulturore "Dy Drina", të themeluar prej tij, të përkohshmen "Gazeta e Kukësit" dhe shtatë vite ka drejtuar si kryeredaktor edhe revistën kombëtare "Bujqësia Shqiptare", organ i Ministrisë së Bujqësisë, Tiranë. Rexhep Shahu prej një dekade është botuesi dhe kryeredaktor i revistës më të madhe letrare në gjuhën shqipe "Illz", periodik dymujore dhe drejton Shtëpinë e tij botuese Klubi i poezisë në Tiranë.

Është autori i shumë veprave: Mali i

Hënës - vëllim poetik (Tiranë, 1998), Bregu i Brengës - vëllim poetik (Prizren, 2000), Misioni për Paqen - publicistikë, krizës së Kosovës 1998-1999 (Tiranë, 2001), Bllaca - (monografi) me bashkautor - 2002, Marsi i minave - publicistikë, për ngjarjet e Kosovës 1998-2000 (Tiranë, 2006), Lis i vetëm në fushë - vëllim poetik (Tiranë, 2011), Apologji për udhën e kombit - publicistikë (Tiranë, 2012), Qyteti i lutjeve - poezi, Tirane 2014, Bukën tonë të përditshme, publicistikë (Tiranë, 2014), Ismail Raka - Sytë e Lirisë - monografi për heroinë e Kaçanikut, (Tiranë 2014), Kjo verë mërzie - vëllim poetik, (Tiranë, 2015), Ku ishe ti hero - publicistikë, Tiranë, Shkrimtarët për Havzi Nelën - Shpirti i lirë i Lumës, - përgatitës, Tiranë, 2018, Havzi Nela - Shtatë fletore, botimi i plotë me 5548 vargje, - përgatitës, Tiranë, 2018, Bisedë me Havzi Nelën, - eseistikë, Tiranë, 2019, Faleminderit Doktor Alushani, - rrëfime, Tiranë, 2020, Dita e gjashtë - Poezi, Tiranë, 2020, Rrahman Zeqiraj - Një statujë kujtimesh, monografi, Tiranë, 2020, Njëgjjo a, njëgjjos'a, pa ta s'a, publicistikë, Tiranë, 2021 dhe Lufta ime për Kosovën, publicistikë, Tiranë, 2023.

HEJZA: Është një fakt i pamohueshëm. Sot, ambientin ton letrar e karakterizojnë "kruzhoqet" letrare, provincializmi, abuzimi, amatorizmi, papërgjegjësia e kështu me radhë. Pse ndodh kjo dhe kur do të pasojë reagimi institucional për ta kthyer këtë ambient në binaret e vërteta?

R. SHAHU: Tempulli i vetëm që duhej të kishte shpëtuar pa u infektuar me viruset mediokre të ditës, do të ishte mjedisi letrar. Askush asgjë kurrë nuk mund ta ndikojë e diktojë një shoqëri në mënyrë edhe të pakuptueshme se sa libri. Po sot

fatkeqësisht në mbretërinë e librit bëhet mbret kush të mundet, kush rend më i pari, kush është më i forti, kush ka post a përkrahje politike më shumë, kush ka kuletën plot ani se mund ta ketë trurin djerrë. Kush mundet katund për katund ndajnë çmime, dekorata, duke rivalizuar edhe Nobelin suedez. Kjo rëndomtësi, ky provincializëm, kjo etje për grada, kjo bjerrje vlerash e "blerje "gradash, kjo nevojë ulëritëse për lëvddata nga jo meritore, nga anonimë të shquar, tregon një shkallë të ultë inteligjence të aktorëve të kohës tonë, tregon një inferioritet të thellë dhe një krizë të rëndë morale. Në mjediset tona letrare kulturore, mendoj se ecet me moton, "lopa jeme ma e mira në katund". Kjo ndodh, sipas mendimit tim, se institucionet shtetërore e shoqërore janë në pikën më të ultë të seriozitetit të tyre, kjo ndodh se shoqërinë shqiptare e tërheqin për hunde në gjithë hapësirën shqiptare militantët ordinerë që i ofron politika e ditës, se politika është mitra e drejtuesve. Kurrë më i ultë nuk ka qenë niveli i njerëzve të institucioneve të kulturës, kurrë më anonimë nuk i kemi pasur zyrtarët që merren me librin e kulturën, me letërsinë e artet. Çdo kohë e brez nxjerr përfaqësuesit e tij, por nuk ka të spikatur që drejtojnë e udhëheqin, ka vetëm anonimë që dalin në majë. Kjo ndodh e do të ndodhë derisa shoqëria të votojë njerëz pa integritet veç pse kanë pasuri jo me djersë, të votojë njerëz që politikën e kanë biznes për pasurim. Derisa të zgjedhim njerëz të ditur, jo matrapazë.

HEJZA: Borhesi, Parajsën e perceptonte si një Bibliotekë me kthina nga Babilonia e lashtë e deri të bibliotekat bashkëkohore gjithandej botës! Tendencat për digjitalizimin e librit, për formën e librit online, a po e rrënojnë këtë

Parajsë borhesiane, apo janë shenjat e para të angazhimit për digjitalizimin e domosdoshëm të Parajsës-bibliotekave!

R. SHAHU: Është tentuar dhe vazhdon të denigrohet libri, libri klasik që në jetë të jetëve nuk do ta humbë magjinë. Është stimuluar e po stimulohet dembelizmi. Jashtë librit nuk mund të jetë dikush i suksesshëm e i ditur në jetë. Telefoni dhe kultura e titujve në telefon nuk bën askënd të ditur, nuk lexohet libri në telefon, nuk është lexim, nuk ka magji pa fëshfëritje e aromë letre sipas meje. Sot po sundojnë ata që kryejnë universitete me studime në celular, ata që blejnë diploma, tituj, grada që ua përgatit e zhvillon temat IT. Ndoshta koha është e tillë e vrullshme, ndoshta koha nuk ka kohë të presë. Por, mendoj se pallati më madhështor i dijës, me solemnitet me hyjnorë në planet është biblioteka me libra fizik. Le t'i digjitalizojnë e kodojnë se ka njerëz që lexojnë në telefona e kompjutera, por nuk ndërtojnë dot pallate hyjnore librash në USB. Ndoshta jam gabim dhe jashtë kohe e jashtë mode, por mendoj se leximi në telefon është si ushqimi në fastfude, si ushqim me hamburgër në dorë.

HEJZA: Besojmë se edhe Ju ndani mendimin se ndër në shumë është shkruar pseudo-poezia, më pak poezia dhe më pak tregimi? Pse shkruhet poezia? Kujt i intereson pseudo-poezia? Cili është identiteti i tregimit tonë të shkurtër?

R. SHAHU: Ne jetojmë në pellgun e poezisë, në atdheun e poezisë, siç e kanë cilësuar. Jemi një arë, një atdhe poezie me Greqinë e Turqinë. Nëse i besojmë asaj që i shkruan Lamartini De Radës në 1800, se nga brigjet tuaja ka ardhë poezia dhe atje



duhet të kthehet, ne nuk i shmangemi dot. Pastaj kemi zona që epika dhe lirika është mënyrë e stil komunikimi. Por, poezia nuk ka lidhje me pseudo-poezinë. Poetët shkruajnë dhe vuajnë, nderohen dhe shpesh nuk e dinë nderimin e adhurimin. Pseudo-poetët shkruajnë për modë, për të mundë të marrin adhurimin që u jepet poetëve. Nderimin e adhurimin që shoqëria ka për poetët e vjelin përgjithësisht dhe e përvetësojnë pseudo-poetët, porno-poetët. Sot e gjithmonë ka pasur pseudo-poetë, vargëzues e rimues vargjesh, ka pasur mashtrues e hajdutë vargjesh, poezish. Ata që vjedhin poezi duan me çdo çmim të jenë të famshëm si poetë, sepse u duket privilegj hyjnor te jesh poet, të të recitojnë njerëzit, t'i shpërndajnë poezitë e tua, t'i përdorin poezitë e vargjet për kartolina urimi, për letra e mesazhe dashurie. Pseudo-poetët ngaqë dështojnë t'i dojë dikush, ata lakmojnë të jenë poetë. Poezi do të thotë dashuri, të jesh poet do të thotë të digjesh e përvëlohesh për dashurinë, të jesh flakë, prush. Nuk e njohim sot sa duhet fuqinë e tregimit të shkurtër, nuk po dalin në dritë mjeshtrë të këtij tregimi, edhe se ka patjetër tregimtarë, por mediat zhurmojnë nuk ndriçojnë meritoret, por ndezin prozhektorët për jo meritoret e meritoret mbeten në errësirë. Ndodh që na ofrojnë si tregimtarë autorë kronikash banale shtypi, por kronikat e shtypit nuk janë tregime. Kemi tregimtarë patjetër që lëvrojnë tregimin e shkurtër edhe të natyrës çehoviane, nuk po hyj në emra, por kemi, kam botuar edhe unë. Kemi shkollë tregimi edhe ne të krijuar nga Kuteli, Anton Pashku, etj. Jo gjithkënd vetmia e bën shkrimtar, jo gjithkënd braktisja a dëshpërimi e bën shkrimtar, jo çdo mësues leximi në shkolla fillore është domosdo shkrimtar a kritik letërsie. Jo 'do veteran mund të bëhet historian, jo çdo rrenë e falsifikim pleqsh është letërsi, jo çdo brengë a mos realizim a plotësim pleqsh është letërsi a histori. Le të shkruajnë të gjithë histori a kujtime, po për fëmijët e tyre, për familjet e tyre, jo të kërkojnë vëmendjen e shoqërisë, të harxhojnë lekët e fëmijëve emigrantë për të botuar librat e tyre. Shumë pensionisti a veterani nga mosha them veteran, beson se është shkrimtar a poet dhe beson se ka shkruar kryevepër. Nuk ka ndonjë të keqe që shkruajnë, por ngatërrojnë me shkrimet e tyre pasi historia nuk bëhet me "si më ka thënë baba"... Pleqtë që gjithë jetën nuk kanë lexuar 50 libra dhe disa fëmijë që paraqiten prej prindërve të tyre si gjeni, janë dy kategori që dështojnë me sukses në jetë në masën më të madhe, me ndonjë përjashtim të rrallë një në 10 a 20 mijë...

HEJZA: A mund të ketë kritikë bashkëkohore letrare në kohën kur po na

ngulfat amatorizmi dhe diletantizmi në bërjen e "letërsisë"?

R. SHAHU: Jo nuk mund të ketë, sepse kritiku bëhet me dije jo me ndonjë aftësi të veçantë tjetër. Nëse për të bërë poezi duhet talent dhe dije, për t'u bere kritik duhet dije dhe dije. Sot shumëkush po na shitet si kritik letrar, si gjitholog në të gjitha fushat dhe në një mënyrë a tjetër kjo punë është bërë biznes ditor, është bërë trafikim vlerash, përgjigje vlerash. Të citosh tre katër emra kritikësh botërorë, nuk do të thotë se ke bërë shkollën e tyre, por këtu tek ne mahnitën autorët lehtë. Njerëzit paguajnë në mënyra të ndryshme që të lavdërohen, është një trafik i madh lëndimi, kemi rënë në një deformim të rëndë. Faqe gazetash e portalesh me lëndata janë si fleta nderi. Pak e fare pak emra besimi ka kritika letrare. Sepse rioshtë të saposhkolluar duke shkruar në shkolla pa libra, pa mësues, pa djersitje, me një celular në dorë shfaqen si të shumë-ditur e të gjithë-ditur. Si është e mundur pa një përvojë leximi të ofrohen si kritikë e studiues letërsie që të marrin në qafë. Ka një keqkuptim të madh në trafikun letrar, mendoj unë. Ka një trafik të dendur, një qarkullim të madh njerëzish që shkruajnë libra, që i lëpihen e jargaviten famës. Tundimi është i madh. Në këtë trafik të dendur ndodh që humbet i talentuari, që nuk vihet re, sepse sot media ka marrë përsipër të zbulojë e promovojë, por media në masën më të madhe nuk ka kompetentë të fushës dhe media do lubrifikant, paratë.

Pastaj sheh në këtë trafik të dendur e kaotik letrar guximtar të çuditshëm. Jo çdo mësues leximi i fshatit duhet të shfaqet si shkrimtar apo si kritik letrar. Minimalisht besoj duhet një kohë fizike, një moshë e caktuar që të besojmë se ka pasur kohë dikush të lexojë 500 a 1000 libra dhe ka fituar një minimum kulture që të shfaqet si letrar a kritik letrar. Nuk kemi trena mjaftueshëm për doktorat e shkencave në fushën e letrave... Edhe këtu politika dikton, rekomandon, cakton kush bën a nuk bën, politika thotë për kë të shkruhet e për kë të mos shkruhet. Besoj, sipas meje, se vlerësimet e shkrimtarëve të njohur për vepra e shkrimtarë të ndryshëm, janë gjërat më serioze për vlerësime veprash letrare. Po bëj një ilustrim të vogël me tregime reale, nëse më lejohet. Më thotë berberi një ditë, ti je shkrimtar, të njoh unë, të kam parë. Po, njëfarë shkrimtari jam, i them. Po ti çfarë shkollë ke mbaruar e pyeta. Tha emrin e një gjimnazi të njohur në Tiranë. Po me Kadarenë a ke pi kafe, më pyet ai. Po, i thashë. Po me Naim Frashërin a ke pi kafe, vijoi të më pyesë berberi ndërsa me priste flokët e rralla. M'u duk se po ma heq edhe lëkurën e kresë bashkë me

flokët. Po Naim Frashëri ka vdekë para njëqind e sa vitesh, i them duke e fshehtë një dëshpërim që më mbuloi. Nuk u skuq fare, e pashë nga pasqyra, nuk e prishi terezinë... Një ditë në një gjimnaz të Tiranës hyjnë në një klasë një grup kontrolli prej tre inspektorësh. Sa hyjnë në klasë, njëri nga inspektorët pyet klasën, "kush i njezh vëllezërit Frashëri nga ju". Mësuesja u tregua më e shkathët se nxënësit, "mund të jenë në ndonjë klasë tjetër, nuk ka vëllezër Frashëri në këtë klasë". Stop. Pikë. Ja ku kemi rënë si shoqëri, si shtet, si komb.

HEJZA: Sipas Jush, jeta letrare e shqiptarëve sot është më e pasur se dikur apo më e varfër?

R. SHAHU: Në dukje jeta letrare e shqiptarëve sot është më e pasur, por në thelb është më e shpërlarë, më hipokrite. Shumë njerëz shalojnë gomarin e na ofrohen si kalorës dhe nuk kuptojnë se kanë shaluar gomarin e jo kalin. Sot bëhen ngjarje letrare sa për fotografi, sa për rrjete sociale, nuk përjetojnë ngjarjet letrare. Nuk ka thellësi, ka veprime sa me kalie radhën, sa për të filmuar diçka kamera. Nuk ka tempull më të lakmuar se libri, se shkrimtari. Të gjithë duan të jenë shkrimtarë, të kenë libra të botuara. Duan të flitet për ta, të kenë famën, vëmendjen, por harrojnë se veç talentit shkrimtari ka mundim të madh që jo gjithkush e përballon. Po sot gjen mjaft nga ata që e blejnë famën, paguajnë të kenë libër, po libri nuk është biznes i gjithkujt që din shkrim e lexim. Se në finale fitojnë harrimin e dështimin, por joshjen e momentit e kanë të madhe. Sot blihet koha televizive jo nga i talentuari e meritorit, por nga ai që ka lekë e kërkon famë e vëmendje. Gazetarë të vërtetë kulture takohen shumë rrallë në kohën tonë dhe mjaft prej atyre që duken si gazetarë kulture, janë tregtarë të hapësirës mediale që e kanë dhe e shesin a këmbëjnë hapësirën për arsye politike, krahinore, dhe për lekët a benefitet që marrin, rrallë për vlerat që promovojnë. Ata të gjerët urdhërohen prej pronarëve, se pronarët janë paguar për t'i bërë qoka këtij a atij autori. Gjithmonë leku e ka ngritë ujin përprjet, por edhe në krijimtarinë letrare në zejen më të rëndë të botës, sot po e çon edhe më lart... derisa gradohen fenomene letrare, risi në letrat shqipe, të talentuar të jashtëzakonshëm... që u bie kallaji shpejt. Jetën letrare po e degjenerojnë keq edhe autorët e disa lloj librash që kanë vlerë patjetër, por janë libra familjarë, fisnore, libra me histori katundesh të tipit kështu më ka thënë baba, libra veteranësh që vrasin kotësinë e jetës së tyre dhe në pleqëri duan të bëhen edhe shkrimtarë a historianë ani se nuk kanë shkollim solid veç shkollës së

partisë e as histori që të jenë të përveçme. Nuk po dua keqkuptim, por jo çdo veteran që i dërgojnë fëmijët lekë nga emigrimi mund të shpenzojë lekët e fëmijëve për të paguar, për të shkruar e botuar libër se as fëmijët e tij nuk i besojnë e nuk e lexojnë, vetëm i bën me turp fëmijët e tij... Siç ka të rinj e te reja që nguten të na shiten gjeni që në shkolla fillore a të mesme dhe prindërit paguajnë për deformimin e tyre në jetë. Ne kemi njerëz për të cilët është investuar para e madhe, pritshmëri e madhe, janë investuar parathënie, recension, rekomandime edhe nga shkrimtarë të mëdhenj dhe në fund për librat e tyre u vjen turp edhe vete atyre autorëve. Ka mjaft raste që autorë të ndryshëm i gënjen mendja se janë poetë e shkrimtarë dhe mallkojnë pse nuk u ofrohen shtëpitë botuese t'i botojnë falas dhe edhe t'i paguajnë. Në kushte normale asnjë botues nuk boton askënd falas. Për të botuar një libër shtëpia botuese shpenzon dhe nuk boton pa pasur interes e besim se i kthehet shpenzimi i kryer. Autorë mediokër, delirantë që nuk kanë asnjë lexues as një blerës të librit, që nuk janë provuar kurrë, bëjnë zhurmat më të mëdha pse nuk botohen, pse shtëpitë botuese nuk ua kërkojnë dorëshkrimet. Kur u jep shembuj të tillë se si Uitmani ka botuar librin e tij të famshëm "Fije bari" me paratë e tij, meken dhe janë gati të të thonë se nuk është gjë Uitmani sa jam unë. Kur u thua se për të botuar Lasgushin, Çabej ka mbledhë sponsorizime, janë gati të të thonë se Lasgushi nuk është gjë si poet sa ç'jam unë... Duke qenë se lexohet në telefona dhe kaq, duke qenë se rrjetet sociale shpërndajnë shumë letërsi ani se përgjithësisht është letërsi këllirë, ka rënë kërkesa për librin fizik, kërkohet më pak, shitet më pak. Pos kësaj, edhe se popullsia shqiptare në hapësirën shqiptare dekadën e fundit apo dekadat e fundit është përgjysmuar pothuajse. Dhe fuqia më aktive njerëzore e ka lënë atdheun dhe është zhvendosë në vende të tjera europiane. Atje kanë probleme integrimin, pak vëmendje kanë për librin shqip se atje nuk i ndihmon libri shqip të integrohen. Pastaj ka nisë një ngutje në botimin e librave hutues të tipit si të jesh i suksesshëm, si të jesh kështu a ashtu, si të bëhesh milioner e pallavra me receta të tilla sa banale e vulgare dhe marketingu për këto libra le në errësirë letërsinë e vërtetë që nuk të mëson si të bëhesh milioner, po si të bëhesh njeri...

HEJZA: E bukura, e përkryera, harmonia! Cila është qasja shqiptare ndaj këtyre kategorive filozofike! I pëlqejmë, bëjmë pas tyre, por si sillemi me to?

R. SHAHU: Asnjëherë nuk besoj se biem në një mendje në vlerësimin për

të bukurën, të përkryerën, harmoniken, sepse në tërësi në ne dominon arroganca e më të paditurve, më pak të diturve, gjysmë të diturve për këto vlerësime. Jemi pak dhe secili mendon se është kërthiza. Kujtoj këtu një fenomen shqetësues, një mani qesharake për të krijuar institucione vlerësimi për të bukurën, për të përkryerën e të përsosurën. Bëhemi aq qesharake e bajat kur sheh e dëgjon deri krijime akademish, ndarje çmimesh, shpërndarje certifikatash, titujsh e nderesh, shitje nderi me gram siç e ka shtjelluar bukur në romanin e tij të qëlluar "Dhjetë gram nder" shkrimtari Namik Dokle. Kemi një mani me i përbaltë gjërat e bukura, me i përllojë, mos me i adhuro, me i përgojue, me ua nxjerrë gjuhën. Kemi një dëshirë e mani me qenë kërthiza e botës, modeli i të përkryerës dhe këtë disa sharlatanë e kanë kthyer në biznes fitimprurës dhe rrjepin popullin analfabet të cilit ia heqin hundën. Shpallin gjuhën tonë si nëna e gjuhëve të botës, shpallin vende të rëndomta në katundet tona si kërthiza qytetërimi, shpallin ndonjë llakë uji si oqean ujërash termale, si oqean naftë... Vlerësimi e nderimi për të bukurën ka degjeneruar si shumëçka në jetën tonë. Shitja e titujve të nderit, e ka shkatërruar hierarkinë e vlerave. Sot po implementohet edhe në sferën e vlerësimit të vlerave shpirtërore ajo që ndodh në tregti në biznes e politikë, që ajo që nuk blihet me para blihet me shumë para. Jemi dëshmitarë të vlerësimeve jo për shkak të cilësive estetike, letrare, por për shumën e lekëve që jepen, për trafikun e influencës nga politika, krushqitë, nga konkubinatat e prostitucioni politik arrogant, sa bëhet humor, mos kalo nga presidenca se të kapin për krahu e të japin ndonjë titull ose të bëjnë edhe Nderi i kombit...


HEJZA: Në Shqipëri, për gjysmë dekadë u kultivua letërsia e diktuar prej pushtetit enverist! Në viset etnike, sidomos në Kosovë, u rezistua fuqishëm kundër politikave shovene që synonin për të krijuar një letërsi politike antikombëtare. Krijimtaria artistike gjeti shteg te metafora? "Disidentë plotë", andej e këndeje kufirit, por letërsi disidente fare? Pse?

R. SHAHU: Nuk është as nuk ka qenë e lehtë a e kollajtë disidenca. Regjimi komunist u instalua me plumba, me pranga, u eliminuan ashpër kundërshtarët, të dysuarit, jo entuziastët. Disidenca jonë mbetej brenda klubit, mbi filxhanin e kafes, mbytej në gotën e rakisë, shndërrohej në jehonë thashethemesh. Pak guxonin në mënyrë inteligjente të bënin letërsi në teh thike, dhe shumica e pazonja mbyste të zotët e rrallë, i denigronte, më e pakta. Shumë e dinin se toka rrotullohet, por kishin fëmijë... Tragjeditë shqiptare nuk patën tragjedianë të shkruheshin të rrëfeshin. Nuk kishte zgjedhje, po shkrope jetën kundër vijës së partisë, dënosheshe me burg ose pushkatim. Ne nuk mund të fajësojmë shkrimtarët pse nuk shkruan në atë mënyrë që e ndalonte regjimi, sepse do dënosheshin, por ne mund t'i fajësojmë ata shkrimtarë që u bënë më të zellshëm se partia në ndihmë të partisë. Disidenca reale u mbyt, dhe disidenca e shpikur mori frenat në dorë, porno disidenca. Shkrimtarët shqiptarë kanë përjetuar akte të tmerrshme tragjike, por u përbaltën. Letërsia shqipe ka poet të pushkatuar e të varur në vitet 1970-1980 kur në Europë, e mbase në botë, nuk ka kush tjetër poet të varur. Të mos harrojmë se komunizmi mbi gjithçka synoi depersonalizimin, synoi t'i bënte të gjithë spiunë të të gjithëve. Masakrat mbi disidentët nisën në krye të herës, u eliminuan letrarët e spikator klerikë që kishin nisë të bënin hekurudhën letrare shqiptare. E pushkatuan Pater Anton Arapin, shkrimtar, ndaluan Fishtën se urdhëroi Serbia, mbytën në burg Vinçenc Prenushin, Et'hem Haxhiademin, vranë Trifon Xhagjikën, Vilson Blloshmin, Genc Lekën, varën Havzi Nelën, mbajtën gjatë në burgje mjaft të tjerë, si Pjetër Arbnorin etj. Perandoria e frikës sundoi çdo mendje. Por, edhe nën terror e frikë është krijuar letërsi. Kemi rastin Kadare, letërsia e të cilit e shkruar në atë kohë, ishte rreze drite e besimi dhe ajo letërsi u



vlerësua në 50 gjuhë të botës. Nuk besoj se një letërsi komuniste e të shpërlarë do ta vlerësonin 50 gjuhë të botës. Në Kosovë si në Shqipëri u investua që të gjithë të ishin kundër të gjithëve, u investua të mos mbetej askush pa bisht, pa u bërë spiun ndaj njëri tjetrit. Komunizmi ndonëse më liberal, komunizëm ishte dhe në Jugosllavi vetëm se lejohej prona private. Kjo tendenca për të bërë e gjet spiunë, për të mos lënë askënd pa bisht vazhdon edhe sot. Vazhdon të thuhet se ky a ai e këta e spiunuan filanin dhe

e futën në burg, si në Shqipëri. Këtu kemi një fushatë të pandershme. Nëse dikush ka qenë antiserb, antijugosllav i deklaruar dhe ka punuar kundër Jugosllavisë, e është mburrë për këtë gjë, pse duhet sot të akuzojë X a Y a Z se e kanë spiunuar dhe ndaj e kanë burgosë. Janë dy gjëra, nëse dikush ka hyrë në burg nga shpifjet e spiunimet e spiunëve, atëherë nuk ka faj, le të ndëshkohen e turpërohen spiunët. Por, nëse dikush ka pasur veprimtarinë kundër Jugosllavisë dhe e ka bërë me ndërgjegje, është kapë



e ka bërë burg, pse duhet t'i tregojë me gisht spiunët. Si në Shqipëri, ke qenë apo nuk ke qenë kundër partisë. Nëse ke qenë kundër partisë dhe je dënuar si anti parti, pse fajëson spiunët. Nëse ke shkruar poezi a letërsi kundër partisë, pranoje burgun dhe mos fajëso spiunët. Nëse nuk ke letërsi kundër partisë, por kanë shpifur spiunët, atëherë duhen ndëshkuar spiunët për shpifje.

HEJZA: Periudha komuniste, nëpër të cilën kaloi edhe populli shqiptar, prodhoi "artin zyrtar" që e luftonte dekadencën, hermetizmin, "artin për art". Me rënien e kësaj "ideologjie të kuqe" u përmbysën shumë vlera ideologjike, koncepte e mentalitete, por jo edhe krijimtaria e përgjithshme kulturore e kësaj periudhe! Ndodhi kjo, sepse ne shquhemi si harrestarë të së kaluarës, sado e afërt qoftë ajo, apo, sepse, patëm nevojë për një "mutacion gjenetik" që do të na rikthejë drejt evropianizimit të qenësisë sonë?

R. SHAHU: Nuk ka një gjykatë ende dhe as do të ketë për ta gjykuar atë periudhë e gjithë periudhat tona. Kur u shemb komunizmi, shumë shqiptarë ikën nga vendi. Sistemi që u instalua kishte probleme mbijetese, urie. Ndikimi i sistemit të kaluar 50 vjeçar ishte kapilar. Ngaqë zgjati shumë komunizmi, kishte arrit të deformonte gjithçka. Kur ra komunizmi, u bënë krushqitë e reja të viktimizeve me xhelatët. Xhelatët arritën të marrin dëshmi persekucioni nga viktimat që i lëshonin këto dëshmi. Fëmijët e prokurorit a të hetuesit, a të instruktorit të partisë u martuan me fëmijët e të dënuarit, me fëmijët e armikut, u bënë krushqi miqtë me armiqtë. Pinin bashkë kafe e raki sigurimsi, hetuesi me ish të burgosurin prej tij, pra xhelati e viktima pinin kafe e raki bashke dhe paguante viktima me këmbënguljen e tij. Kjo pyetje që keni bërë kërkon shpjegim të gjatë të thelluar se kjo është pjesa më e pa shkruar, më e pandriçuar e jetës shqiptare. Nuk e ka treguar letërsia çfare ka ndodhë në psikikën e këtyre njerëzve. Tregimi në thellësi e me ndershmëri i kësaj historie është çelësi i historisë shqiptare të postkomunizmit. Po kjo njëllj përthyeret dhe në Kosovë, edhe pse parullat atje janë shpesh më të ashpra. Por pyetjet mbeten pa përgjigje kur thua, pse ministri i brendshëm i Kosovës që e vrasin serbët, ka qenë i keq e ministri i jashtëm që e zhdukun serbët, ka qenë i mirë.

HEJZA: Historia jonë më e re ka shënuar mijëra ngjarje nga më të trishtat dhe nga më të papërjetuarat nga askush në këtë kontinent! Pra, ndonëse kemi po aq shumë tema të freskëta, ne lajtmotivet edhe më tej i kërkojmë në lashtësi, në mitologji e në folklor. Letërsia jonë, teatrot tona, assesi të trajtojnë gjenocidin serb, tradhtinë, përdhunimet, eksodin shqiptar. Apo, temat e tilla nuk janë të përshtatshme, meqë "do të nxisin urrejtje dhe konflikte ndër-etnike"?

R. SHAHU: Frika dhe pazotësia bën të mos shkruhet për temat tronditëse të fatit e historisë tonë. Popull i vogël, fat i vogël, gjuhë e vogël, shkrimtar të vegjël. Ndonëse kaloi çerek shekulli pas luftës për Kosovën, ende nuk është shkruar në letërsi ajo luftë. Vazhdojmë ende me kronika, monografi, dëshmi, por jo me letërsi sa duhet. Ndonjë vepër letrare është bërë, por si kronike gazetareske. Ndonëse nuk e kam të lehtë të gjykoj drejt apo të jem i saktë e i drejtë sepse njohja është e mangët, por flas nga perceptimi që më është krijuar. Ne duhet të kthjellemi si popull njëherë, t'i këpusim telat e çiftelisë, të ndalojmë rrenat ndaj vetes e fëmijëve tanë. Sa kemi luftuar, sa jemi çliruar, a e kemi të fituar apo e kemi të dhuruar lirinë, pse falsifikojmë pa pushim, pse na pëlqen të mashtrohemi, të gënjehemi. Nuk mendoj se duhet të rrimë e të qajmë për çfarë na ndodhi në lufte, pasi ka qenë luftë, jo mbrëmje vallëzimi, ka qenë shpërngulje masive me dhunë. Miliona përdhunime kanë bërë rusët në Gjermani e Austri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Krimet e tilla të luftës nuk shërohen me qarje e lot. Jeta nën Serbi e me serbët për gati një shekull në Kosovë e hapësirën shqiptare të ish Jugosllavisë, mendoj se nuk është shkruar nga

letërsia, ose nëse është shkruar, nuk është e njohur kjo letërsi. Por, të mos harrojmë se nuk ka qenë një shekull apo 80 vjet vetëm luftë. Këto janë tema të mëdha që duan pena të mëdha. Duhet të shkruhen për të heqë kompleksin e shoqërisë. Të mos harrojmë se në raste luftërash popujt ikin, zhvendosen siç ikën shqiptarët në 1998-1999. Por, rrallë popull kthehet aq masivisht sa u kthyen shqiptarët e Kosovës në 1999 nëpër bomba e predha të pushpërthyerë në oborret, rrënojat e tyre. Shih sa milionë boshnjakë nuk u kthyen më në Bosnje. Shkurt Shkëlzen, temat e tilla duan shkrimtarë të mëdhenj. Historia e komunizmit në Shqipëri do shkrimtarë të mëdhenj. Ne kemi probleme me veten, ne kemi treguar një dashuri të çuditshme për serbet si shqiptare në tërësi. Në vitin 1941 kur erdhi Gjermania në Jugosllavi, për pak ditë arriti ta dëbonte Serbinë prej Kosove dhe Gjermania bëri bashkë Kosovën me Shqipërinë, krijoi shtetin kombëtar shqiptar me administratë shqiptare, me parlament kombëtar, me qeveri kombëtare. Shqiptarët që drejtuan atë shtet shqiptar, Serbia i ka shpallë armiq të saj, por edhe Shqipëria edhe Kosova i ka shpallë armiq, tradhtarë, kolaboracionistë, i ka dënuar, vrazë e masakruar. Cili është morali këtu? Ti që ke ëndërruar gjithë jetën të çlirohesh prej Serbisë, u çlirove. Gjermanët të çliruan, pse i shpall armiq njerëzit që ndërmjetësuan te gjermanët dhe e drejtuan shtetin shqiptar. Njëllor sikur sot të shpallen armiq të gjithë ata shqiptarë që bashkëpunuan me amerikanët e NATON që e çliruan Kosovën në 1999. Serbet na krijuan partinë komuniste, jugosllavët e serbët ishin gjithmonë nëndetëse në politikën e Tiranës, në politikën shqiptare në tërësi.

HEJZA: *Thonë se armiku në luftë e arrin kulmin e kriminalitetit në momentin kur fillon t'ia dëgjë librat kundërshtarit. Në luftën e fundit kundër okupatorit serb, armiku në Kosovë dogji shumë shtëpi, shumë libra. Në tërheqje mori miliona dokumente, libra administrative, kadastrale, artefakte arkeologjike, muzeale... Dhe, fatkeqësisht askush nuk ia doli deri më sot, të paktën të bënte një film të metrazhit të gjatë, apo një dramë që do ta trajtonte artistikisht këtë lloj armiku! Filmi boshnjak "Në tokën e askujt" që mori çmimin "Oskar", arriti që të ndikojë të 80 për qind e opinionit amerikan të dëgjojnë për herë të parë për boshnjakët, përkatësisht të kuptojnë se çfarë kishte ndodhur në Bosnjë dhe me boshnjakët. Pra, e bëri një film atë që nuk e bëri lufta që zgjati plotë katër vite!*

R. SHAHU: Kjo ndodhi edhe në Shqipëri në 1997, ku armiku shqiptar u tregua më i keq se armiku jo shqiptar në Kosovë. Nuk jemi popull i librit dhe shkrimtarët e artistët tanë duan të jenë të parët në katundin e tyre, nuk guxojnë të konkurrojnë e të hyjnë not në oqean, u mjafton më mirë i pari në katund se i fundit në qytet.

Neve do të na mbajë mend bota me armë në duar duke qëlluar qiellin në 1997 në Shqipëri, me tre gishtat lart në Vlorë, duke qarë, lot burrash, grash e fëmijësh, me trasta e fëmijë në krahë duke ikë në 1999, duke puthë makinat gjermane e duart e ushtarëve gjermanë kur hynë në Kosovë në 1999. Ne nuk diktuam dot asgjë, nuk kishim fuqi të diktonim, ne iu lutëm qiellit dhe në fakt nga qielli na erdhi liria e Kosovës, nga një luftë 78 ditore në qiell e Amerikës e NATOS, nga qielli erdhi liria jonë. Pasuria shkresore e grabitur është mungesë e rëndë. Arkivat, arkivat e shërbimeve sekrete janë mina që mund t'i shpërtheje kur të dojë Serbia. Mirë që nuk i bëjmë vetë filmat e mëdhenj, por Kosova i ka pasur dhe i ka mundësitë ta financojë një film të madh, pasi shqiptarët e Kosovës munden, kanë potencial financiar për këtë gjë, Kosova ka diasporën më patriotë në botë.

HEJZA: *Subjektet tona politike, a kanë nevojë për një "Manual të politikave kulturore kombëtare", me peshë të një "kushtetute kulturore", pa njohjen e së cilës, nuk do të guxonin të drejtojnë shtet?*

R. SHAHU: Jo kanë nevojë, por subjekteve



politike shqiptare kjo u mungon në mënyrën më dramatike. Mungesa e kulturës dhe mungesa e investimeve në kulturë është tronditëse, është mungesa më e rëndë e shqiptarëve. Pasuria më e bukur e shqiptarëve është tradita, trashëgimia e cila është vlerë që na bën interesantë, nuk mund të konkurrojmë me ndonjë gjë tjetër.

HEJZA: *A është i lehtë bashkimi kombëtar në sferën e kulturës. A na pengon dikush që të kemi institucione kombëtare reprezentative: një shtëpi botuese nacionale, një filarmoni kombëtare, një balet kombëtar, një teatër, një produksion filmi, një galeri kombëtare një akademi shqiptare etj?*

R. SHAHU: Është e lehtë, e mundshme, vetëm kërkon pak dashuri e pak përkushtim, kërkon disa njerëz idealistë e jo matrapazë e tregtarë. Duke punuar gjatë gazetar kam kërkuar, fol e shkruar se është e mundshme, më shumë se e domosdoshme krijimi i një televizionit kombëtar që kur të japë lajmet të mos thotë lajme nga Kosova apo lajme nga Maqedonia a Mali i Zi, por ta thotë qartë e kthjellë p.sh sot në Strugë..., a sot në Lipjan... a sot në Tuz... a Bujanovc... siç thotë sot në Shkodër apo sot në Tepelenë... Televizionet janë biznese private që vjelin mjaft donacione e reklama shtetërore. Po të ketë vullnet, bëhet një televizion kombëtar dhe mbahet prej profesionistësh. Por, bëhet edhe televizioni publik i Tiranës i tillë po të duan politikanët e hapësirës shqiptare. Bëhet një gazetë kombëtare që të dalë në treg në mëngjes në gjithë qytetet shqiptare. Por, meqë çdo gjë do nismë politikanësh, ne fatkeqësisht politikanët nuk i kemi me përmasa të tilla, i kemi politikanë të vegjël katundesh. Vetëm me fondet e reklamave që japin qeveritë shqiptare pushtetet vendore shqiptare në gjithë hapësirën shqiptare mbulohet pjesa më e madhe e shpenzimeve. Por, kemi inferioritete të thella. Askush nuk na pengon ta shpërndajmë librin shqip në gjithë hapësirën shqiptare, por ky lloj biznesi kërkon mbështetje nga qeveritë shqiptare. Libri sot nuk vjen nga Prishtina a Shkupi në Bibliotekën kombëtare në Tiranë dhe as nga Tirana nuk shkon në Bibliotekën e Prishtinës a Shkupit. Se politikanët shqiptarë nuk janë produkte të librit në pjesën dërrmuese. Se ministrat e kulturës nuk zgjidhen nga autoritete letrare, se ambasadorët shqiptarë në vendet tona nuk vijnë nga bota e librit dhe kulturës, por militantë të partive. Vetëm kultura e gjuha, libri, arti e sporti mund ta mbajnë e bëjnë shpirtërisht të bashkuar kombin shqiptar, martesat e krushqitë e asgjë tjetër. Vetëm duke vënë njerëz të shquar e të spikatur në detyra që kanë të bëjnë me këto probleme, mund të ecin punët përpara, por me zyrtarë anonimë, me autorë anonimë, me "nafije" partish nuk bëhen punë kombëtare. Për të pasur një shtëpi botuese kombëtare referuese, duhet

minimalisht të mbështetet pjesërisht nga qeveritë shqiptare, nga ministritë përkatëse, por mosdakortësia është prezent, lakmia për copën e madhe minon çdo gjë. Ishte Rilindja shtëpia e madhe shqiptare e librit që botonte edhe autorë të zgjedhur nga Tirana, pra e kemi pasur një model që mund ta përsosnim. Me fondet shtetërore për pasurim bibliotekash mund të mbahej një shtëpi botuese kombëtare që e ka të garantuar shitjen e librave bibliotekave me fonde shtetërore. Por, sot librat e autorëve shqiptarë jashtë kufijve shtetërorë, nuk vijnë në bibliotekat e qyteteve e shkollave të Shqipërisë. Po janë 100 autorë shqiptarë jashtë kufijve të Shqipërisë që duhet të jenë në bibliotekat e Shqipërisë. Por, nuk mendon askush për këtë gjë fatkeqësisht nga institucionet shqiptare të kulturës kudo, nuk qarkullon libri shqip, nuk njihen shkrimtarët shqiptarë në gjithë hapësirat shqiptare. Institucionet kulturore kombëtare nuk na ndalon askush t'i bëjmë, veç na ndalon mediokriteti ynë, paaftësia jonë, pazotësia jonë. Zyrtarët tanë kujtojnë se konkurrojmë me industri të rëndë, me industri ushtarake. Jo, ne kemi fusha të tjera ku konkurrojmë e mund të bëhemi të dobishëm e të pranueshëm për vete e të fusim gjurin në sofrën e Europës. Vlerat tona të traditës vlejné nëse dimë t'i ofrojmë, prodhimet tona bio vlejné nëse dimë t'i shesim, për gjysmë shekulli ne kemi nxjerrë një Kadare të pranuar botërisht. Tani kemi edhe sharlatanë që deklarohen se jam botuar në 30 a 40 gjuhë, por kuptojmë se në tirazhe 5 a 10 libra mund të botohesh në qindra gjuhe me fondet e tua...

HEJZA: *Megjithatë, revista letrare Illz, po arrin ta bëjë bashkimin e autorëve nga të gjitha hapësirat shqiptare. Çfarë, në fakt, paraqet revista Illz dhe a po e realizon misionin e saj në këto kohë kur realisht kemi kriza të madhe të leximit?*

R. SHAHU: Illz, kjo shtëpi e bukur shkrimtarësh, u bë 10 vjeç dhe deri tani botoi numrin 53 të saj. Mund të flas për revistën illz, pasi jam botuesi e kryeredaktori i saj. Në 53 numra reviste në rreth 12500 faqe të shtypura në formatin B/5 me gërmë 11, bashkë me dy numrat specialë 10 e 14, me nga 500 faqe, për Skënderbeun dhe shkrimtarët martirë, kanë shkruar në revistë mbi 3500 autorë e përkthyes, të cilët meritojnë pafund falënderime e mirënjohje. Ata i dhanë dritë nga drita e shpirtit të tyre kësaj shtëpie shkrimtarësh, duke shkruar kështu një faqe të ndritshme në historinë e letërsisë shqipe, duke u shndërruar në një trashëgimi që patjetër koha do t'i japë vlerë. illz është organ i shtëpisë botuese Klubi i Poezisë, të cilën e kam unë. Pra, administrativisht jam botuesi i revistës illz. Por revista botohet e jeton falë një trekëndëshi të bukur miqsh Flamur Hoxha, Izet Duraku, Rexhep Shahu. Kjo revistë nuk e mendon asnjë

çast qenien e saj si revistë e Shqipërisë administrative, jo, ajo është konceptuar si reviste e hapësirës shqiptare, si revistë letrare e republikës së gjuhës shqipe, si revistë e republikës së letrave shqipe, pastaj si reviste rajonale, ballkanike e më gjerë, ia kemi heqë kufijtë, dhe do të vazhdojmë ta përsosim. Nëse flasim me gjuhë teknike, arkitekt i revistës illz është miku im, Izet Duraku - drejtori i saj që edhe e ka pagëzuar revistën me emrin që ka. Pa Izetin nuk do të ishte bërë kjo revistë letrare, kështu siç është. Unë jam inxhinieri i zbatimit për ndërtimin e kësaj reviste. Dhe jam shumë i gëzuar që ia dolëm pa përkrahje shteti, pa përkrahje mediash, ia dolëm. Ta kishte bërë ndonjë shkrimtar partie këtë revistë, sot në numër 53, do të gjëmonin ekranet e televizioneve të pushtetit. Kjo revistë illzash është një libër i madh dashurie, nuk është revistë biznesi pasi edhe 99 % e atyre që po i lexojnë e mund t'i lexojnë këto fjalë, nuk e kanë blerë asnjë numër reviste. Ne nuk e bëjmë dot revistën gazetë dhe do t'i largohemi përditë e më shumë gazetës. Mua dhe Izetit do të na tereshin ëndrrat në telat e zogjve po të mos ishte Flamur Hoxha, një sipërmarrës atipik shpirtbukur shqiptar, i cili e ka sponsorizuar printimin e kësaj reviste që nga dita e parë pa kushte, pa asnjë lloj ndërhyrje në punët e revistës një dekadë me radhë, 6 herë në vit. Humanisti deputet i PD, Flamur Hoxha, ndryshe nga sipërmarrës të tjerë që ngrenë perandori biznesi me fonde tenderash qeveritare, që ndërtojnë e dhurojnë shtëpia a vila, pranoi të sponsorizojë krijimin e revistës illz, kësaj shtëpie shkrimtarësh. Poeti Petrit Ruka e krahasonte Flamurin me Anastas Lakcen që sponsorizoi librat e poetit kombëtar Naim Frashëri. Shkrimtari Zija Çela e ka cilësuar Flamurin "deputeti i letërsisë", Shkrimtari Mehmet Elezi e quan "perandor i vogël në perandorinë e madhe të Librit". Po ashtu poetët Bardhyl Londo, Sadik Bejko e të tjerë e kanë vlerësuar kontributin e përveçëm të deputetit humanist Flamur Hoxha, falë të cilit kemi në dorë 53 revista illz, një libër të madh dashurie që nuk e kanë bërë dot institucionet as universitetet publike e private. Ndaj, me shumë përzemësi, faleminderit po i them Flamurit edhe nga dritarja e revistës HEJZA. Kur është themeluar e formatuar kjo revistë një dekadë më parë, e në vazhdimësi, një kontribut të veçantë e special ka dhënë miku ynë i përhershëm, akademik Shaban Sinani për ndërtimin e rubrikave të revistës, me studime të herëpashershme dhe në rekomandimin për disa anëtarë bordi për revistën.Revistën illz nuk e ka ngritë bordi, por revista ka ngritë bordin e saj. Në startin e ri për 100 numrat e tjerë të illz, do të kemi një bord më aktiv, më pjesëmarrës e kontribuues. Në 50 numrat e parë të revistës illz jemi përpjekë që autorët e hapësirës shqiptare "të republikës së gjuhës shqipe" të jenë të përfaqësuar dinjitetshëm. Revista vërtetë ka shënimin "revistë letrare e Tiranës", por kjo është vetëm për shkak se Tirana është aktualisht kryeqyteti më i madh i shqiptarëve. Por, po aq sa është revistë e Tiranës, aq është edhe e Prishtinës, e Shkupit a e Ulqinit dhe gjithë autorëve shqiptarë e jo shqiptarë kudo ku janë në botë. Këtë e vërteton lënda e revistës që nuk përjashton askënd dhe është e hapur për fjalën e bukur. Revista illz ka tentuar e do të tentojë të jetë illz për vendet fqinje, pasi ne kemi idenë se urat që ngre letërsia nuk i shemb dot urrejtja. Ndoshta u zgjata për revistën, por e çmtoj dhe e di se kjo revistë është bërë tani një vlerë e përveçme e pashmangshme, si një kurorë për letrat shqipe. Revista gjithmonë ka nevojë për shkrimtarët, se ata janë lumenjtë e këtij deti. Ka nevojë edhe të sjellin shkrime, por edhe ta promovojnë. Është dëshpëruese që shkrimtarë që punojnë si gazetarë, nuk i kushtojnë kurrë hapësirë revistës e prezantimit të saj në mediat ku ata punojnë. Revista ka dhënë e po jep prova se bën edhe pa mediat e tjera, se nuk është revistë propagande ditore, nuk jeton me reklama, ajo e ka bastin me historinë e letrave shqipe jo me aktualitetin, nuk i dëgjon zhurmat e ditës, por gazetarët shkrimtarë mos të dërgojnë pra krijimtarinë e tyre për botim në revistë, të paktën të mos këmbëngulin të botojnë në çdo numër. Kjo është dëshpëruese.

Ese

PESIMIZMI I TEATRIT

Bota e qytetëruar e zbulon "tragjedinë e vet njerëzore" vetëm në skenën e teatrit. Kurse nëpër komeditë e lira dhe te melodramat demode ka njëfarë optimizmi. Pjesët serioze i përshkon pesimizmi



Alija IZETBEGOVIQ

Është përnjëmend simptomatike kur nga vendet e pa-sura dhe të zhvilluara vjen filozofia më ogurzezë. Le të kujtojmë autorë si Ibsen, Heidegger, Mailer, Pinter, Beckett, Marcuse, O'Neil, Bergman, Camus, Antonioni e shumë të tjerë. Diç më shumë optimizëm hasim akoma te shkencëtarët, të cilët kryesisht merren me pamjen e jashtme të gjërave. Mendimtarët dhe artistët janë të shqetësuar, sidomos këta të fundit. Në pamje të parë duket sikur pesimizmi fillon kur procesi alfabetizues arrin t'i përfshijë të gjithë; kur funksionon sigurimi social dhe kur të ardhurat kombëtare për banor shkojnë 1.000 dollarë. Filozofia skandinave e fundit të shekullit XIX dhe e fillimit të shekullit XX ka një pesimizëm të theksuar. Sipas saj, fati njerëzor është medoemos tragjik: errësira dhe hiçi janë pasojat e mbrame të përpjekjeve njerëzore në kërkim të rrugëdaljes. Kjo filozofi mbiu që në fillim të shek. XX, bashkë me aty ku s'kishte më analfabetë, dhe kur pjesa jugore e Europës vazhdonte të kënaqej me "injurancën e bekuar". Jemi para sprovës të pyesim se a mos ndërmjet sigurimit social suedez, tani më të përsosur në botë, dhe ndjenjës së dëshpërimit e të përhumbjes ka ndonjë lidhje. Mos ndoshta ndjenja e sigurisë materiale lind ndjenjën e përhumbjes shpirtërore? Pavarësisht dinamikës së jashtme, që gjithsesi mbetet një trajtë shajnie (dinamika e jetës shoqërore dhe politike), qytetërimi karakterizohet nga një ritëm i ngadalësuar i jetës së brendshme. Dramat e absurdit janë pamje besnike të jetës së njerëzve në shoqëritë më të zhvilluara bashkëkohore. Luksi është fytyra e jetës në qytetërim, kurse absurdi fytyra që nuk duket, me dialektikën sa më shumë luks e kamje, aq

më shumë ndjenjë absurdi e çorientim. Anasjelltas, shoqëritë primitive mund të jenë të varfra e të tronditura nga dallimet e mëdha sociale, mirëpo të gjitha dëshmitë që kemi për to flasin për ndjenja të forta e të kthjellëta, me të cilat ngjyroset jeta e tyre. Veçanërisht folklori, "letërsia e shoqërisë primitive", na paraqet një forcë e jashtëzakonshme jete dhe plotinë e ndjenjave të njeriut të primitiv. Kjo shoqëri e varfër nuk e njeh fare ndjenjën e përhumbjes e të absurdit. Bota e qytetëruar e zbulon "tragjedinë e vet njerëzore" vetëm në skenën e teatrit. Kurse nëpër komeditë e lira dhe te melodramat demode ka njëfarë optimizmi. Pjesët serioze i përshkon pesimizmi. Teatri ia heq vazhdimisht breroren e përsosmërisë qytetërimin, dhe shkenca ia vendos rishtazi. Shkenca i imponon gjithnjë me brutalitet të dhënat e saj për sasinë e prodhimeve, me indeksat e produktivitetit masiv, me energjinë e fuqisë njerëzore, me varfërinë intelektuale e morale, me dhunë, me përbindshmëri e absurd. Në një botë të begatë, midis gjithë pasurisë e fuqisë, teatri zbulon njeriun agresiv, të rrëmbyer nga veset, të rënë. Poetët janë antenat e ndjeshme të njerëzimit. Duke gjuar sipas drojës dhe dyshimeve të tyre, bota nuk ecën drejt humanizimit, por drejt dehumanizimit, drejt një tjetërsimi të hapur. Më 1971 u vetëvra Kavabata, fitues i Çmimit Nobel për letërsi (1968), një prej personaliteteve më të shquara të letërsisë bashkëkohore. Para tij, më 1969, po njësoj i dha fund jetës një tjetër romancier japonez - Mishima. Që nga viti 1895 e gjer më sot janë vetëvra të trembëdhjetë shkrimtarë japonezë, ku një ndër ta është edhe autori i famshëm i Rashomonit, Agutagava. Kjo "tragjedi në vazhdimësi" e kulturës japoneze përkon me depërtimin e qytetërimin perëndimor dhe të botëkuptimeve materialiste në kulturën tradicionale të Japonisë. Cilido

qoftë ai, për shkrimtarët e tragjedive dhe për poetët qytetërimi do të ketë përherë një fytyrë jonjerëzore, e cila e kërcënon vazhdimisht njeriun. Një vit para se të vdiste, Kavabata shkroi këto radhë: "Njerëzit janë ndarë nga njëri-tjetri me një mur prej betoni, i cili pengon çdo rrjedhë të dashurisë. Natyra masakrohet në emër të zhvillimit." Te romani Toka e borës (1937), në qendër të meditimeve të Kavabatës është çështja e vetmisë dhe e tjetërsimit të njeriut në botën bashkëkohore. Të gjithë përfaqësuesit e mëdhenj të kulturës e shohin në të njëjtën mënyrë këtë dëshitim të njeriut në qytetërim. André Malraux pyet se cili ishte rezultati përfundimtar i shpresës dhe i optimizmit të shekullit XIX, dhe përgjigjet: "Kjo është Europa e shkretuar dhe e gjakosur, që nuk është më e shkretuar dhe më e gjakosur se shëmbëlltyra e njeriut që shpresonte se do të krijonte. E njëjta pamje iu fanit edhe Valéry-së menjëherë pas Luftës së Parë Botërore. Më 1919 ai shkruan: "Ekziston iluzioni i humbur i një kulture europiane dhe dëshmia e pafuqisë së njohjes për të shpëtuar çfarëdo qoftë. Ekziston shkenca e goditur për vdekje në ambiciet e saj morale, dhe e shndërruar nga egërsia e aplikimeve. Ekziston idealizmi që ngadhënjeu me zor, i thërrmuar deri në fund, përgjegjës për ëndrrat e veta; realizmi i zhgënjyer, i mundur, i bërë pluhur nga barra e krimeve dhe e gabimeve; babëzia dhe vetëmohimi njësoj të përqeshur, besimet e përziera nëpër kohë; kryqi kundër kryqit, gjysmëhëna kundër gjysmëhënës. Ekzistojnë edhe skeptikët, të befasuara në një vorbull ngjarjesh kaq të rrafshme, kaq të ashpra, kaq tronditëse, që luajnë me mendimet tona si macja me miun. Skeptikët humbasin dyshimet e tyre, i gjejnë rishmi, përsëri i humbasin, dhe nuk e dinë se më shumë shërbehen me kthesat e shpirtit të tyre." Nihilizmi dhe filozofia e absurdit janë frytet e pjesës më

të pasur e më të qytetëruar të botës. Kjo filozofi flet për "mungesën e perspektivës në botë", për "individin e shtresuar e të çintegruar nga ana psikike", për "botën e heshtjes shurdhmemece" etj. Kjo nuk është kurrsesi një filozofi helmuese, siç e quajnë disa. Në të vërtetë, ajo është shumë e thellë dhe edukuese. Ajo është shprehje e rezistencës së njeriut, e kundërshtimit të njeriut ndaj një bote që zhvillohet dhe rritet përkundër përfytyrimeve rreth saj. Ky është rebelimi i njeriut kundër botës njëdimensionale të qytetërimin (Camus: Njeriu i revoltuar dhe Marcuse: Njeriu njëdimensional). Duke pasur parasysh këtë, nihilizmin modern disa e morën si një formë religjioni, dhe jo pa arsye. Të dyja qasjet paraqesin mohimin e materializmit dhe e qortojnë këtë botë me të njëjtin nocion. Që të dyja kanë të përbashkët atë ankh të stërlashtë, atë shikim përtej varrit, atë kërkim dëshpërues për të dalë nga një botë ku njeriu e ndien veten të huaj (Camus, I huaji). Ato ndryshojnë në lidhje me faktin se nihilizmi nuk e gjen dot daljen, kurse religjioni mëton se e ka gjetur. Dështimi i qytetërimin që përmes shkencës së tij, fuqisë dhe pasurisë të zgjidhë çështjen e lumturisë njerëzore, kur të jetë kuptuar e më pas të pranohet, do të bëjë një përshtypje të madhe psikologjike te njerëzimi. Ky do të jetë filli-mi i zgjimit dhe i rishqyrtimit të disa prej botëkuptimeve tona elementare të pranuar nga të gjithë. Një ndër paragjykimet e para që do të goditet do të jetë paragjykimi i shkencës për njeriun; sepse, në qoftë se shkencën nuk e zgjidh çështjen e lumturisë njerëzore, atëherë vizioni religjioz për origjinën e njeriut është i vërtetë, ndërsa ai shkencor i rremë. Mundësi të tretë nuk ka.

(Nga boshnjakishtja: Eqrem Kryeziu)


George Orwell, "1984"

FRIKA NGA LIRIA

Përmes një rrëfimi të errët dhe tronditës, Orwell eksploron fuqinë e propagandës, manipulimin e së vërtetës dhe humbjen e lirisë njerëzore në një shoqëri ku çdo mendim dhe veprim është i mbikëqyrtur

Ervina TOPTANI

Romani "1984" i George Orwell është një nga veprat më të rëndësishme dhe të fuqishme të letërsisë distopike, e botuar në vitin 1949 nga George Orwell, emri i vërtetë i të cilit është Eric Arthur Blair, me profesion gazetar. Romani përshkruan një botë totalitare ku individët jetojnë nën kontrollin e rreptë të Partisë, e udhëhequr nga figura e padukshme e Vëllait të Madh (Big Brother). Përmes një rrëfimi të errët dhe tronditës, Orwell eksploron fuqinë e propagandës, manipulimin e së vërtetës dhe humbjen e lirisë njerëzore në një shoqëri ku çdo mendim dhe veprim është i mbikëqyrtur. Personazhi kryesor i romanit është Winston Smith, një burrë që jeton në Oqeani, një shtet i kontrolluar nga Partia. Jeta e përditshme është e mbushur me survejim të vazhdueshëm nga «telescreen-ët» që janë pajisjet që transmetojnë propagandën e partisë dhe me frikën e Policisë së Mendimeve, e cila ndëshkon çdo mendim kundër regjimit. Partia manipulon realitetin duke ndryshuar historinë dhe gjuhën përmes "Gjuhës së Re" (Newspeak), një formë e re e gjuhës që synon të kufizojë mendimin kritik. Pavarësisht frikës dhe presionit, Winston fillon të dyshojë te sistemi dhe ëndërron për një botë më të lirë. Ai nis një lidhje sekrete me Julian, një grua rebele, dhe të dy përpiqen të sfidojnë Partinë. Së bashku, ata kërkojnë shpëtim te "Vëllazëria", një organizatë e supozuar që kundërshton regjimin. Por, Winston dhe Julia tradhtohen dhe arrestohen nga O'Brien, një anëtar i Partisë së Brendshme, që ishte elita e vërtetë sunduese e shtetit totalitar, i cili shfaqet si rebel, por në fakt është një agjent besnik i sistemit. Në Dhomën 101, Winston i nënshtrohet torturave psikologjike dhe fizike deri sa humb çdo ndjenjë rezistence. Në fund, ai dorëzohet plotësisht, pranon autoritetin e Partisë



dhe më e tmerrshme është që fillon ta dojë "Vëllain e Madh". Është një libër që

besoj se diktatori shqiptar dhe jo vetëm ai e kanë pasur si busull në ndjekjen me përpikëri të mbikëqyrjes dhe kontrollit totalitar të shoqërisë ku çdo aspekt i jetës monitorohet nga shteti. Manipulimi i së vërtetës dhe historia që ndryshohet vazhdimisht e ndjekur nga dhuna dhe injektimi i frikës janë armët e forta që i përshtaten narrativës së Partisë, duke treguar fuqinë e propagandës dhe ndikimin e saj mbi mendjen e njerëzve. Liria mbetet diçka utopike prej së cilës njerëzit kanë frikë, pavarësisht se nuk e njohin atë. Frika është elementi bazë që përshkon gjithë ecurinë historike të këtyre vendeve fatkeqe si i yni dhe në këtë roman tregohet më së miri sesi frika e ndëshkimit mund ta shkatërrojë shpirtin njerëzor. Edhe vetë dashuria si element ekzistues në jetën e njeriut, e cila në roman simbolizon shpresën, përfundon si një mjet që Partia e përdor për të shkatërruar njerëzit. Gjuha që njerëzit e përdorin si mjet komunikimi kthehet në fakt në mjet për të formuar realitetin e partisë dhe për të kufizuar në maksimum lirinë e mendimit. Njësoj si Machiavelli me "Princin" e tij, si Maurice Jolie me "Dialog në ferr", edhe Orwell me "1984" i kanë shërbyer njerëzimit duke i ndezur fanarin e mendimit për të mos gabuar e për të mos minuar jetën e tyre e të brezave që vijnë, por në shoqëritë ku ka mbizotëruar injoranca dhe pandërgjegjia e kësaj injoranca, diktatorët, politikanët meskinë e shpirtzinj i kanë parë këto kryevepra si mundësi suksesi për veten e tyre, duke i zbatuar ato pikë për pikë e duke i çuar popujt drejt humnerës ku një shembull i këtij shkatërrimi është Shqipëria. Nuk e di nëse ky libër studiohet në shkollat e mesme në Shqipëri e nëse nuk studiohet atëherë do të vazhdojmë pambarimisht të jemi nën trysinë e pandërgjegjjes për injorancën tonë. Shkurt, do të jemi përjetësisht të mallkuar për të mos dalë nga qerthulli i politikanëve shpirtzinj.

Reflekse

MITRUSH KUTELI, KY RRËFENJËS MAGJIK I PËRRALLAVE POPULLORE

(Interpretim, veçanërisht, për librin "Tregime të moçme shqiptare" (Botime "Kuteli '04", ilustrimet: Gazmend Leka, Tiranë 2017)

Xhahid BUSHATI

Studiuesit dhe kritika letrare e kanë vlerësuar Mitrush Kutelin si Mjeshtër i Fjalës shqipe. Një mjeshtër i rrallë! Krijoi një botë letrare. Në këtë botë zë vend dhe Letërsia e tij që shkroi për fëmijë. Në këtë udhëtim, autori u shfaq: përrallëtar, poet e përkthyes. Ritregimin dhe rrëfimin e përrallave, legjendave, baladave... etj., e shohim te "Tregime të moçme shqiptare" dhe "Xinxifilloja"; ndjeshmërinë poetike e shohim te poema "Pylli i gështenjave"; përkthimet e këndshme e shohim te "Përralla të zgjedhura" e "Piktori i vogël që bënte mrekullira", etj. Duam të rikujtojmë se në 10-vjeçarin e fundit të jetës së autorit, lidhjet e Kutelit me folklorin bëhen më të ngushta e më produktive. Autori, kësaj here vihet në rolin e përpunuesit dhe të ritreguesit të krijimtarisë popullore. Veçanërisht te libri "Tregime të moçme shqiptare" Mitrush nuk ka marrë përsipër t'i rikrijojë e ndryshojë motivet, heronjtë, ngjarjet e folklorit; por synon

vetëm t'i ritregojë, por, ama, bukur, saktë dhe duke ruajtur "të paprekur" palcën mrekullidhënëse që mbart përralla e çmueshme popullore. Ne do të ndalemi te libri "Tregimet e moçme shqiptare" dhe do të përmendim disa dukuri që lidhen jo vetëm me mënyrë e konceptimit të krijimit, por edhe me mënyrën sesi Mitrush krijoi personalitetin e tij artistik. Te libri në fjalë, lexuesi vlerëson rrëfimetarë e talentuar, që interpreton me mjeshtëri e mençuri krijimtarinë (eposin) e popullit. Janë një mozaik kallëzimesh. Mbase është vepra e parë e këtij lloji, kur shkrimtari e ritregon poezinë me gjuhën e prozës, duke iu përmbajtur kritereve të letërsisë artistike. Lënda përrallore gjithnjë kalon përmes filtrit të shkrimtarit. Konflikti në përrallat e Kutelit përftohet nga ndeshja ndërmjet dy forcave antagoniste, kategori të njohura në përrallën tonë, në mes të Mirës dhe së Keqes, të Bukurës dhe të Shëmtuarës, të Voglit e të Madhit... ku përherë fiton i pari mbi të dytin. Vepra e Kutelit është e mbrujtur me një frymëmarrje të gjerë popullore. Vetë

autori pohon se ushqimi i tij i përhershëm ka qenë "piksëpari folklori dhe përsëri folklori". "Rrëfimet e mia, shkruan më tej Kuteli në një dorëshkrim janë reflektim i tregimeve të pleqve..." (Letër prof. Vehbi Balës, 15 gusht 1965, dorëshkrim).

Rrëfimi në penën e shkrimtarit u ngrit në një vlerë që nuk ishte parë më parë, duke fituar cilësitë e vërteta të llojit të vet. Ai, jo vetëm krijoi një tip të ri tregimi, por i dha këtij lloji epik vulën e individualitetit të tij. Poetika e rrëfimeve është ajo e rrëfimit popullor, por e përpunuar artistikisht nga Mjeshtri, e kthyer në një mekanizëm të strukturuarit artistik. Këtu, luan rol të rëndësishëm figura e rrëfimitarit, i cili krijon raporte të caktuara me dëgjuesin, me kohën dhe me hapësirën dhe kthehet në personazh unik i gjithë prozës së tij tregimtare. Funkcioni i rrëfimitarit të Kutelit është i gjithanshëm. Rrafshet që përbëjnë këtë gjithanshmëri janë: zbulimi i tipit, - karakteri i personazhit, - përshkrimi i situatës psikologjike dhe i gjendjes shpirtërore, - shtjellimi i konfliktit, - zbulimi i figurës, evidentimi

dhe shenja e detajit... etj.

Te Kuteli përshkrimi është i fuqishëm, karakterizues dhe i harmonishëm. Ndërsa dialogu me monologun, tok me përshkrimin ndërtojnë veprën. Ato shfaqen në situata të caktuara, si një nga burimet e informacionit; por akoma më shumë me funksion tipizues e individualizues.

Po shënojmë edhe tre elementë: - Poetika nuk mund të kuptohet pa poetikën e kompozicionit të rrëfimeve, - Subjekti i rrëfimeve ndërtohet të rrokë gjithë jetën e heroit ose një pjesë të saj, - Gjuha e Kutelit është dhe mbetet thesar i çmuar.

Si përfundim, Mitrush Kuteli përralltar (Mvetësia është thelbi i shkrimtarit; por, mendoj se, nuk mungojnë aty-këtu edhe ndikimet nga letërsia ruse për fëmijë); ashtu si Anderseni, Charl Perró, Vëllazërit Grimm... etj., arrin ta kthejë përrallën popullore në përrallë letrare. I jep asaj botën magjike që e ka në zanafillë si gjini.

Me shkrimtarin GRIGOR JOVANI

NUK T'I SHIKOJNË DORËSHKRIMET, POR XHEPAT!

(Kohë më parë ndërroi jetë Grigor Jovani, një penë shumë e mirë e letërsisë shqiptare. Qysh në fillimet e para platforma HEJZA pati realizuar një intervistë me Jovanin, të cilën, në nderim të tij, për lexuesit e revistës sonë, sërish e publikojmë)



Avni HALIMI

Grigor Jovani u lind në Jorgucat të Gjirokastrës, më 1959. Kaloj fëmijërinë dhe rininë në Laç të Kurbinut. Përfundoi studimet e larta filologjike më 1983, punoi për dy vjet si mësues në Mirditë dhe Krujë, mandej, derisa u largua nga Shqipëria, pas një specializimi për media, ka qenë gazetar profesionist. Më 1991 u shpërngul familjarisht në Athinë, ku jeton edhe sot. Është marrë gjithë kohës me shtypin shqiptar të emigracionit. Prej vitit 2006 boton në Athinë Revistën Letrare dhe Artistike "Pegasi". Shkruan letërsi, poezi dhe prozë, si edhe përkthen letërsi të huaj në shqip. Është vlerësuar për publicistikën dhe krijimtarinë letrare me çmime të ndryshme.

HEJZA: *Larg atdheut, larg vlerave kulturore të kombit, me valixhet plot kujtime, ndrydhur në vetmi e përmallime, lemeritur nga pesha e papërballueshme e asimilimit - ky është motivi krijues, apo, është ai fat që i ndjek të mërguarit për të bërë letërsi të mirëfilltë. Dikur, krijuesit nga diaspora, shqetësimet letrar si rrjedhojë e rebelimit*

shpirtëror anti-pushtet (disidenca), i orientonin në krijimin e kryeveprave në letërsinë tonë shqiptare, sot këtë gjë e bëjnë me qejf, për ta përcjellë traditën e prurjeve të reja në letërsi dhe, përgjithësisht, në kulturë! Apo ndoshta, tashmë, ky vlerësim është demode, sepse, shkrimtari ynë sot, në kohën e globalizmit, kudo qoftë në botë, ai është në atdhe!

JOVANI: Kudo që të ishin do ta bënin letërsinë e tyre. Krijimtaria nuk varet nga vendndodhja e krijuesit, por nga ajo shtysë e brendshme për ta parë dhe shprehur vetveten dhe botën në mënyrë artistike. Shkrimtari është si ai futbollisti ndërkombëtar, që tek fusha me gurë e fëmijërisë kupton së pari që i pëlqen kjo lojë më tepër se gjithçka, pastaj talentin e tij e dallojnë edhe të tjerët, e inkurajojnë të vazhdojë pasionin e jetës dhe pasi shkëlqen në fushat zyrtare të vendit të tij, mund ta bëjë këtë punë po kaq mirë ose akoma më mirë edhe jashtë Atdheut. Veçse jashtë Atdheut dhe në nivelin që ka arritur tashmë talenti i tij ka kushte të tjera, më të favorshme për t'u perfeksionuar. Tani po, krijuesi është në gjendje të pretendojë letërsinë

e mirëfilltë. Nuk ka kohë dhe shans tjetër. Dikur edhe për futbollistët afron fundi i karrierës së tyre... O tani, o kurrë! Prandaj lindin edhe kryeveprat. Një lindje mund të ndodhë kudo, edhe jashtë shtëpisë. Ato që thatë pak më sipër, "vetmia e papërballueshme e përmallimit atdhetar", "lemeria e asimilimit" etj, etj, nuk kanë të bëjnë me punën krijuese. Janë togfjalësja të ngurtësuar, që vijnë nga e kaluara e romantizmit patriotik dhe nuk i përshtaten të vërtetës së kohës që rrojmë, që ju vetë sanksionuat me kaq saktësi: "... shkrimtari ynë sot, në kohën e globalizmit, kudo qoftë në botë, është në atdhe!" Ju kujtohet rrëfimi i Kadaresë, se kur u ndje më në fund qytetar i Parisit? Atëherë kur ndjeu nevojën biologjike të krijimit, u ul tek një cep i kafesë së tij të preferuar në Paris dhe... filloi të shkruajë. Shkrimi është Atdheu i shkrimtarit.

HEJZA: *Gërshetimi i kulturës hispane me kulturën e indigjenëve përgjatë kolonializmit të "kontinentit të ri" (Amerikës), solli deri te "lindja e madhe" e Letërsisë Hispanoamerikane, e cila, botës letrare i dhuroi kryevepra të paarritshme, nxori një plejadë shkrimtarësh mbase të papërsëritshëm ndonjëherë! Mund të*

vërehet ndonjë element i tillë gërshetues te krijimtaria letrare e krijuesve tanë në diasporë?

JOVANI: Më duket se ka një ngatërrim këtu përsa i përket terminologjisë. Unë e di se me termin Letërsi Hispanoamerikane nënkuptojmë letërsinë e madhe të Amerikës Latine, gjatë një kohështrirjeje të gjatë, treqindvjeçare, që përfshin tre epoka, kolonizimin hispanik, kalimin nga klasicizmi tek modernizmi dhe epoka e artë, shek. i 20-të, ku u vulos ndikimi absolut i kulturës së ardhur mbi atë ekzistuesen vendase, gjë që u pasqyrua edhe tek letërsia. Pikërisht kjo periudhë nxori korifenj të tillë letrarë, si Borges, Oneti, Sabato, Rulfo, Garcia Marquez, Cortazar e shumë të tjerë në këto vende në Jug të "kontinentit të vjetër". Nuk e di nëse mund të përfshijmë në këtë term edhe atë letërsi që krijuan të ardhurit e të ashtuquajturit "Perëndim i Largët" ose "i Egër" në pjesën veriore të kontinentit (nuk e di gjithashtu pse u quajt "kontinent i ri"), ku në tokën e pushtuar të indigjenëve u imponua kultura e kolonizuesve evropianë, bashkë me pushtetin e tyre, që sot ekziston në prezencën e kombit

dhe shtetit të madh, SHBA-së. Jo, jo, nuk është e njëjta gjë, më duket... E tërheq "vërejtjen" time, nëse keni parasysh të parën, letërsinë latinoamerikane, por nuk është përcaktuar qartë në pyetjen tuaj... Sidoqoftë, shumë i skajshëm do të ishte krahasimi i këtyre letërsive me atë që krijojnë sot shkrimtarët shqiptarë të Diasporës. Nuk ekzistojnë kushtet përfaqëse, laboratorit gjeopolitik i krijimit është shumë i ndryshëm. Ne nuk u shpërngulëm për t'iu imponuar asnjë kulture vendase, zaten edhe të donim, nuk mund ta bënim këtë. Erdhëm thjesht si hallexhinj, për të jetuar më mirë dhe nëse bëme punën tonë, shkruam vetë më mirë në vazhdim, mbase ndikoi kultura dhe letërsia që gjetëm, ajo vendase. Mbase ishim ne "të asimiluarit". Këtë "fat" kishin dikur edhe të ardhurit e hershëm në këto troje ku u vendosëm ne tani, legjionarët romakë, që ndonëse pushtuan me forcë territoret e Helladës së Lashtë, u gjendën të pushtuar në kulturë prej saj epoka dhe epoka më vonë... Kjo për sa u përket atyre, që si unë, u ngulën këtu në Greqi.

HEJZA: Është më me vlerë ndjekja e traditës për të sjellë "krijime unikalë", apo të bëjmë përpjekje që letërsinë tonë ta sjellim në gjuhën e popujve me të cilët bashkëjetojnë diaspora jonë! Sa stimulohet përkthimi, a kemi përkthyes të mirëfilltë në diasporë. Bibliotekat si dhe libraritë tona, gjithandë viseve etnike, po "gogësinë" nga veprat e përkthyer nga letërsia botërore. Apo ndoshta ndani mendimin se çështja e përkthimit të veprave tona nga shqipja në gjuhë të ndryshme, është problem që duhet ta zgjidhin ekskluzivisht institucionet tona qeveritare dhe nacionale!

JOVANI: Gjuha është identiteti i një kulture, doemos edhe i letërsisë së saj. I përket letërsisë së një kombi, sepse shkruan me gjuhën e tij. Me atë formohesh dhe atë përdor si mjet shprehës. Bashkëfolësve të asaj gjuhe u drejtohen. Kjo nuk ndodh me dekrete. Është një përzgjedhje e brendshme e shkrimtarit. Disa herë nuk ka të bëjë me kombin prej të cilit rrjedh. Kushtëzohet nga rrethanat. Formohesh brenda një kulture, ndërjegjësohesh se i përket asaj dhe përdor mjetet komunikuese që

ajo të disponon. Kjo është punë, teknikë. Vetëm se duke bërë përzgjedhjen e gjuhës, je përcaktuar automatikisht në kulturën përkatëse, në letërsinë e saj. Nuk mendoj se ka shkrimtarë botërorë, ka shkrimtarë kombëtarë që hyjnë pastaj nëpërmjet këtij identiteti tek maza e madhe e botërore. Kjo vetëm mund të jetë rruga e "krijimeve unikalë", siç e përcaktuat ju. Mund të jemi në diasporë, por i përkasim kulturës shqiptare, letërsisë së saj, kryesisht ngaqë shkruajmë shqip. Nëpërmjet saj trokasim tek "konaqet" e huaja letrare. Mendimi se duhet të shkruash në gjuhët evropiane, në rastin tonë si emigrantë në gjuhët përkatëse vendase, që të bëhesh pjesë e letërsisë evropiane, më ngjan naiv. Vetëm nëse dëshiron të "ndërrosh shtëpinë". Është punë për ty, por mos u vetëshpall "ambasador kulture", se nuk do të besohesh. Duhet të luash futboll në kampionatet vendase, që të inkuadrohesh pastaj edhe në ato evropiane... Këtu lind nevoja imediate e përkthimit të veprave tona në gjuhët e huaja që dëshirojmë. Është bërë punë e konsiderueshme, të paktën për sa i përket realitetit grek, të cilin njoh. Ia kanë gjetur anën kësaj nevojë shkrimtarët emigrantë, njoh shumë raste pune të shkëlqyer në këtë drejtim. Dhe janë mirëpritur në përgjithësi nga kultura vendase, po të mos dëgjojmë kapriçot e veçanta të disa kolegëve, që qahen vazhdimisht, se nuk u a kanë dorëzuar vendasit akoma... çelësat e shtëpisë së tyre. Këtu kanë hyrë në punë shkëlqyeshëm edhe "urat e miqësisë" - kolegët minoritarë grekë të Shqipërisë, që rrojnë edhe ata me vëllezërit shqiptarë në këtë vend. Kanë vënë në dispozicion talentin dhe njohjen e tyre të gjuhës, në dobi të kësaj pune. Ata janë urrat me të vërtetë të efektshme, jo ato të rremet e politikës. Kë të përmend më parë, Telemak Koçën, Niko Kacalidhën, Arqile Garon apo Petro Çerkezin? Jam krenar për ta, edhe pse i përkas të njëjtës kategorie. Institucionet tona shtetërore në Atdhe është fat që nuk janë marrë seriozisht me këtë punë. Do ta bastardonin në mënyrë qesharake këtë mision, si çdo gjë tjetër. Është problem shumë serioz dhe i nevojshëm për ne, që të merren me të kameleonët politikë të Atdheut. Do ia gjejnë anën shkrimtarët e diasporës vetë kësaj nevojë. I zoti e nxjerr gjënë e butë nga balta. Zoti na ruajt, në u dasht të

biem në dorën e gomerëve të tillë!

HEJZA: Cili është raporti i atdheut me krijuesit shqiptarë të diasporës! Shtëpitë tona botuese që i kemi me bollëk, dinë gjë për këta shkrimtarë, apo nisin e i njohin sapo ndonjëri prej tyre të shpreh gatishmëri për vetëfinancim të veprave të veta? A mendoni se vetëfinancimi i botimeve është një "korrupsion kulturor" i cili duhet të ndiqet, madje edhe me mbyllje të shtëpisë botuese nga organet respektive shtetërore?

JOVANI: Ah, këtu fillon drama dhe komedia bashkë. Një mishmash i vërtetë. Asgjë e frytshme, asgjë e natyrshme, mesjetë! Ata nuk janë botues letrarë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Janë xhambazë. Varrmihësit e letërsisë shqipe. Nëse letërsia kombëtare është katandisur ajo që është, botuesit janë fajtorët kryesorë. Botues u thëncin! Nuk t'i shikojnë dorëshkrimet, por xhepat. Nëse mund të të vjedhin, mund edhe të ulin brekët para teje, nëse nuk ndodh kjo dhe ti u përplas në fytyrë dorëshkrimet, ata të shikojnë si të jesh alien. Vjen nga një planet tjetër dhe nuk ke para? Të dhjefsha letërsinë, nuk vlen grosh! Këta janë botuesit e sotëm të Atdheut dhe ky është edhe fati ynë: përjashtimi! Kështu që detyrohemi të gënjejmë vetveten: botojmë në ca shtypshkronja bakallësh dhe "librat" tanë ua falim miqve. Sa do të zgjasë kjo? Aq sa shteti ynë i korruptuar do të ndërrojë fytyrë. Aq sa shtëpitë botuese nuk do të jenë edhe shtypshkronja. Aq sa do të ketë treg të vërtetë libri, me standarde bashkëkohëse evropiane. Është thënë kaq herë kjo, dihet zgjidhja. Pse nuk bëhet? Se shteti xhambaz është ortak me mafian e librit. Pikë! Në këto situata, mos u kthefshim kurrë në Atdhe. Nuk është Atdhe ai, është shtëpi publike, ku bëjnë qejf xhambazët dhe putanat.

HEJZA: A e ka thënë akoma fjalën e vet kritika letrare për krijimtarinë që po zhvillohet në diasporë. Apo, janë dy vlera që po ecin paralelisht dhe assesit të takohen diku sy më sy!

JOVANI: E ka thënë dhe e thotë. Sepse është punë miqsh, marrëdhënie kolegësh

brenda të njëjtës letërsie. Nuk hyn shteti këtu. Bie fjala, për çdo libër timin, është shkruar në Shqipëri dhe në shtypin e diasporës. Kur flas për veten - më ndjeni! - nënkuptoj edhe kolegët e mi në diasporë. Organizojmë promovime në Shqipëri të librave tanë, mikpresim kolegët nga Atdheu tek ne për librat e tyre. Ndjemë bij të të njëjtit zot. Dhe me çdo rast shajmë ata që nuk na duan bashkë, që duan të mos bashkëpunojmë, ngaqë kështu mund ta bëjnë punën e tyre makavielane më mirë. Jemi e njëjta vlerë shkrimtarët brenda dhe jashtë Atdheut, që ecim njëkohësisht. Si vëllezër siamezë.

HEJZA: Antologjitë e më hershme të poezisë, por edhe të tregimit shqiptar, nuk janë llogaritur si të "kompletuara" pa përfshirjen e autorëve shqiptarë të diasporës! Sa vend zënë sot krijuesit nga diaspora nëpër antologjitë e tilla bashkëkohore? Apo nuk njihen fare nga hartuesit e antologjive, aq më pak nëse nuk paguajnë për përfshirje!

JOVANI: "Antologjitë" janë farsa të gëzuara në teatrin tonë letrar. Brenda dhe jashtë Atdheut. Duhet parë si skeçe të gëzuara, që të bëjnë të qeshsh, por që harrohen në çastin pasardhës. Nuk duhet marrë seriozisht, përndryshe mund të çmendesh. Janë punë të dorës, artizanale, nga çirakë profanë të zanatit. Më të paaftët në letërsi mund të bëjnë një Antologji Letrare. Më të patalentuarit, natyrisht, do të jenë përzgjedhur brenda. Të ngjashmit, që njohin njeri-tjetrin. Ç'të them tjetër? Humbas seriozitetin...

HEJZA: Jeta letrare e shqiptarëve sot është më e pasur se dikur apo më e varfër?

JOVANI: Sot kemi lirinë e të shprehurit, mundësinë e lëvizjes dhe të përzgjedhjes. Asgjë nuk krahasohet me lirinë. Nuk ka visar më të çmuar për krijuesin. Dhe ai e ka tashmë në dorë këtë pasuri. Mund ta përdorë. Asgjë nuk të falet. Çdo gjë mund të arrihet. Me kusht, të jesh i lirë. Prandaj do të them se sot jeta letrare e shqiptarëve është më e pasur se dje. Me mundësitë që na jep koha, le të punojmë për ta bërë më të pasur edhe letërsinë tonë. Khanëm, bota nuk u krijua në një ditë...



Tradita

BEGATIA E FIGURACIONIT NË POEMËN “HISTORI E SKËNDEBEUT” TË NAIM FRASHËRIT

Nga vetë fakti se “Histori e Skënderbeut” është një poemë heroike, doemos poeti ka qenë i detyruar të përdorë në masë të madhe edhe hiperbolën. Zmadhimi është mënyra e shikimit apo e projektimit të botës nga romantikët në përgjithësi

Sadik KRASNIQI

Shprehia poetike e ligjërimit të Naim Frashërit në poemën heroike “Histori e Skënderbeut” është shumë e pasur, me figura letrare nga më të ndryshmet. Te kjo poemë gjejmë më së shpeshti: metafora, simbole, personifikime, hiperbola, si dhe litotën. Pos figurave poetike - tropeve, në këtë poemë gjejmë edhe figura stilistike apo të ligjërimit, si: aliteracioni, anafora, antiteza, pyetja retorike etj. Naimi është ndër rilindësit e rrallë, që duke përdorur figura të ndryshme me efekt artistik, arrin që të tillat t’i përligjë në letërsinë shqipe. Pothuajse s’ka figurë artistike që përdor ky autor, që nuk shkon në funksion të artistikes.

Metaforën e përdor të zgjeruar dhe kryesisht të mbështetur në modelin e frazeologjisë popullore. Bie fjala, rrjedhën e kohës e shpreh mjaft bukur metaforikisht edhe në këtë shembull:

*Ditët ishin duke shkuar,
vinin me vrap si lumi,
I turbullt, i kulluar
që ikën e nuk e zë gjumi.
(K. II)*

Me anë të metaforës, poeti përshkruan edhe vetitë e dobëta të karaktereve negative në këtë poemë. Për Muratin metaforikisht shprehet se: “Në gjuhë kishte dhelpërinë”, ose për mbetjen e ndonjë luftëtari në fushën e betejës: “Ia bëri ditën natë”.

Në poemën heroike të Naimit gjejmë mjaft dendur simbole apo situata simbolike. Ai i krijon këto simbole me anë të figurave historike. Me Hamzain simbolizon njeriun negativ, me Ballabanin tradhtarin, me Volterin e Rusoin simbolizon diturinë, kurse Murati dhe Mehmeti bëhen simbole të së keqes dhe dhunës. Antipod i këtyre është Skënderbeu, i cili simbolizon qëndruesin dhe ngadhënjimin. Personifikimi naimjan ndërtohet me anë të thirrjes apo shpirtëzimit të sendeve dhe fenomeneve. Duke shpirtëzuar kohën, ai thotë se: “Rrjedh si lumi, as dremi, as s’e zë gjumi”. Naimi personifikon gjërat, duke dashur t’i shpirtëzojë ato. Krahasimet dhe epitetet, të përdorura aq shpesh, krijojnë përshtypjen se poema heroike mbi Skënderbeun është e ndërtuar mbi këto dy figura. Naimi në poemën e tij aplikon dy lloje krahasimesh:

NAIM FRASHËRI
HISTORI E
SKËNDËRBEUT
poemë



të thjeshta dhe të zgjeruara. Krahasimet e thjeshta i ndërton kryesisht me anë të lidhëzave si dhe posi.

*Nga dy anët shigjeta,
binin me fishkëllimë,
dhe ndrinin të shkretat,
në diell si vetëtimë.*

Ndërsa krahasimet e zgjeruara janë të ndërtuara me lidhëzat *kështu dhe ashtu*.

Në këto vargje vërehet se, për të krijuar situata të tilla imazhiste, krahasimin e ndihmon edhe cilësori apo epiteti. Cilësori si epitet, në këtë poemë, hyn në funksion për të vënë në pah bukurinë fizike të heronjve, e cila rrjedh nga fisnikëria shpirtërore e tyre. Epitetet në njëfarë mënyre i japin freski poemës me elemente të së bukurës. Në këtë ligjërim poetik do të hasim cilësorë etikë,

estetikë, fizikë dhe emocionale. Cilësorë më të dendur janë ata fizikë, që pothuajse njëkohësisht janë edhe estetikë, p.sh.: *leshra prej floriri, symëshqerrë, leshbardhë, lule t’arta, sypishë, syshigjetë* etj. Mjaft shpesh në poemë gjejmë edhe cilësorë emocionale, të cilët krijojnë situata të ndryshme shpirtërore, më shpesh të zymta, por herë-herë edhe të hareshme. Duke u bazuar në cilësorët me efekte emocionale, na del në pah qëndrimi etik i Naimit, që dënon të keqen dhe luftën.

Epiteti cilësor i(e) shkretë përdoret sa herë që i paraprin emri luftë. Këtë cilësor shpesh e gjejmë të shoqëruar me emrin *vdekje, fushë, Varnë*. Të gjithë këto janë të shkreta për poetin.

Naimi me epitetin i(e) shkretë në shumë raste krijon edhe anatemë, me të cilën mallkon të keqen njerëzore. Epitete të tjera emocionale kemi: *sytë e egërsuar, e zeza mëmë, luftë e tmerrshme etj.*

Nga vetë fakti se “Histori e

Skënderbeut” është një poemë heroike, doemos poeti ka qenë i detyruar të përdorë në masë të madhe edhe hiperbolën. Zmadhimi është mënyra e shikimit apo e projektimit të botës nga romantikët në përgjithësi.

Heroi i poemës përmes kësaj figure i afrohet të madhërishtes. Edhe pse e përdor mjaft dendur këtë figurë folkloristike, poeti e bën me mjeshtëri të rrallë, gjë që plotëson idenë e veprës.

Naimi në “Histori e Skënderbeut” hiperbolizon çdo gjë, për ta bërë madhështore heroikën e veprave të kryepersonazhit. Ai në fushën e betejës zmadhon numrin e ushtarëve turq krahas numrit konstant të shqiptarëve. Kur lufton Skënderbeu, “me mijëra vdesin” në taborin e armikut, “lumi bëhet kënetë” nga gjaku, “fusha mbulohet me të vdekur”, “dridhet trolli”, siç shprehet tekstualisht autori.

Herë-herë poeti hiperbolizon edhe vetë trimërinë e Sulltanit, për të madhëruar atë të kryepersonazhit. Veprimet e Gjergj Kastriotit, të ilustruara me këtë figurë, shtojnë vizualitetin e skenës luftarake.

“Ç’u ka bërë Skënderbeu armiqve atë natë,

i griu, i shoi, i preu,

aq shumë ndrinte shpata,

sa shkelte mbi yje e shkante,

me vrap nga frika e asaj nate,

ditës vend i lëshonte.”

(K. XII)

Këtu edhe pse ngërthehen tri trope, si personifikimi, metafora dhe hiperbola, prapëseprapë dominon kjo e fundit. Naimi me mjeshtëri përdori edhe litotën, për të arritur efektin e simpatisë. Naimi Frashëri shpesh në poemë për njeriun shprehet njerth, për Shqipërinë-Shqipërizë, për dritën-dritëz. Me këto trope të dendura poeti me mjaft sukses arrin ta transferojë artistikisht lëndën e historisë në një poemë heroike.

Në saje të këtyre figurave, kjo vepër, gjithsesi, ka edhe vlera estetike.

Mund të themi se Naim Frashëri, ndër romantikët tanë më të shquar, i krijoi veprat e tij sipas programit të Rilindjes Kombëtare, ndërsa Rilindja Kombëtare u bë e ndërgjegjshme në saj të veprave të tij. Ato sikur lindën njëra-tjetrën.

Qasje

A ËSHTË REALIZMI SOCIALIST METODË LETRARE E ARTISTIKE?

Funksioni qëllimor i teksteve të socrealizmit është krejt i ndryshëm nga funksioni qëllimor te letërsia e romantikëve energjikë, apo edhe te letërsia realiste me sfond të fortë shoqëror

Yzedin HIMA

Pothuajse përherë, kur flitet për realizmin socialist, emërtohet si: metoda letrare e artistike e realizmit socialist. Mendoj se ky përcaktim është i gabuar, sepse realizmi socialist, i importuar nga Bashkimi Sovjetik, nuk është metodë letrare e artistike, përderisa parimet dhe kanonet e tij nuk të çojnë në krijimin e një teksti me funksion estetik, por pikërisht, kanonizojnë devijimin nga funksioni themelor i tekstit letrar, duke e zëvendësuar funksionin estetik të tekstit me funksionin thelbësisht a tërësisht qëllimor, gjë që e shndërron tekstin letrar në një tekst me funksion praktik, duke goditur letraren dhe duke përfutur një tekst propagande:

Lavdi për ty, Parti
Çaje tynelin me vërtik
Malin e Shqipërisë
Edhe vërsho tej, në të ik,
Hekurudh' e rinisë
Sos janë male vetëm gur;
Po janë krom e bakër plot,
Thesare plot.
Mbi male sot jam zot,
I lirë e lavdiplotë.
Lavdi për ty, Parti!
Dh. Sh.

Ky tekst nuk ka asgjë letrare. Është propagandë e pastër. Shkrimtari është në rolin e aktuar nga metoda estetike e realizmit socialist, si ndihmës i partisë për edukimin e masave me partishmërinë proletare. Nuk është e mundur që këtij teksti t'i bëhet një koment letrar, sepse aty mungon letrarja. Teksti fillon si një marsh luftarak, vazhdon si një pohim se "malet nuk janë vetëm gur, por krom e bakër" dhe përfundon me një parullë: "Lavdi për ty Parti!"

Autori, në këtë rast, është pjesë e korit të shkrimtarëve entuziastë, të cilët gëzonin kolektivisht, ndjenin kolektivisht, këndonin e "krijonin" kolektivisht, duke u shndërruar në një turmë, ku nuk mund të flitej për individualitet, nuk bëhej fjalë për stil (Stili është vetja- thotë Bualo), nuk bëhej fjalë për letërsi, por thjesht për propagandë.

Natyrisht, autori nuk është një rishtar në krijimtari. Ai ka studiuar në një universitet perëndimor për filozofi, ka shkruar poezi në vitet '30 të shekullit XX. Ja një tekst poetik i Dh. Sh., i shkruar në vitin 1933:

KUMBONA
N'qiellin plot dritë e gaz, kur e lëshove,
kumbonë, hymnin e naltë të lindjes s' re
un me një shpresë të re që në shpirt më
zgjove,
e ngrita kangën terne për në re.
Po sa i shkurtën gëzimi qenka në dhe!
Kumbona shpejt lajmoi të zezën zi!
Shif! në këtë ditë të qeshun ti këndon
mbasandaj qan e qesh e prapë vajton
Kumbonë! Sa fort ngjan me i shpirt të ri!
1933

Autorit të ri nuk i mungon talenti letrar dhe ky tekst duket se është nyjësuar nën ndikimin e estetikës simboliste. Nga krahasimi i dy teksteve shohim se parimet e socrealizmit, të zbatuara me rreptësi vrasin shkrimtarinë dhe si rrjedhojë edhe letraren te teksti. Po si ka ndodhur ky shndërrim?! Autori me vetëdije i ka shkruar këto vargje sipas kërkesave të metodës estetike të regjimit. Mendoj tekstin "Lavdi për ty, Parti" nuk e ka mundësinë për të devijuar shijet estetike të lexuesit, qoftë ky edhe me përvojë të paktë leximi. Natyrisht, tekstin krijon shije vulgare dhe keqkuptime te nxënësit e vegjël, nëse



lexohet dhe komentohet në orë mësimi dhe në tekste shkollore, për rrjedhojë ky tekst nuk shkakton dëmin që shkakton një tekst ku krijuesi krahas shtyllës së funksionit qëllimor, ngre paralelisht edhe shtyllën e funksionit estetik. Edhe krijuesit me talent letrar, kanonet e socrealizmit i detyronin të braktisnin letraren dhe të hidhnin në letër vargje propagandistike, krejt si parullat që shkruheshin me gurë në faqe muresh. Në një tekst të F. Gj. kjo dukuri ndodh brenda një teksti:

Dimri i dyzet e katër
Kishin ikur zogjtë shtegtarë
E kish ardhur një dimër i marrë
Qefinin kish hedhur mbi male
Dimri i zi, i kuq e i bardhë!
Po ne këndonim Internacionalen,
Këngë për Stalinin dhe Enverë
Dhe si lulet rriteshim në pranverë...

Katër vargjet e parë të tekstit e kanë të pranishme letraren: kemi epitetet i marrë, i zi, i kuq, i bardhë dhe metaforën qefinin. Katër vargjet e parësëjllin imazhe poetike si zogjtë shtegtarë që ikin, dimri i marrë që vjen, qefinin që kish hedhur mbi male. Kemi ngjyra si: e bardha, e zeza, e kuqja. Pikërisht pas katër vargjeve, "vritet letrarja", flaket tej funksioni estetik i tekstit dhe tekstin vazhdues banalizohet në propagandë si: Po ne këndonim internacionalen/ Këngë për Stalinin dhe Enverë/ Dhe si lulet rriteshim në pranverë./

Dhuna e kanuneve të socrealizmit, brenda një teksti kanë vlarë pa mëshirë artin, letraren, madje kanë sjellë edhe një varg të pakuptimtë, fëminor: /Dhe si lulet rriteshim në pranverë/ duke harruar se pakëz më lart flitej për dimrin. Natyrisht, në tekst ka ndërhyrë dhunshëm parimi i partishmërisë proletare.

Ka autorë pararendës të epokës së romantizmit, poetët e famshëm romantikë energjikë, të cilët krijuan një poezi me funksion qëllimor, por falë mjeshtërisë së tyre ruajtën funksionin estetik. Shkrimtarë të tillë si; Hygo, Bajroni krijuan tekste me nivel të lartë estetik dhe ideor, por funksioni i tyre qëllimor ndryshonte kryekëput nga funksioni qëllimor i teksteve të shkrimtarëve të socrealizmit. Ata synuan përhapjen e mesazhit të lirisë individuale dhe lirisë së njerëzve me tekstet e tyre, synim mjaft fisnik dhe i qëndrueshëm. Natyrisht, një pjesë e shkrimtarëve romantikë, ata që u quajtën romantikë sentimentalë, ata që synonin lirinë estetike, jo atë shoqërore krijuan tekste me nivel të lartë estetik. Blejk,

Wordsworth, Leopardi etj. Tekste si ky i Viktor Hygoit shkaktojnë habi ideoestetike:

Një mijë në qëndroshin, do të qëndroj dhe vetë,
Po edhe njëqind në mbetshin, nuk tundem kurrsesi;
I dhjeti do të jem, po qe se mbeten dhjetë:
E në mbettë veç një, - do të jem unë ai!
("Ndëshkimet")

Ndërsa tekste të tillë si "Poezia" e Uiliam Blejkut shkaktojnë mahni estetike:

Të shohësh një botë në kokërrizën e rërës
Dhe qiellin në një lule të egër,
Të mbash Pafundësinë në pëllëmbën e dorës
Dhe Përjetësinë në një çast.
Nëse do të krahasonim të dy tekstet, ata dallohen për mesazhet e fortë që përcjellin. Teksti i Viktor Hygoit për mesazhin kuptimor shoqëror, ndërsa teksti i Blejkut për mesazhin estetik.
Ndërsa te tekstet e poezisë së socrealizmit, në korin e shkrimtarëve të promovuar nga kritika zyrtare aksi estetik mungon. Këto tekste kanë krijuar shije vulgare te lexuesit e pasprovuar dhe janë refuzuar nga lexuesit sqimtarë. Po krahas teksteve pa aks estetik, në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit XX takon edhe teksteve ku dallohen të dy shtyllat e funksioneve të letërsisë, shtylla e funksionit qëllimor, ndikues dhe shtylla e funksionit estetik si këto vargje të poetit N. Gj:

Kur po plotësoja autobiografinë
Me shkrim të pastër dhe të bukur.
Më dukej sikur hidhnin valle gërmat dhe firma
Nën ritmet e zemrës sime të lumtur.

Pastaj kur më dhanë për herë të parë
Tëserën e Partisë shokët e komitetit,
Më dukej sikur mbaja në dorë
Tërë peshën e shqetësimit e planetit.

Natyrisht, këto tekste e kanë të pranishme shtyllën e funksionit estetik. Letrarja aty është e pranishme. Ndikimi te lexuesit është më i ndjeshëm nga tekste të tillë e për rrjedhojë edhe dëmi është më i madh në deformimin estetik, shpirtëror dhe ideologjik se te tekstet që janë kthyer thjesht në propagandë. Funksioni qëllimor i teksteve të socrealizmit është krejt i ndryshëm nga funksioni qëllimor te letërsia e romantikëve energjikë, apo edhe te letërsia realiste me sfond të fortë shoqëror. Në të shumtën e rasteve tekstin nuk i shërben as lirisë individuale, as lirisë

universale të njerëzve, as lirisë së njerëzve të privuar si te letërsia realiste. Në tekstet e socrealizmit tekstet shndërrohen në tekste ideologjikë dhe i shërbejnë urrejtjes së një pjese për pjesën tjetër, Pikërisht vështrimi klasor, d.m.th. lufta e klasave predikonte jo humanizmin, që është fija që thur tekstin, që nga Eskili me "Prometeun e mbërthyer", por predikonte urrejtjen klasore. As që mund të krahasohet letërsia qëllimore e ndikuese e të gjitha kohëve pararendëse me tekstet e socrealizmit.

Se cili është ndikimi i teksteve të tillë, natyrisht të shoqëruar edhe me propagandën edhe në fusha të tjera të artit, mjafton të shohim panoramën shqiptare menjëherë pasrënies së diktaturës. Njeriu i ri socialist, ose përbindëshi i rritur në diktaturë, i rrethuar na telat me gjemba te kufijtë dhe me tela ideologjikë te mendja, i kalli datën qytetërimin evropian me dhunën e egërsinë me të cilat u shpreh në liri. Gjënë e parë që bëri, dhunoi pjesën më të bukur, femrën, të cilën e nxori në tregun e mishit të bardhë në udhëkryqet e Europës, pastaj shkatërroi, pyjet, gjelbërimin, e gjithçka të mirë që kishte mbetur ende në natyrë. Pse? Sepse nuk e dallonte të bukurën, nuk e përjetonte atë, as që bëhet fjalë ta krijonte të bukurën. Krahas rritjes në tirani, mjerim e dhunë, një pjesë të meritës në formimin e përbindëshit e ka edhe tekstin e helmuar nga ideologjia, me të cilin qe ushqyer gjatë viteve njeriu i ri. Për të sjellë një pamje me të qartë të dhunimit të tekstit letrar nga censura e autocensura, nga përqafimi me vetëdije i metodës estetike të socrealizmit nga autorë të gjysmës së dytë të shekullit XX, po sjell një ragment teksti të shkruar në këtë kohë, por i shkruar jashtë shtrëngimit të kanuneve të socrealizmit. Autori është V. B.:

SAHARAJA

Saharaja, larg është Saharaja,
Saharaja shkëmb e rërë e gurë,
Që ka shok veç emrin e saja
Dhe ngaqë s'sheh ëndrra, s'sheh as drurë.
Saharaja s'di të ëndërrojë.
Ajo bluan gurë me mend' e saj...
Saharaja s'ka këngë të këndojë,
Saharaja s'ka as lot të qajë.

Kur krahasojmë këtë tekst me tekstet e shkruar në të njëjtën kohë, dallojmë qartë dhunën e tmerrshme dhe plagët që ka shkaktuar metoda estetike e socrealizmit edhe te autorë me talent letrar, ndaj me plot gojën pohojmë se ky tekst, i pandikuar nga socrealizmi, mund të pranvitet me poezinë më të mirë europiane dhe vështirë t'i gjendet shoqi në poezinë e kohës kur u shkrua, për nga niveli cilësor në planin artistik.

Natyrisht, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX u krijuan edhe poezi e letërsi cilësore, e cila vuajti botimin, por kur u botua u mirëprit nga lexuesi. Teksti poetik i Dhori Qiriazit, i titulluar "Dikur në vjeshtë" është antologjik. Po kështu edhe mjaft poezi të Ismail Kadaresë, Fatos Arapit, Rudolf Markut, Petrit Rukës, Bujar Xhaferit, Sadik Bejkos, Skënder Rusit, Ndoc Gjetjes i kanë shpëtuar morsës së socrealizmit dhe kurrsesi nuk mund të klasifikohen si letërsi e socrealizmit. Në krijimtarinë e disave prej këtyre autorëve gjen edhe tekste me të gjithë tatuaazhet e socrealizmit. Disa prej tyre kanë besuar te ideologjia e kohës dhe me vetëdije e kanë ngritur shtyllën e funksionit qëllimor, por falë talentit të tyre, i kanë thyer kornizat e ngurta të socrealizmit, dhe kanë nyjësuar tekste me vlera të spikatura artistike.

Mbi prozën e shkrimtares Armenida Qyqja

VIZATIM KARAKTERESH ME THELLËSI PSIKOLOGJIKE

Janë 14 tregime nga vëllimi “Pirgjet e hirta” dhe 12 tregime nga vëllimi “I vdekuri që qesh” të autores Armenida Qyqja, që të përmbledhura në dy vëllime, botuar kohët e fundit, të ndjellin që t’i lexosh me endje

Dr. Bardhosh GAÇE

Mjaft shkrimtarë të dekadave të fundit, në sprovat e tyre letrare kanë bërë përpjekje që, krahas lëvrimin të poezisë, të shpalosin talentin e tyre edhe në prozë, në ese, tregime e romane, duke dëshmuar kështu pjekurinë e tyre artistike dhe estetike. Tek autorja Armenida Qyqja, edhe pse në emigracion, në Kanada, si në muzën e saj poetike edhe në tregimtarin, gjallon bota dhe jeta shqiptare. Duke kundruar këtë botë të gjerë artistike dhe estetike edhe pse ajo ka dekada që jeton në një kontinent tjetër, të duket sikur Atdheun e ka marrë me vete mbi supë, në frymë dhe në shpirt. Janë 14 tregime nga vëllimi “Pirgjet e hirta” dhe 12 tregime nga vëllimi “I vdekuri që qesh” të autores Armenida Qyqja, që të përmbledhura në dy vëllime, botuar kohët e fundit, të ndjellin që t’i lexosh me endje. Kjo sepse autorja shtjellon një narracion jetësor me zhvillim karakteresh, duke marrë më së shumti ngjarje nga përditshmëria. Është e rëndësishme ta themi që në fillim, se tregimi i Armenidës si tipologji i përket një ngjarje që vijëzohet në elementet dhe konturet e një subjekti të thurur me kujdes dhe të drejtpeshuar përmes qendërimit të ngjarjes, që hapet aq sa mban pesha e saj e funksionalizimit të episodeve dhe e bërthamës rrezatuese të idesë. Tregimet u përkasin viteve pas nëntëdhjetës, pikërisht kur në këtë periudhë ndodhën ndryshime të mëdha sociale, politike-shoqërore, kur individi me veten, me shoqërinë, me botën, me fatin, vuri raporte të reja ndërvarësie e varësie, prandaj ato e kanë të shtjelluar bukur mirë aspektin psikologjik dhe mental, që vihet re përmes subjekteve dhe detajeve që e materializojnë këtë. Zbërthimi i karaktereve përmes rrethanave, mendësisë, fatit apo rastësisë, është një detyrë e mocme krijuese e letërsisë dhe nuk është nevoja të japim shembuj, sepse ato dihen. Ka mënyra të ndryshme të këtij zbërthimi përmes atmosferës, ku personazhi jepet konvencional, përmes realizmit, ku personazhi është konkret, apo përmes misterit, ku personazhi shtyhet drejt një bote të panjohur. Asnjë mënyrë nuk është përjashtuese ndaj tjetrës, ashtu siç themi se është këshilluese secila, kur kemi realizim artistik, sepse çdo mënyrë varet nga motivi, tema, subjekti apo nga shenjat e prirjet e talentit të rrëfimtari. Tregimi i Armenidës u përket më tepër gjendjeve shpirtërore që shpalosen, ndërthuren e hapen dhe mbyllen sipas situatave, ku vihet personazhi, që detyrohet t’i përjetojë ato sipas forcës së tij shpirtërore apo këndshikimit personal. Si i tillë, ajo ta afron personazhin përmes vërtetësisë së tij, duke ta dhënë të besueshëm sikur ti sapo e takove apo pret ta takosh e të bisedosh me të. Kuptohet, kjo është shenjë pjekurie artistike e një autoreje që prozën e shkruan me një nerv të kulturuar, me një rrëfim të natyreshëm që shkon në tendencë drejt zbërthimit të atyre elementeve bazikë të njeriut, shqetësimin për jetën, fatin, për të sotmen e të ardhmen. Tregimin me subjekte të thjeshta – moraviane – ku personazhet hyjnë në ato marrëdhënie që i thërrret e zakonshmja e jetës, mendojmë se kanë pëlqimin e tyre për një lexues, i cili e shikon jetën në shfaqjen e saj të natyreshme larg çudirave apo ndaj qasjeve për të dashur një element dhe një ndodhi me të papritura befasuese deri në kufij të zmadhimit të mbinatyreshëm, siç ndodh me disa autorë që kërkojnë ta çudisin lexuesin me zgjidhje *deux ex machine*. Jo, Armenida preferon të



zakonshmen, çastin, por jo atë të zakonshme që shkon në thjeshtësim, por atë të zakonshme që mbart poezinë e jetës dhe i ngre kult bukurisë së saj. Poezia e jetës ndodhet pikërisht tek ajo që është e zakonshme, tek ato detaje që nuk vihen re dhe vetëm syri vëzhgues i një shkrimtareje, siç është Armenida, i kap ato dhe i shtjellon me një befasi ndjesore që imponohet bindshëm dhe të krijon kënaqësi leximore. Tregimet e Armenidës frymëzohen nga ngjarje të thjeshta të jetës, duke zgjedhur një fabul që i ngjet të zakonshmes dhe që zgjerohet përmes një subjekti linear, ku nuk kemi retrospektiva apo paralelizma të shumta. Duke përzgjedhur mikrongjarje të tilla ajo zbulon prej tyre bërthama që gjenerojnë mjaft ndjenja e kundërshti, të cilat në shtjellimin e tyre portretizojnë njerëz dhe situata reale. Vetë titulli “Pirgjet e hirta” tregon në mënyrë simbolike pengesat dhe kapërcimet e vështira që ndesh njeriu i sotëm në shoqëri, pengesa të llojllojta që vijnë prej natyrës së shoqërisë së sotme, e cila është shkapërdredhur në mjaft probleme prej një sistemi të ri që jeton. Plagët sociale janë të ndryshme, si: kurbeti, varfëria, prostitucioni, etja për para, venitja e jetës, rënia e dëshirës për punë dhe etja për përfitim, por autorja trajton edhe probleme psikologjike dhe etike, siç janë keqkuptimet, mungesa e karakterit apo anë të tjera të panjohura që shpërfaqin një botë instinktive të papritur. Duke i marrë me radhë tregimet një nga një, nuk mundet tjetër veçse të zbulojnë një reliev të jetës, ku përthyerja e tij duket se ndryshon format çdo ditë pa u stabilizuar në një gjendje. Në një tregim është e rëndësishme të mos tregohet një histori, por të përshkruhet ajo se si e mbartin këtë histori të marrëdhënieve njerëzore, se si sillen përmes saj natyra njerëzore përmes një transfigurimi artistik. Dhe ky është arti. Gjendja emocionale e personazhet përcillen në situata herë të qeta e herë të vullshme, duke shkuar drejt fundit, që jepet me një mesazh kuptimplotë dhe njerëzor. Ndërtimi i personazhit kryhet në një mënyrë të tillë që ai të shkojë drejt plotësisë së mundshme të karakterit të tij dhe kjo është shenjë pjekurie e talentit të autorës dhe vjen nga një përvojë e njohjes së temës dhe grumbullimit të përvojës gjithashtu nga leximet. Gjetja dhe ndërtimi i detajit bëhet me kujdes, që detaji të përçojë mundësi për zgjerim të narratives, e cila në tregimet e saj rrjedh e qetë dhe me plot antonime vërtetësie. Kjo

narrativë përcjell gjithashtu edhe besimin se jeta është e bukur dhe ka kuptim vetëm kur atë duhet ta shikosh nga qëndrimet që mbajnë njerëzit e mirë, përkundër atyre që dinë të bëjnë keq dhe vetëm të shfrytëzojnë rastin në dobi të interesit të tyre meskin. Thjesht e bukur jep autorja situatën te tregimi “I mbijetuari”, ku në figurën e Ermalit jep ankthin e masakrës dhe gjetjen e paqes, po kështu, në tregimin tjetër “Pirgjet e hirta”, autorja vizaton figurën e Andit dhe jepet një pirg cigaresh të shuara – si shenjë e mërzisë dhe e pritjes- detaje që vizatohen mirë nga autorja dhe që japin një atmosferë gri. “823 metra nën ujë” është një tregim tjetër interesant- i cili e rrit më tepër intensitetin e të rrëfyerit dhe komplikon situatat, duke përmbysur rrëfimin në raporte të ndërlikuara me thyerje lineariteti- Motivi i kërkimit të kryefamiljarit për gruan e humbur dhe fëmijët është çelësi që e mban tregimin në ankth dhe rrëfimi i jep përparësi një dinamike të mbylltur, që zhvillohet si një luftë e brendshme shpirtërore. Përpjekja gërshetohet me rastësinë dhe rastësia e ardhur për një jetë tjetër, sjell atë që quhet lodhje e dëshpërim- dëshpërim dhe humbje përmes tij. “Nga zero” është një tregim tjetër që të bën të mos e humbasësh interesin për prozën e shkurtër rrëfimtare të Armenida Qyqes. Në këtë tregim jepet një përpjekje e njeriut për të arritur diçka dhe humbja-pastaj një ringritje e besimit për t’ia nisur sërish nga pika fillestare. Linjat shoqërore ngërthehen me linja dashurore dhe kështu fluksi rrëfyet nuancon jetën e njeriut në mënyrë shumëplanëshe. Tregime të tjera, si “Prapa diellit”, “Pllakat”, përfaqësojnë vlera të qenësishme etike-morale. Janë një sërë tregimesh që kanë në fokus temën e parasë, një temë e ditëve tona- paraja- ky mekanizëm diabolik, që lëviz gjallërimin e shoqërisë, djeg shumë dëshira, ashtu siç ndez shumëfishimin e tyre nga njerëzit e shtresave të ndryshme shoqërore. Jepet kjo bukur në tregimin “Zemra e nënës”- një tregim sa i rrafshit shoqëror dhe i problematikës së mprehtë, aq edhe i ndjesive të holla kur vjen puna për të reflektuar mbi ndjesitë e një nëne. Edhe në tregimin tjetër “Gjashtë ditë”, autorja ndërton premisën si parakusht i kuptimit të vetvetes – si ngecje dhe harrësë për gjërat e mundura me një angazhim tjetër shpirtëror për të arritur seriozitetin dhe aftësinë e një njeriu ndaj një tjetri. Në këtë kohë, kur njeriu përthithet nga absurdi i

saj shpeshherë humbja e kujdesit bëhet edhe ndaj njeriut më të dashur. Po kështu në tregimin “Çmimi” arrihet që të jepet një botë tjetër që induktohet dhe merret në një tërësi të veprimeve të personazheve, ku imazhet përzihen me njëra-tjetrën, duke përcjellë ankth. Andaj, të bukura janë tregimet “Vajzat”, “Djajtë e vegjël”, “Rrëfyesi”. Dilemat e personazhit, lufta shpirtërore me vetveten, është një mundësi e realizueshme këndvështrimi e autores, e cila e sjell botën njerëzore si komplekse dhe inkandeshente herë-herë. Autorja krijon një minibotë të zhdërvjellët plot përndezeje shpirtërore, me pengesa e pendesa, me një ritëm të qetë rrëfyet, ku poshtë rrjedhës narrative vlon një zjarr i brendshëm shpirtëror. Fraza e saj punohet me kujdes dhe autorja ruan sensin e masës, duke shmangur mënyrën përshkruese nga trimet apo ngjashmëritë dhe duke arritur të na japë një prozë sa fabuleske, aq edhe refleksive. Lidhur me mjeshtërinë e saj mund të themi se ajo nuk e prezanton problemin në fillim të tregimit- një zotësi konceptuale kjo – në mënyrë që lexuesi përmes një nisje rrëfyetë të mbajë të gjallë kureshtinë e tij për të arritur tek pika e nyjës, aty ku lidhet intriga- dhe, ndërsa shkon aty, ai nuk hamendëson dot për zgjidhjen, veçse përpos zgjidhjes së autores, të cilën e kupton në fund. Kjo mënyrë tregon për një njohje të mirë të autores për artin e tregimit, i cili nuk mund të quhet i bukur nëse gjërat kuptohen që në fillim. Përshkrimet e shumta transmetojnë gjendje shpirtërore, dilema e hamendje, por edhe mjedise, të cilat vizatohen në përshtatje të këtyre gjendjeve dhe rrethanave sociale. Duke paraqitur njeriun e sotëm kryesisht në mjedise urbane- në vend apo jashtë shtetit – autorja zhvillon një përmasë të re shpirtërore dhe mentale të këtij njeriu – ku hapësira nuk është më e kufizuar. Duke arritur të kapë tema e motive që kanë peshë – ajo tregon gjithëkohësinë e tyre me një universalizëm të kapjes, çka u jep tregimeve të saj një ton filozofik. Kështu, vëllimi “Pirgjet e hirta” mbetet një nga vëllimet e mira në prozë – ku kapja e problemeve, mjediset, personazhet, karakteret dhe mendësitë e të sotmes, sillen në mënyrën e të shkruarit përmes një stili të qetë dhe që realizon një përmbajtje të gjerë e, më shumë, të thellë të shqetësimeve të individit të sotëm.

Aspekte

MITI DHE KRIJIMTARIA ARTISTIKE



Kuptimi dhe perceptimi mitik i ekzistencës së njeriut antik, dallohet në formë tejet të diferencuar nga mendimi racional i qytetërimit aktual. Kryesisht në formë të riciklimit, lidhet me përvojën e fatalitetit të jetës së individit dhe të vazhdimësisë së saj

Luljeta ISAKU

Në situata aktuale, kur mendimi kritik e shtron bazueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e çdo të vërtete aprioriste, është memoria që përkujton ngjarjet e së kaluarës, duke i reprodukuar në imagjinatë. Fryma invencionit e cila gjërave u jep kuptim të ri e formon sintezën, relacionin e dhe shtysën që miti i ka dhënë zhvillimit të krijimtarisë artistike. Përpjekjet për ta mohuar mitin kanë dështuar, sepse ai mbetet pjesë e shpirtit të njeriut. Mënyra më efektive për t'iu afruar dhe për ta njohur atë, gjendet në suazat e invencionit të krijimtarisë artistike. Natyra e mitit e shprehur në strukturat e përmbajtjeve artistike, dëshmohet tejet vitale dhe superiore. Me gjithë përpjekjet për rregullimin racional të marrëdhënieve njerëzore dhe institucionale, janë larg nga harmonia e relikteve të kohës së kaluar, dhe shtresëzimeve të reja. Shumë forma të krijimtarisë dhe të kulturës së trashëguar, sot më tepër shërbejnë si mjete ndihmëse dhe shtysë e lëvizjeve avangarde. Krijimtaria artistike dhe poetike ka mbetur forma më e qëndrueshme dhe më e zhvilluar e krijimtarisë kulturore në të gjitha etapat e historisë njerëzore. Bota poetike paraqet edhe botën imagjinare duke shfaqur anën konkrete të realitetit dhe ekzistencës herë - herë të vrazhdë. Prandaj ndodh të jetë në kundërshti me botën e përditshmërisë të quajtur realitet. Dukuritë, gjendjet, situatat dhe subjektet poetike brenda tyre lëvizin aq shumë përpara përditshmërisë, sa që vështirë mund t'i shpjegojmë me përvojën tonë. Shpesh nuk mund të përcaktohen as me koordinatat kohore dhe hapësinore. Kjo botë imagjinare ndryshon nga fryma e objektivizuar shkencës. Vizionet, shumëkuptimësia, figurat dhe metaforat poetike me fuqinë ndjesore dhe vrojtuese në mënyrë të stërholluar, ngriten mbi përvojat e përditshmërisë duke ndriçuar dhe duke i dhënë kuptim botës në

dimensione shumështrësore.

Krijimtaria letrare dhe diskursi poetik asnjëherë nuk janë indiferent ndaj botës së njeriut edhe pse dallohen nga kërkimet empirike shkencore. Ndryshe nuk mund të shpjegohet fakti se strukturat përmbajtëse, figurat dhe ligjërimi metaforik i krijimtarisë letrare kanë tërhequr vëmendjen e shumë gjeneratave. Krijimet letrare dhe diskursi poetik nxisin fuqishëm ndjenjat e pasionit më të thella të të gjitha shtresat e kategoritë më të ndryshme shoqërore. Jehona e këtyre të diskutit letrar nuk do të kishte qenë e mundshme nëse nuk do të kishte pasur objektivitet në krijimin dhe paraqitjen e realiteteve artistike. Krijimtaria e mirëfilltë artistike nuk është kurrfarë improvizimi i rastësishëm, as trillim arbitrar. Krijuesi i mirëfilltë nuk trillon, nuk i krijon kuturu personazhet e veta dhe nuk i konstruktin ngjarjet në mënyrë artificiale. Imagjinata e tij ka strukturë të brendshme të fuqishme dhe të qëndrueshme me të cilën ia hap rrugën në mënyrë rigorozë një domosdoshmërie dhe objektiviteti më të lartë.

Krijimtaria letrare, me karakterin e vet shumëdimensional dhe shumëdimensional, me strukturat përmbajtëse, logosin dhe njetet e sendërtimit, ka krijuar historikisht shtratin për studime edhe në fusha të tjera. Mitin e ka bërë pjesë përbërëse në veprat gjithëkohore dhe të pakapërcyeshëm për vështrimin e shumësisë së formave të ekzistencës shpirtërore dhe materiale. Përmes imagjinatës, në mënyrë tjetërfare, më të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë burimore, interesimi i shkencës në këtë fushë determinohet nga mënyra poetike e zbulimit dhe artikullimit të realitetit ekzistencial.

Krijimtaria letrare artistike dhe sidomos imagjinata poetike, thellësisht depërton në sferat e transcendencës kozmike dhe të intertranscendencës së njeriut si pjesë përbërëse dhe pjesëmarrëse aktive në njohjen, zbulimin dhe ndryshimin e shumë mistereve të cilat në forme

të shkallëzuar dhe dialektike janë demistifikuar. Fisnikëron jetën duke shprishur, shpërkufizuar dhe stigmatizuar e demaskuar rendin ekzistues të gjërave. Krijimtaria shpirtërore ngrihet më lartë se kufijtë e përvojës pragmatike dhe shumë më lartë nga e tërë ajo që arsyenja e shëndoshë përpiqet me ankth ta mbrojë nga çdo formë e shtrembërimit. Imagjinata na shpie në një botë të panjohur, të largët që ndryshon nga ajo me të cilën jemi mishëruar, që e kemi të afërt dhe të njohur. Përmes gjenialitetit emfatik krijuesi nuk e shprehë ndjeshmërinë personale, sepse të gjitha gjykimet shpijnë në faktin se e vërteta artistike nuk është shprehje e e prijeve të caktuara alternuese dhe e frymëzimit shterp të çastit, po dëshmi e pamohueshme e raporteve dhe ligjësive të caktuara konstante. Nga ligjërimi krijues, tropet, figurat, metaforat nuk shprehin vetëm qëndrimin individual ndaj jetës dhe botës. Prej tyre rrjedhin gjykimet shumështrësore lidhur me kuptimin dhe kushtëzimet e vërteta të botës.

Me këto cilësi, përmes krijimtarisë letrare, kapen anët e padukshme të jetës së amshueshme. Rrëfimi ngre kushtimin, jep mesazhe, paralajmërimet të zbulësive, bëhet ndërmjetësuese e nxjerrjes në syprinë të mistereve më të mëdha jetësore. Krijimtaria artistike në këtë mënyrë e zbulon të vërtetën e madhe jo vetëm njerëzore, por edhe të vërtetën e qenies dhe të qenësisë. Me veçantitë e këtyre, diskursi letrar, merr karakter spekulativ. Duke lëvizur ndërmjet kuptimit të pafundësisë, përkatësisht amshimit dhe jetës së ndryshueshme në të cilën asgjë nuk mund të definohet dhe përcaktohet me saktësi, krijimtaria artistike letrare nuk gjen pika të qëndrueshme në të cilat do të mbështetet në mënyrë konstante. Natyra e saj është e ndërrueshme si edhe shfaqja e mendjes njerëzore, prandaj në skenën e historisë kthehen format retrospektive. Pardigmat dhe shumësia e ngjarjeve vendosen në një lloj labirinti. Ngjarjet herë duken të ngjashme dhe të afërta, herë të largëta dhe

të pakapshme. Në sfidën ndërmjet kohës dhe hapësirës, krijimtaria e zhvilluar në kohën aktuale, s'është tjerër pos e ardhmja e cila rrjedh përmes të së kaluarës. Nga ky këndvështrim realiteti, utopia dhe iluzioni si përbërës të ekzistencës njerëzore gërshetohen pa ndërprerë. Duke konstruuar madhështinë, pakapshmërinë dhe misteret, si determinuese të kohëve mitike dhe historike me reflekse në shqetësimet, ankthet dhe mynxyrat në jetën aktuale. Nuk ka dyshim se vizioni letrar është ngusht i lidhur me mitin, se bota imagjinative poetike qëndron dhe mbështetet në elementet e përfytyrimeve dhe shfaqjeve mitike të botës dhe ekzistencës. Shumëkuptimësia e shprehjeve figurative, metaforike, formave simbolike dhe paradigmatiche, shndërrohen në tingëllima e tone të caktuara të gjuhës së lashtë mitike. Edhe në situatën aktuale të sprovave marramendëse të modernitetit, krahasimi ndërmjet diskursit poetik letrar dhe mitit është parakusht themelor në vetëdijjen, ndërgjegjen dhe cilësinë e mendimit artistik dhe të mendimit të përgjithshëm njerëzor, për thellësinë dhe rrezatimet asociative të krijimtarisë mitike. Diskursi poetik letrar me petkun e vet solemn, tmerrues, ideo- estetik, filozofik dhe moral nuk mund të vështrohet dhe vlerësohet jashtë mitit të kohëve dhe hapësirave antike mitike. Kuptimi dhe perceptimi mitik i ekzistencës së njeriut antik, dallohet në formë tejet të diferencuar nga mendimi racional i qytetërimit aktual. Kryesisht në formë të riciklimit, lidhet me përvojën e fatalitetit të jetës së individit dhe të vazhdimësisë së saj. Ky besim, apo religjion, është mbindërtuar me legjenda, kulte hyjnore dhe tokësore, rite dhe rituale që janë përcjellur përmes trashëgimisë gojore nëpër breza, duke u begatuar me forma paradigmatiche e simbolike. Përmes krijimtarisë artistike, poetikat letrare, tekstet e kodeve dhe legjendave morale të religjionit monoteist, me kohë kanë marrë forma të ndryshme letrare.

Sufizmi

OQEAN I MUNDËSISË SË PAFUNDME

Oqeani është përbrenda si dhe përjashta, e udha e mistikëve është një zgjim i dalëngadaltë si të thuash 'së prapthi', në drejtim të rrënjës së qenies sonë, një përkujtim i Vetes Sipërore, që e tejkalon pafundësisht egon njerëzore dhe nuk është tjetër veçse e Thella drejt të cilës tërhiqet vala

Martin LINGS

Sufiu i madh andaluzian Muhji'd-Din Ibn Arabi e kishte zakon të bënte një lutje, që nis me fjalët: 'Kridh-më, o Zot, në thellësinë e Oqeanit të Njëshmërisë Tënde të Pafundme', dhe në trajtesat sufiste ky 'Oqean' përmendet pareshtur, sikurse me anë të të referuarit simbolik ndaj Fundit drejt të cilit orientohet udha e tyre. Ndaj, le ta nisim duke thënë, mbështetur te ky simbol, në përgjigje të pyetjes 'Çfarë është sufizmi?', se: Herë pas here një Shpallje 'rrjedh' si dallgë e madhe batice nga Oqeani i Pafundësisë drejt brigjeve të botës sonë të fundme; dhe sufizmi përbën zanatin, disiplinën dhe diturinë e zhytjes në zbatimin e njërës prej këtyre dallgëve dhe të kthyerit mbrapsht me të tek Burimi i Përhershëm e i Pafundëm i saj. 'Herë pas here': ky është thjeshtim që kërkon koment; sepse duke mos ekzistuar masë e përbashkët ndërmjet origjinës e vendmbërritjes së një dallgë të tillë, kohshmëria e saj është e detyruar të marrë pjesë, në mënyrë të mistershme, tek e Përhershëmja, ashtu sikurse fundshmëria e saj është e detyruar të marrë pjesë tek e Pafundmja. Si e kohshme, ajo duhet së pari ta arrijë këtë botë në një çast të caktuar në histori; por ai çast në njëfarë kuptimi do t'i shqitet kohës. Më e mirë se njëmijë muaj - kështu e përshkruan Shpallja Islame natën e ardhjes së vet. Duhet të ketë gjithashtu edhe një fund, i cili përkon me fillimin, por që do jetë tepër i largët për t'u parashikuar nga njeriu. Institucionet hyjnore janë bërë për gjithmonë. Një tjetër gjurmë e të Tashmes së Përhershme mbi të do të shihet në faktin se ajo rrjedh pareshtur e tërhiqet pareshtur, në kuptimin që ajo përmban praktikisht edhe baticë edhe zbatim për çdo individ që hyn në shtrirjen e saj. Ka vetëm një ujë, por asnjë çift Shpalljesh nuk janë të njëjta për së jashtmi. Çdo valë ka karakteristikat e saj sipas vendsynimit të saj, pra sipas nevojave të caktuara të kohës e vendit, drejt të cilave dhe në përgjigje të të cilave ajo është bërë providencialisht të rrjedhë. Këto nevoja, që përfshijnë të gjitha llojet e aftësive marrëse dhe prirjeve etnike që dallojnë nga njëri popull në tjetrin, mund të krahasohen me zgavrat e lugoret që shtrihen udhës së dallgës. Shumica dërrmuese e besimtarëve merren ekskluzivisht me ujin që depoziton vala në këto enë, i cili përbën aspektin formal të fesë. Nga ana tjetër, mistikët - e sufizmi është një lloj mistike - merren, me përkufizim, mbi të gjitha me 'misteret e Mbretërisë së Qiellit'; kështu që do të ishte e vërtetë të thuhej, duke ndjekur figuracionin e mësipërm, se mistiku është pakrahasimisht më shumë i zënë me valën e zbatimit sesa me ujin që ajo ka lënë pas. Porse prapë, ai ka nevojë për këtë sikurse pjesa tjetër e bashkësisë së tij - nevojë, pra për format e jashtme të fesë së tij që kanë të bëjnë me individin si të tillë. Sepse, nëse pyetet se ç'është ajo gjë te mistiku që mund të tërhiqet me dallgën e zbatimit, një pjesë e përgjigjes do të jetë: jo trupi i tij dhe jo nefsi i tij. Trupi nuk mund të tërhiqet deri në Ringjallje, që është etapa e parë e ripërthithjes së tij dhe, bashkë me të, të krejt gjendjes materiale - në stadet e larta të qenies.



Kurse nefsit i duhet të presë gjer në vdekjen e trupit. Deri atëherë, ndonëse i pavdekshëm, ai do jetë i burgosur në botën e vdekshmërisë. Kur vdiq Gazaliu, sufiu i madh i shekullit XI, një poezi e shkruar prej tij gjatë sëmundjes së fundit iu gjet nën kokë. Ajo përmban rreshtat:

Një zog unë jam: ky trup, kafazi im ka qenë Por fluturova tej dhe atë e lashë si shenj? Të tjerë sufi të mëdhenj kanë folur duke nënkuptuar të njëjtën gjë: por duke qartësuar gjithashtu në të shkruarit, të folurit ose të jetuarit e tyre - çka përbën për ne masën e madhësisë së tyre - se diçka në ta ka pësuar zbatim përpara vdekjes, pavarësisht nga kafazi, diçka pakrahasimisht më e rëndësishme se çfarëdo që duhet të presë vdekjen për t'u çliruar. Ajo, që tërhiqet mbrapsht drejt Burimit nga realizimi shpirtëror, mund të quhet qendra e ndërgjegjes. Oqeani është përbrenda si dhe përjashta, e udha e mistikëve është një zgjim i dalëngadaltë si të thuash 'së prapthi', në drejtim të rrënjës së qenies sonë, një përkujtim i Vetes Sipërore, që e tejkalon pafundësisht egon njerëzore dhe nuk është tjetër veçse e Thella drejt të cilës tërhiqet vala. Duke përdorur një figurë shumë të ndryshme, e cila do na ndihmojë ta plotësojmë të parën, le ta përngjasojmë botën me një kopsht - ose më saktë, me një bahçe, sepse nuk ka asgjë në të që të mos jetë mbjellë për t'u mbëltuar dikur gjatë. Pjesa qendrore e bahçes u jepet pemëve të një lloji veçanërisht fisnik, ndonëse relativisht të vogla e të rritura në vazo argjile; por tek i vështrojmë, krejt vëmendja jonë pushtohet nga njëra, që është pakrahasimisht më fine se të tjerat, të cilat i tejkalon së tepërmi në harlisje dhe vrull rritjeje. Shkaku nuk është aq i për syrin, por e dimë menjëherë ç'ka ndodhur, pa pasur nevojë për çfarëdo lloj hetimi: pema ka mundur disi të lëshojë rrënjë thellë në tokë përtej bazës së enës mbajtëse. Pemët janë shpirtat, ndërsa pema e pemëve është ajo që, siç

thonë hindutë, është 'çliruar në jetë', që e ka realizuar atë që sufitë e quajnë 'Mekami Sipëror'; dhe sufizmi përbën mënyrë dhe mjet për ta kaluar një rrënjë nëpër 'portën e ngushtë' në thellësinë e vetes për tek lëmi i Shpirtit të kulluar e të paburgosshëm, i cili nga ana e vet hapet drejt Hyjnisë. Sufiu i pjekur është kësajsoj i ndërgjegjshëm për të qenit, ashtu sikurse njerëzit e tjerë, i burgosur në botën e formave, por ndryshe nga ata, ai është gjithaq i ndërgjegjshëm se është i lirë, me një liri që peshon pakrahasimisht më shumë se burgimi i tij. Kështu që mund të thuhet se ai ka dy qendra ndërgjegjeje: një njerëzore e një Hyjnore, dhe mund të flasë tash nga njëra e mandej nga tjetra, gjë që shpjegon disa (në dukje) kundërshti. Me ndjekë rrugën e mistikëve do të thotë me rrokë një përmasë shtesë, sepse kjo rrugë nuk është tjetër veçse përmasa e thellësisë. Rrjedhimisht, siç do të shihet më hollësisht më vonë, edhe ato rite që mis-tiku i bashkëndon me pjesën tjetër të bashkësisë së tij e të cilat i nevojiten edhe atij për baraspeshimin e nefsit të vet, nuk kryhen prej tij ekzotikisht sikurse nga të tjerët, por nga i njëjti këndvështrim i thellësisht ezotik që karakterizon të gjitha ritet e tija dhe të cilat i ka metodologjikisht të ndaluara t'i braktisë. Me fjalë të tjera, ai nuk duhet të humbasë nga sytë të vër-tetën se uji i lënë pas nga dallga është i njëjtë me atë që tërhiqet. Analogjikisht, ai nuk duhet të harrojë se, ashtu sikurse uji që 'burgoset' në forma, shpirti i tij nuk dallon në thelb nga Shpirti transcendent, të cilit i është tejkajtuar, si një dorë që shtrihet dhe futet në një xhep e që pastaj tërhiqet. Nëse arsyeja e titullit të këtij kreu akoma s'është e dukshme, kjo ndodh pjesërisht sepse fjalës 'origjinal' i janë mbivendosur si kore kuptime që nuk e prekin thelbin e origjinalitetit por të cilat kufizohen në njëri prej rrjedhjeve të tij, gjegjësisht dallimin, cilësinë e të qenit

i pazakontë ose i jashtëzakonshëm. 'Origjinal' biles përdoret si sinonim me 'abnormal', çka përbën shtrembërim të përbindshëm, ngase origjinaliteti është gjithmonë normë. E as nuk mund të arrihet ai me vullnet; ndërsa groteskja është dyfish më e lehtë për t'u arritur, pikërisht sepse nuk përbën më tepër se një lëshim huazimesh. Origjinale është ajo që gufon drejtpërsëdrejti nga origjina ose burimi, si uji i kulluar e i pandotur që nuk ka pësuar efekte 'anësore'. Origjinaliteti kësajsoj lidhet me frymëzimin dhe mbi të gjitha me shpalljen, sepse origjinat janë transcendentë, duke qenë përtej kësaj bote, në lëmin e Shpirtit. Përfundimisht, origjina nuk është hiç më pak se Absolutja, e Pafundmja dhe e Përrjetshmja - së këndeji edhe Emri Hyjnor 'Filluesi', el-Badij në arabisht, i cili mund të përkthehet edhe 'i Mrekullueshmi'. Pikërisht nga Oqeani i Mundësisë së Pafundme rrjedhin dallgët e baticës së Shpalljes, çdo-njëra 'mrekullisht e ndryshme nga të tjerat sepse mbart vulën e së Vërtetës që është Një dhe e Vetme. Nën dritën e figurës së valës shohim se origjinaliteti është garanci si për autenticitetin, ashtu edhe për efikasitetin. Autenticiteti, për të cilin drejtbesimi është si të thuash fytyra në këtë botë, përbëhet nga rrjedha e valës, pra ardhja e drejtpërdrejtë e Shpalljes nga Origjina e saj Hyjnore; dhe në çdo rrjedhë është premtimi i një zbatim, ku qëndron efikasiteti, Hiri i fuqisë së papërbalueshme tërheqëse të së Vërtetës. Sufizmi nuk është tjetër veçse mistika islame, që do të thotë se ai përbën rrymën qendrore dhe më të fuqishme të asaj baticë që përbën Shpalljen e Islamit; dhe nga sa u tha më lart do jetë e qartë se ky afirmim nuk është kursresi përçmim, siç duket se mendojnë disa. Përkundrazi, kjo përbën një pohim se sufizmi është edhe autentik edhe efikas. Sa për mijëra burrat dhe gratë në Perëndimin modern që, tek pretendojnë se janë 'sufi', pohojnë se sufizmi është i pavarur nga cilado fe dhe se ai ka ekzistuar gjithmonë, ata e reduktojnë padashur nëse mund të përdorim të njëjtin figuracion elemental - në një rrjet kanalizimesh artificiale. Ata s'e vërejnë dot që, duke e zhveshur nga veçantia e kësajsoj nga origjinaliteti i tij, ata e privojnë edhe nga vrulli i tij. Sigurisht, kanalizimet ekzistojnë. Për shembull, qëkur Islami u vendos në nënkontinentin indian, ka pasur shkëmbime intelektuale mes sufive e brahminëve; dhe në fund sufizmi përvetësoi ca terma e nocione nga neoplatonizmi. Por themelet e sufizmit ishin hedhur dhe kursi i tij në vijim ishte fiksuar pakthyeshmërisht, shumë më përpara se të bëhej e mundur që ndikime mistike të jashtme e paralele të fusnin elemente joislame, dhe kur ndikime të tilla më në fund u ndjenë, ato prekën vetëm syprinën. Me fjalë të tjera, duke qenë tërësisht i varur nga një Shpallje e veçantë, sufizmi është krejtësisht i pavarur nga gjithçka tjetër. Por si i vetëmjaftueshëm, ai mundet - nëse vendi dhe koha lejojnë - të këpusë lule nga bahçe të tjera. Profeti i Islamit ka thënë: 'Kërkojeni dijen, qoftë edhe në Kinë!'

(Perktheu Edin Q. Lohja)

Shënime shpirti

MARRRËZIA E ITAKËS

Secilës ditë i mjafton pikëllimi i vet, tha Jezui në mal.



Frederik RESHPJA

1. Atë ditë dhjetori kur dogja tërë dorëshkrimet që kisha punuar këto dy dekada, e dija që po bëja një punë të mençur. Çdo ditë ka dhjetorin e vet, dhe kjo mjafton.

2. E kam thënë disa herë që letërsinë nuk e kam patur me seriozitet kurrë. Unë kam dashur pikurën dhe kiminë. Ndofta vetëm me këtë shpjegohet fakti që jam letrar tipik pa ambicje dhe krejt indiferent për çka shkruaj. Unë hyj ndër ata shqiptarë që nuk kanë lexuar asnjë rresht të botuar nga F. Rreshpja.

3. Kur u hap porta, u shfaq një biondinë e panjohur. Ajo kërkoi dikë, dhe unë u trondita. Ishte një miku im i fëminisë që e kisha dashur shumë.
- Ai vdiq dje, - i thashë - tani erdha nga varrimi.
- Jo, tani sapo u ndava me të, - foli vajza e menduar.
- Thashë mos erdhi këtu.
U afua te zjarri dhe nxorri një letër, - Ja, kjo është.
Unë u drodha. Para disa ditësh, ai më kërkoi të bëja por tretin tim. Se bëj dot, i thashë i kam kyçet të dëmtuara. Mos kërkoni më vizatime nga unë! Bëje, pra! tha. Dhe unë Moskëa këtë vjershë me titullin Vinjetë. Po, unë këtë të kërkova, më tha, se desha të vizatuar. Vjershën e botova. Pas shtatëmbëdhjetë vjet heshtjeje si autor i regjistruar në Index expurgatorius. Për këtë ndërhyri M. Z. Shumë muaj më vonë, tek hanim një drekë të varfër me sallam, ulur në një stol çimentoje në një park, desha t'ia tregoj këtë ngjarje por nuk qeshë i sigurtë në qe e vërtetë. Sidoqoftë marrëzia e Itakës nuk qe kjo.

Një Itakë tjetër më priste.

VINJETË

Një shelg i vetmuar mbuluar me dimër Braktisur nga zogjtë dhe gjethet.
Era si ketër kërcen mbi drurin
Me boçen e shiut ndër dhëmbë.

Netët e lumtura si zilka
Tringëllijnë në degët e kujtesës.
Vizatohen në sfond të vetëtimave
Hënëzat që hëngrën dhentë e vjeshtës.

Rënë nga xhami i thyer i qiellit
Kristal i akullit yllëzon netëve
Dhe mbi pastelet e borës mardhet
Shelgu i trishtuar, fatkeq si Serembe.

4. Ç'qe ky i Verbër madhështor që po këndonte fatin tim?

5. Herën e fundit që pashë një turmë shkrimtarësh, ka qenë e mërkurë. Dita e dimrit e çdo jave në jetën time. Po kthehesha nga KQ. Sekretari i R. A. më tha se do të dënohesha fare pak. Më transmetoi porosinë që, dy javë pas burgut të veja tek sh. R. Nuk do të vij kurrë, i thashë. Dhe ika. Rrugës pashë Xh. S. Qe ulur i dëshpëruar anës një bordure, për çudi. Më porositi të shkoj tek shtëpia e Dritëroit. Përse? e pyeta.

Në Lidhje do të bëhej një mbledhje. Turma e shkrimtarëve qe shpërndarë në klub dhe përjashta. Nuk më përshëndeti njeri. Mirëpo aso kohe isha një poet i përkëdhelur. Që nga një tryezë e largët më vështronte I. K. Zoti të ruajtë! mendova me vete. Ti si diplomat nuk bën, derisa më vështron mua. Pas pak më thirri. Bëra sikur nuk dëgjova.

- Po të thërret Ismaili, - më tha një komisar letrar, - nuk e dëgjon?
Me këtë komisar letrar njihesha,

ndaj u nevríkosa që më foli ashtu. S'di ç'dreqin pata, dhe e fyeva. Sot ky njeri është shkrimtar disident dhe më mëson mua ç'janë prangat.

7. - A po shkruan ndonjë gjë të bukur? e pyeta si gjithmonë.
- Sot dua të më thuash, përse më pyet gjithmonë kësodore?
- Sepse në art, mua më intereson vetëm e bukura.

8. Me Ismailin nuk jam takuar. Jemi parë një herë në Tiranë më 1982 por nuk i fola. Një takim me mua, mund ta merrte në qafë.

9. U ngrita. Turma e shkrimtarëve të E. më përgjonte me sy armiqësor. I huaj! Armik!
Mjerë letërsia shqiptare! mendova. Mjerë De Rada dhe Fishta! Turmë e mjerë meskine! Mallkim i pyjeve dhe celulozës! Ktheva kokën dhe pashë Ismailin që më vështronte. U ngrit. Ku vete, Ismail, ke De Rada? Parisin nuk e përmendnim asokohe.

10. - Fred, ku vete kështu? - më pyeti dikush që po hante.

- Po shkoj të gozhdohem në kryqin tim.

Nuk do ta përmend emrin e këtij njeriu. Ndofta një ditë do të kthehem përsëri në këto salla, ndofta atëherë kjo rrëmujë do të ketë mbaruar. Nuk do të përmend shumë emra të tjerë. Zoti i faltë! Këtu nuk e kam fjalën aspak për letrarët e qytetit ku kam lindur, që kanë aprovuar në kor arrestimin tim. Letrarët e qytetit tim ishin tepër të parëndësishëm, për të më bërë dëm mua. Ky qe njeriu që më bëri gjëmën. Ndofta është penduar se ka dy dekada që flet vetëm mirë për mua.

Do të doja më mirë të më priste në fyt. Unë i kam provuar prerjet: ato nuk të dhembnin sa tradhëtia e një miku. Mua më shumë më kanë tradhëtuar se më kanë prerë.

11. Pra, armiqtë më të pamëshirshëm për mua, kanë qenë miqtë. Lavdi Zotit, tani nuk kam asnjë mik.

12. Jashtë, te porta e Lidhjes takova Petro Markon. I zgjuar por i padjallëzuar, nuk dinte asgjë për mua. Mbledhjen e la, dhe vajtëm të pimë raki në Vjosa, lart te këndi ynë i preferuar. O Zot, sa i lumtur kam qenë me atë njeri që më deshi aq shumë, dhe se kuptova kurrë përse! Kohët e fundit vajta ta takoj pas kaq vitesh, por nuk pata fat, qe tepër sëmurë. Arrita në Tiranë shumë vonë. Më priti Safoja.

13. Kur erdha herën e dytë, ishte përsëri natë. Por ai kishte vdekur. Kishte lënë amanet ta çonin në fshatin e lindjes. Më priti përsëri Safoja. Si statuja e pikëllimit. Petro i dashur, të kam qarë me lotë, por unë nuk kisha para të të vija aty buzë detit. Unë jam i dënuar i vjetër politik, pa punë dhe pa para. Që atë natë, duhej ta kisha kuptuar marrëzinë e Itakës!

14. Vajta në hotel dhe qava për Petro Markon. Pastaj u luta për nënën dhe kujtova tërë të vdekurit e mi, atë natë në atë hotel të shtrenjtë të Tiranës, hotel xhamethyer dhe pa çarçafë.

15. 1991. Ishte hera e parë pas kaq vitesh që po takoja përsëri një turmë shkrimtarësh. Të zymtë dhe nevríkosa Antienveristë të tërbuar. Disidentë të shpallur në kolonat e "Dritës". Ismaili qe diku larg si përtej

kohës. Bilali nuk ishte më. Ah, ajo ëndrra e tij për Çamërinë, për dhentë e bardhë në muzg, për hënën e kallamishteve! Jakovi kishte vdekur. Edhe Lasgushi. Kishin tepruar vetëm këta antienvieristë të tërbuar, të mjerë dhe mediokër, si gjithnjë të gatshëm për hymne e ditirambe, nëpër shkallë e korridore. Nëqoftëse takoj Dhimitër Xhuvanin, atëherë zoti më do!

16. Para njëzet vitesh, në një nga dhomat e hetuesisë në burgun e vjetër të Tiranës, jam ballafaquar me një dëshmitar kokëfortë. Ai ngulte këmbë që unë kisha sharë E. H. Kur e pashë që qante për shenjtërinë e E. H. e godita. Mua më vunë prangat dhe më thyen kyçet.

Tani, pas njëzet vjetësh, ky erdhi dhe më shtrëngoi dorën.

Kujdes! - i thashë. – Unë e kam dorën të thyer, ti e din.

- Kam dëgjuar se nuk je anëtar i P(X). - Jam tepër i vendosur në lirinë time që e kam fituar vetë.

Unë kam humbur çdo gjë në jetë për këtë liri.

- Atëherë, ti qenke envierist, - më tha. E godita tepër rëndë me një mënyrë të vjetër burgu aty te shkallët e Lidhjes. Ra praptas. Gojën e kishte me gjak. Më erdhi turp. Desha ta ndihmoja por nuk mund ta prekja me dorë. Neveri!

17. Në një mbledhje u betua se do të më vriste. Në gjyqin tim dërgoi deklaratë kundër meje. Unë vetë se kam sulmuar kurrë atë njeri. Të jem i singertë, kjo ka ardhur edhe nga përbuzja. Bile, tani vonë e kam mbrojtur pikërisht kur shokët e tij po e sulmonin. Po ju, ç'keni me të? - u thashë. - Ju kenë qenë shokët e tij, miqtë e tij. Tani kërkoni të bëheni ujqërit e tij. S' u vjen turp! Sigurisht, edhe kjo hynte në marrëzitë e Ishullit që kisha shpikur unë.

18. Sigurisht kam mbajtur shënime të rregullta me hulumtime personale e dëshmi nga shtypi i huaj, vrojtime nga biseda të papublikuara nga jeta politike, ato ç'kam mundur të ruaj me dokumente nga takime të fshehta e misione të veçanta etj. Këto përbëjnë disa dosje të depozituara që do të publikohen mbase nga dikush tjetër.

19. Itaka ka qenë marrëzia e Homerit. Sikur të kishte zbritur përsëri nëpër ishuj të tillë, ai do të ishte bërë romancier i zakonshëm siç e jep Varnalisi. Nuk duhet të jetë e vërtetë fitorja e Uliksit mbi ta (mëtonjësit), dhe nuk do ketë patur kënaqësi dashurie në krevatin e Penelopës mes çiftit të mplakur. Shekuj më vonë ky do të quhej happy end.

20. Shungullima e Trojës mbeti pas, dhe këngëtari plak po largohej nga sheshet e gjakut, i verbër dhe madhështor. drejt ishullit të ëndrrës së tij. Në të vërtetë ai duhej të kërkonte një Trojë të re dhe jo të luftonte me poetët mëtonjës, aty ku e priste disfata: pasi ke lexuar fundin e Odisesë, e kupton që një Iliadë tjetër nuk mund të shkruhet më kurrë.

21. Gjithmonë kam menduar se Itaka ka qenë marrëzia e Homerit, dhe se tërë fisin e poetëve e pret ky fat. Ditën që shkrova dhe recitova Itakën, më denoncoi në MPB një poet i shquar.

Kam vendosur ta botoj këtë vjershë. Ndofta do të jetë botimi im i fundit. Jo, ishujt nuk ekzistojnë. Nuk ka kurrëfarë Itake në këtë botë!

DIKU, KUDO

Shi, ti fëmijë i vogël që qan prej mijëra vjetësh
Për ditën tënde të pangushëlluar,
Shfaqet dhe zhduket Itaka
Nën pasione vetëtimash.

Kam një pritje të vjetër dhe s' di ku ta lë. Tani duhej të isha diku përtej shiut Te dritarja fëmija lakuriq
Më vështron me sy prej uji.

Përditë më duhet të nxitoj drejt diçkaje që nuk është
Pra nuk jam një Odise i shpikur.

Por Itakën time e kam shpikur vetë
Se kam nevojë të domosdoshme për ishuj.

22. Itaka është një ëndërr. Është dëshira për t'u prehur një ditë nën një qiell të kaltër, pas tridhjetepesë vjet endjesh, i mallkuar nga një Poseidon me emrin E. H. Ç'është kjo vdekje e pafundme o Zot, bërë në gjashtë ditë?! Ditën e shtatë edhe Zoti u lodh e pushoi. Por e diela ime ka humbur.

23. Ja edhe Itaka që kam shpikur unë: Ca poetë të mjerë, të neveritur nga E. H., vargëzonjës të dështuar, kishin dëgjuar me kohë që muzat ishin diku. Tërë jetën duke pritur manna-n, si çifutët në shkretëtirë, të marrosur dhe injorantë. Mundet që ndonjëherë do të flas, ndonjëherë kur të shërohem nga alergjia, por, kur o Zot? Këta njerëz e kanë mundjen përbrenda, këta njerëz janë të mundur vetvetiu.

24. Kam bërë një barrë qejf. Por, kur jam i pikëlluar, bëj humor. Përsëri Itaka. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Këtu refuzuan të më pranojnë (megjithëse anëtar i vjetër që më 1967) por më vonë më ofruan shpejt e shpejt një rrogë të madhe që unë natyrisht, e përcjmoja. Kjo është Shtëpia Kriminale-Letrare e Partisë së Punës. E pra, ato ditë isha në mes të Tiranës pa lekë dhe pa hotel.

25. Homeri është serioz: me verbërinë e talentit, ai mbase ka zbuluar vendlindjen e tij, diku nën ullinjtë e ishullit, anës brigjeve ku motit barisnin perënditë. Por, perëndi nuk ka më. Homeri tani merret me gjëra të vogla, me derra, numëron dhentë dhe nuk e ka më atë sqimë me të cilën flet për mitet.

26. Artisti i vërtetë është i thirrur në këtë botë për të kënduar bukurinë e shpirtit njerëzor, për të kënduar tronditjet dhe mirësinë, për ta përsosur njeriun. Aristokracia e thërret artistin për ta denatruar, për ta bërë një predikues, një mag të mitit. Këtu është ndryshimi i mitologjisë me artin. Për magun krijimi është tradhëti, kurse artisti është demiurg.

27. Në lashtësi, Lukiani pyeste: cili je ti, i dashur, dhe si kërkon të bëhesh perëndi përderisa leh? Kjo aristokraci pra, e thërret edhe artistin që të lehë. Nëqoftëse ndërrohen faraonët,

ndërron edhe mënyra e të lehurit. Nuk është vetëm realizmi socialist që leh. Tërë poezia politike që lexojmë përditë, është lehje. Ka gazeta që kur i merr në dorë, të duket sikur do të të kafshojnë.

28. Edhe druri më i thjeshtë që ruan në kujtesën e tij të tëra ngjyrat dhe format e gjetheve që ka patur, e di se të çelësh sythe kur akoma nuk ka dalë dimri, është marrëzi: Një guxim i tillë zakonisht paguhet me të tëra lulet e të tëra gjethet. Atëherë, ku është Itaka?

29. Zot! Njeriu ka të drejtë të prehet një ditë, pas tmerreve që vetëm mendja e një të Verbëri madhështor do mund t'i sajonte. Asnjëri nuk ka patur nevojë më shumë se unë për ishuj. Por tërë ishujt janë të rremë.

30. Tërë të afërmit e mi që i shtija në dhomën time të vogël, ku nga stringlat e një poeti kanë tepruar shumë pak gjëra prej bastisjeve, kontrolleve e hetuesve, e dinë se tërë ato që shkruaj, i djeg. Më ngushëllon fakti se asnjëri prej tyre asnjëherë, nuk më ka qortuar për këtë.

31. Unë prisja ditën time. Sigurisht e dija se dita ime qe tepër larg, na ndanin male të tëra kohe. Kam kaluar shumë netë përballë dritares pa xhama, duke vështruar yjet si budalla, në një temperaturë minus 10 gradë C, mbështjellë me batanijen e hetuesisë.

32. Mëngjeseve, më ka qëlluar që, duke pritur në oborrin e burgut, tasi të më mbushej me dëborë. Kam qenë poet i pabindur vërtetë. Por kam duruar shumë sepse e dija se dita ime ishte diku: një ishull i kaltër ku më në fund mund të merresha seriozisht me letërsi, t'u tregoja njerëzve se sa shumë i doja.

33. Kam patur hetues që donte të më vriste me maqinën e shkrimit pasi unë nuk firmosja procesverbalin që qe me gabime gjuhësore. Kam patur hetues që më shtrëngonte prangat derisa më kullonte gjak nga thonjtë. Pastaj më kafshonte si qentë në sup dhe në krah. Kam parë mishin tim në dhëmbët e tij!

34. Të gjitha këto jam gati t'i duroj përsëri, por që të më thonë se një nga këta hetues është bërë antienvierist dhe demokrat, këtë nuk e duroj dot. Ai që do të ma thotë një gjë të tillë, ka për të qenë armiku im më i keq.

35. I sëmurë dhe delikat, disa herë jam përplasur në çimenton e të vdekurit, me një gardian të tmerrshëm mbi kokë që kërkonte të dinte si vdes një njeri nga hemoragjia akute, dhe si reagon kur duan të shuajnë cigaren në syrin e tij. Isha i sigurt që ky gardian nuk qe njeri, përndryshe, me kohë do ta kisha mallkuar tërë fisin njerëzor. Nuk kam aspak ndër mend të shkruaj për gjëra të tilla, por dua të them që kam duruar shumë.

37. I shtyrë nga një magji e bukur mbase, pasi kisha djegur një turrë me dorëshkrime për të cilat kisha punuar

vite të tëra, dola të kërkoj shirita për maqinë shkrimi dhe zarfa. Dy netë më parë kisha lexuar Homerin. Një natë më parë kisha ruajtur një nga miqtë e mi më të mirë, të vdekur. Pra nuk ishte koha për të bërë marrëzira letrare. Siç e thashë, ka qenë dhjetor. Pranvera ishte tepër larg.

39. Ca zogj të zinj vraponin në ajër si të trembur nga një dimër që rend. Më erdhi keq për zogjtë. Befas m'u shpik një frikë e tmerrshme: nëna!

Ajo kishte nevojë për kujdesje të vazhdueshme. Flinte. E bukur, pakëz e zbehtë, me flokë të zinj dhe të gjatë të hedhur mënjanë.

Oh, nënë, nëqoftëse ti ikën tek yjet, nuk e di se ç' do të bëj më në këtë botë! Nuk do të kalonin shumë kohë dhe unë do të puthja buzë varrit duart e njeriut që kam dashur si Zotin!

41. Nuk keni të drejtë të shfrytëzoni popullin tim, të shkelni dinjitetin e të varfërve! Kjo është porosia e Providencës që e jep Isaia (3:13-15) në Testamentin e vjetër. Vetëm në Shqipëri jep intervistë një ministër që vjedh. Vetëm në Shqipëri një njeri vjedh dhjetë metra tub, dhe lë një qytet pa ujë, një qytet që ka patur akuadukte që para Krishtit!

42. Vendi im i dashur! Toka ime e dhembshur dhe fatkeqe! Edhe unë si të gjithë poetët, kisha shpikur një Itakë. Po cili do të më shesë tani? Ndoshta do të kthehem pas një vetmie tjetër. Ndoshta nuk do të kthehem më, kurrë. Këtë e di vetëm Zoti.

43. Vendi im ka patur fatin më të keq në tërë Lindjen. Ky fat ka për ta ndjekur përsëri si në ato baladat tona ballkanase. Shpresa është një virtyt. Megjithkëtë, a nuk është thënë se ka edhe të sëmurë nga virtyti? Por, në fund të fundit, secilës ditë i mjafton pikëllimi i vet, tha Jezui në mal. Për nesër, mendon Zoti.

46. E diela ime ka humbur! Tani mund të them se në të vërtetë, nuk kam pasur asnjë të diel në jetën time. Kam qenë shumë fatkeq në kalendarin e ditëve, sidomos mungesën e të dielës e kam ndjerë shumë.

47. Më parë, aty jashtë ra një zog. Është shpirti i drurit që po vdes nën fatkeqësinë e hënës. Shkrova se shirat janë krenaria e fenomeneve qiellorë.

48. Jam i trishtuar si rënia e gjetheve në një akuarel shiu. Sot mora një letër nga një njeri që kam dashur dikur. Pas njëzet vjetësh. Shpata ka rënë, nuk ka më luftë klasash.

49. Ishte dikur një akuarel shiu që rrodhi si loti i botës, o njeri! shkrova mbi shpinë të letrës. Ishte dikur një rënie gjethesh që mbështillte supet tua lakuriq.

50. Ndenja me shpinë nga dita, për të mos parë si zhdukej ishulli që kam ëndërruar kaq dekada. Lamtumirë Itakë!

Prill 1992

Poezi: Agron TUFA

TËHUJTJA

Faji ma bën tejet të largët, të pambërrishme
dhe njëherësh të ëndërruar, shtëpinë.
Faji ma bën t'hyjnishme,
ma vesh me dëshirë
shtëpinë që më zboi pa mëshirë ndaj të gdhirë.
Nata bie. Shtëpiza ndez dritat dhe bëhet brorore.
Brenda është parajsja idilike, përrallore,
me prind, me vëllezër, me motra, siç ishte njëherit...
Unë jam nata e ftohtë, jam ndërgjegjja e territ,
që s'duhet të hyjë brenda. Jam lëmshi i vajit.
Jam faji dhe dënimi i fajit.
2024

LAGJJA NË MUZG

Marsi në të dalë – prilli në të hyrë,
muzgu s'mbijeton veçse si mynxyrë.
Me një djegë të fshehtë e fiksimit ngulmues
çlirohen n'ajri shpirtra kundërmues
jargavanësh, plagësh, brengash anonime,
fjalësh të pathëna për pengje intime.
Është ora kur mëdyshja nuk di ku të struket,
kur dhe ylli i parë mezi nëpërduket
ndër retë e shpëlara – supë e murrme lakre,
kur dritat vonojnë të ndizen në lagje,
kur gjithçka lëmeket dhe shkrihet në bruz,
kur kthehen nga puna etërit vramuzë
me xixa që u ndizen e fiken ndër buzë.
Atëherë amvisave zënë t'u kruhen shalët,
shpirtrat e muzgut zbresin ngutas shkallët
dhe treten zgëqeve, bodrumeve, fustaneve;
jep shpirt në brekë aromë e jargavanëve
dhe dritat ndizen si në ritual të lashtë.
Dyert mbyllen. Diç prore mbetet jashtë.
Diç prore tërhiqet papërcaktueshëm në hije,
si e qara pa ngushëllim e një fëmije,
si diç që u druhet fjalëve, ndonëse diç e thekur,
por më fort si era e gjellës së djegur.
2024

KA DIÇ QË S'TË BIND

Ka diç që s'të bind në këto pamje, në shije, në aromë.
Ka diç që s'të bind në vërtetësinë e sendeve në dhomë.
Ka diç që s'të bind në arkipelagët pluskues të reve n'ajri.
Ka diç që s'të bind në rroba, lëkurë, rropulli.
Ka diç që s'të bind as në të vështruar, as në të prekur.
Ka diç që s'të bind në të qenët gjallë, në të qenët vdekur.
Dhe bindja që s'bind përhap paprâ metastaza e gjëndra,
sepse diç që s'bind është kallur në hamendje dhe ëndrra,
pushton me dyshime karteziante ekzistencën mbarë –
tok me pasionin tënd të topitur atdhetar.
Dhe bindjen që s'bind s'e di në e ke mallkim apo prikë,
sepse ka diç që s'bind
dhe pikë.

Ka diç që s'të bind në plasaritjen e agut me vesë.
Ka diç që s'të bind në poteren e dalldisur me shpesë.
Ka diç që s'të bind në shkrepimën e diellit të ri.
Ka diç që s'të bind nga zërat e zgjimit në shtëpi.
Ka diç që s'bind qysh në të parën përshëndetje
dhe s'të bind, pas kësaj, as fjalë, as buzëqeshje.
Dhe bindja që s'bind e bën ditën të gjatë – Golgotë
me kryqin e rëndë që bart ta shpiësh në Kuotë
gjersa të sosësh me frymë, para se të bjerë terri;
por dhe Kuota dhe terri s'të bindin njëheri
dhe kryqi ku varesh e ku tash kullon gjak –
s'të bind aspak.
2022

GJUETIA E DELEVE TË ZEZA

Para bindjes a mbas bindjes, pa sinorë,
për tekë a delir gjyshnash zuni fill
vështrimi vëngërosh i Hyjit mënimadh.
Ai grishi legjione me demonë mizorë,
me na mbyllë të tanëve – dele t'zeza n'vathë.
Sa herë ndonjë dele turret me dalë jashtë,
kokrra e rrufesë i pëlçet në rrashtë.

Asht kjo duhmë shkrumbi që varet mbi ne
lkura jonë që digjet, gjuejtun me rrufe.
2021

OSE JETA ËSHTË E SHKURTËR, OSE ZGJIMI ËSHTË I VONË

Ose jeta është e shkurtër, ose zgjimi është i vonë;
ose pengu i jetës në koma vjen e vret më shumë –
zgjimi në mesmoshë... keqardhja që sëmbon...
E kam një brinjë prej uji që natës rrjedh në gjumë.

Brinja ime prej lumi çan tejprtej mes territ,
ngarkuar me ëndrra të rënda që rrjedha i mbyl në det:
ç'fat të dëlirësh natën kurmin nga barra e misterit
dhe brinja tjetër e kaltër të digjet në zjarr të lehtë!

Kësaj jete i ngjitesh në majë veç me pak gjëra, në këmbë,
ashtu si alpinisti: një çantë, litar dhe kthetra dëbore...
Shkarkojeni veten – këtë anije tonazhi të rëndë
dhe flakini ëndrrat e mëdha në rrjedhën pluskore –

pa grimë keqardhjeje! Nuk përmbushen kurrë!
Lumi i fryrë i brinjës i merr të tëra me vete,
si trarët e mëdhenj, të krimbur e të kalbur,
kur shembet me rropamë një urë.

Kjo jetë do pesha të lehta dhe lyp shëndet atletik;
utopitë janë krusma ndër hekatomba flijimi.
Që nën vete mos t'ju gorrormisin ëndrrat e mëdha –
ruqjeni njërin brinjë prej lumi, si valvul shkarkimi,
2023

ATDHE M'U BËNË IDETË

Atdhe m'u bënë idetë që i ngroh ëmbël në kllockë
me kurmin e mërdhirë, në folenë më të lartë
të kavakut dimëror, të zhveshur, pilirak –
si një klithmë me penel mes trishtimit fusharak.

Idetë m'u bënë Atdhe, i dehur me vetmi
në folenë më të lartë, ku nuk ngjitet asnjëri,
ku i kaltri gjak venoz mezi shtyhet pikë-pikë,
ku dhe kllocka e pangrohur në fole, ka rrezik

mos me çelë zogj të gjallë. Për një stinë. Për një vit.
Për një jetë që përpëlitet me Atdheun-kockë në fytyrë.

2024

(Nga vëllimi "Njeriu buzë lumit", Onufri, 2024)



Tregim

SHTRËNGATË MBI LUMË

**Dino BUXATI**

Kallamat e ujit, barishtet buzë bregut, kaçubat e vogla prej shelgu si dhe pemët e larta, panë asaj të diele shtatori një zotëri plak, të veshur krejt në të bardha. Shumë e shumë vite më parë, - vetëm trungjet më të moçëm e mbanin pakëz mend, - një i panjohur nisi të peshkonte aty në atë kthesën e vetmuar të lumit, ku ujërat rrjedhin më të qeta.

Ai vinte të kremteve, kur bënte mot i mirë. Një ditë ai nuk erdhi vetëm: bashkë me të ishte një fëmijë, që dëfrente korijeve dhe kishte një zë të ëmbël. Vitet kaluan si pa u ndierë. Zotëria plakej e thyhej gjithnjë, ndërsa fëmija rritej e lulëzonte. Më në fund, një ditë pranvere, zotëria plak s u pa më. Erdhi ai djaloshi, i cili nisi të peshkonte fillikat. Pastaj koha bëri punën e vet, - ikte e ndryshonte. Djaloshi, që me sa dukej nuk harronte të vinte, e humbi atë zërin e ëmbël, sepse edhe ai filloi të plakej e të gërmuqej. Një ditë edhe ai erdhi vetë i dytë.

Kjo është një rrëfenjë që s'ka të sosur, pas së cilës tërë pylli linte kokën. Fëmija i dytë u rrit, mirëpo babait të tij as që ia pamë më sytë. Më vonë kjo ngjarje u bë lëmsh në kujtesën e pemëve. Ka disa vite që peshkatarët ndodhen përsëri aty. Muajin e kaluar, bashkë me zotërinë e veshur në të bardha, erdhi edhe fëmija, që u ul me kallam në dorë e nisi të peshkonte. Pemët hidhnin vështrimin, të lumtura. Mezi prisnin që të vinin ata, mes asaj vetmie në lumë. Sa të qetë ndiheshin kur i shihnin që peshkonin! Ato dëgjonin si fliste fëmija dhe zëri i tij i hollë, që kumbonte nëpër gjethë, u bënte

çudi. Teksa i shikonin ashtu të palëvizur, ulur buzë bregut e të heshtur si vetë lumi, kënaqeshin, ndërsa lart në qiell kalonin retë.

Një mizë tregoi se baba e bir i ngrysnin ditët në një shtëpi të madhe, rrëzë shpatit këtu afër. Mirëpo pylli se dinte cilët ishin ata. Dinte vetëm se ngjarjet kanë rrugën e vet dhe se herët a vonë zotëria sigurisht që sdo të kthehej më, kësaj djaloshit do ti duhej të vinte vetëm.

Edhe sot, në të njëjtën orë, u dëgjua një fëshfërimë gjethesh dhe zhurmë hapash, që sa vinin e afroreshin. Po si për çudi zotëria u shfaq i vetëm, ashtu pakëz i kërrusur, i dobët e i rraskapitur. Pas pak mori për nga kasollja e vogël, e mbuluar përgjysmë me degët e pemëve, ku ruheshin takëmet e peshkimit. Kësaj here u vonua ca, duke kërkuar nëpër rrangullat e vjetra, në atë shtëpi të heshtur. Tashmë çdo gjë ishte e qetë. Edhe kambana e kishës aty pranë i kishte pushuar tingujt. Peshkatarit hoqi xhakëtën. Me kallam në dorë e me fijen në ujë, i ulur rrëzë një plepi, dukej si një vulë e bardhë mes atij gjelbërimi. Në qiell u dukën dy re të mëdha. Njëra ngjante me turirin e një qeni, ndërsa tjetra kishte formën e shishes.

Pylli u shqetësua, ngaqë fëmija s'po dukej. Bimët e ujit lëviznin ngaherë enkas, për të trembur peshqit e për tia çuar sa më afër peshkatarit tonë të vogël. Ai përqendrohet, ndonëse fillikat, me fytyrën të zbehur e qejfprishur. Po edhe sikur peshqit të mos vinin, zotërisë as që di ti hynte në sy. Me kallam në dorë vështronte rreth e rrotull, si me

përtesë.

Kallamat në breg të lumit tani kanë punë me një trung të madh. Trungu ishte përzierë me barishtet dhe gjeti rastin të rrëfente një ngjarje. "Dikur, ia nisi ai, - shërbeja si këmbë ure, po pastaj u lodha nga pesha dhe e shemba ç'kisha mbi shpinë."

Kallamat janë bërë vesh e dëgjojnë, mirëpo seç thonë njëra me tjetrën, duke shpërndarë përreth një çuçurimë, që merr lëndinën mbarë, gjer te majat e pemëve, dhe që më pas tretet bashkë me erën. Peshkatarit ngriti kokën, vështroi rrotull, a thua se edhe ai kishte dëgjuar diçka. Nga kasollja aty afër u dëgjua një dy-tre goditje të thata, me prejardhje të pakuptimtë. Një mizë e madhe kishte mbetur e mbyllur aty. Qe hutuar për një çast dhe tani sillet më kot nëpër dhomë. I duhet të ndalte shpesh fluturimin e të mbante vesh. Shoqet e saj kushedi për ku do ta kenë mbajtur frymën. Disi i çuditshëm ky ajër i rëndë!

Por miza nuk e kuptonte që tani trokiti vjeshta, prandaj përplasej sa andej-këtej. Dëgjohej pas xhamave goditje të lehta të trupit të dhjamur. Më në fund e kuptoi që qe e kotë, mbasi mizat e tjera kishin ikur. Përmes xhamave dukej një re, që paralajmëronte shtrëngatën.

Zotëria ndezi një cigare. Nganjëherë ngrihej prej degëve një valë e kaltër tymi. Fëmija nuk po duket tani, sepse pasditja do shumë kohë të vijë. Më në fund, pas përpjekjesh të mëdha, miza arriti të dilte nga kasollja. Ndërkohë dielli qe struktur prapa reve. Pak më parë era largoi nga kallamat trungun, duke e shtyrë përpara, mes ujërave që rridhnin

pa pengesë. Këtu ngjarja u ndërpre papritur, s'dihet pse. Trungu u largua sikur të ishte i dënuar që udhëtonte drejt detit. Filloi shtrëngata, po ku pyeste peshkatarit! Rrinte i palëvizur, me shpinën mbështetur pas një trungu peme. Prej bishtit të cigares së hedhur dilte një fijez tymi, të cilën e thyente era.

Retë erdhën e u nxinë dhe sakaq filluan pikat e para të shiut. Aty-këtu, mbi sipërfaqen e ujit, formohen disa rrathe të përsosur, që zgjerohen dora-dorës. Brenda në kasolle goditjet përsëriten më me ngulm, në një mënyrë të pashpjegueshme. Vallë pse zotëria nuk ngrihet të ikë? Një pikë shiu ra mu në bishtin e cigares së ndezur. U dëgjua një cijatje e lehtë dhe cigarja u shua.

Nga një mazgallë në mur, andej nga ana e perëndimit, vërshonte një dritë e ftohtë, e bardhë. Era përplasej pas pemëve dhe lëshonte një zë të përvajshëm, madje ajo tundte edhe xhakëtën e bardhë, që zotëria e kishte varur në një gëthep. Pemët e larta, kaçubat prej shëlgjesh, barishtet në breg dhe bimët e tjera të ujit i thirrën mendjes. Dukej sikur peshkatarit po flinte, ndonëse gjëmimet binin që përtej horizontit. Koka i përkulet pak përpara, ndërsa mjekra i mbështetet lehtë në kraharor. Barishtet e mbuluara nga uji fillojnë të dridhen, për të trembur peshqit e për t'ia afruar peshkatarit, siç bënin përherë. Por kallami, i pambajtur, ulet lehtë-lehtë. Maja e tij prek ujin. Vala e qetë, teksa përplasat pas saj, formon një kreshtë që mezi duket.

(Nga origjinali: Robert ANASTASI)

Nobelistët e letërsisë

POETI DHE BOTA

Ka pasur, ka dhe do të ketë gjithmonë një grup njerëzish të cilët i viziton frymëzimi

Visllava SIMBORSKA

Thonë se fjalë e parë në çdo fjalim është gjithmonë më vështira. Sido qoftë, unë tani e kalova këtë. Por, kam ndjenjën sikur fjalitë e ardhshme - e treta, e gjashta, e dhjeta e kështu me radhë deri tek rreshti i fundit - do të jenë po aq të vështira, pasi që më duhet të flas për poezinë. Kam folur shumë pak për këtë temë, gati asgjë, në fakt. Dhe, sa herë që kam thënë diçka, gjithmonë më ka brejtur dyshimi se nuk jam shumë e zonja për këtë. Për këtë arsye, ligjëratat ime do të jetë e shkurtër. Të gjitha mangësitë mund të durohen më lehtë, nëse servohen në doza të vogla.

Poetët bashkëkohorë janë skeptikë, madje edhe të hamendur, sidomos kur flasin për veten e tyre. Ata pranojnë publikisht se janë bërë poetë pa dashur, thuajse janë paksa të turpëruar prej kësaj. Por, në kohët tona të zhurmshme, është shumë më lehtë të njohësh të metat tua, të paktën nëse janë të paketuara në mënyrë tërheqëse, sesa të njohësh meritat, pasi që këto fshihen më thellë dhe ju kurrë nuk besoni plotësisht në to... Me rastin e plotësimit të pyetësorëve, apo të bisedës me të panjohur, kur ata nuk mund të mos zbulojnë profesionin e tyre, poetët parapëlqejnë të përdorin termin e përgjithësuar "shkrimtar", apo të zëvendësojnë fjalën "poet" me atë të çfarëdo pune tjetër që bëjnë krahas të shkruarit. Burokratët dhe udhëtarët e autobusit reagojnë me një dozë mosbesimi dhe shqetësimi sa herë kuptojnë se kanë të bëjnë me një poet. Ma merr mendja se edhe filozofët mund të hasin në reagime të ngjashme. Po, prapë se prapë, ata janë në pozitë me të lakmueshme, pasi që ata të shumtën e rasteve kur mund ta zbulojnë profesionin e tyre me ndonjë titull akademik. Profesor i filozofisë kjo tingëllon më e respektueshme.

Po, profesorë të poezisë nuk ekzistojnë. Kjo do të thoshte, në fund të fundit, se poezia është një profesion që kërkon studim të specializuar, provime të rregullta, artikuj teorikë me bibliografi dhe fusnota dhe, së fundi, më diploma të dhëna me ceremoni. Dhe, kjo do të thoshte, nga ana tjetër, nuk mjafton që të mbushni faqet me poezi edhe më elegante që të mund të bëheni poet. Elementi kyç është shkarje letre që ka një vulë zyrtare. Të rikujtojmë se krenaria e poezisë ruse, laureati i nesërm i Nobelit, Jozef Brodski, u dënua njëherë me internim të brendshëm pikërisht për arsye të tilla. Atë e quajtën "parazit", sepse atij i mungonte vërtetimi zyrtar që do t'i jepte atij të drejtën të ishte poet...

Para disa vjetësh, kisha nderin dhe kënaqësinë ta takoja Brodskin personalisht. Më ra në sy se, nga të gjithë poetët që kisha njohur, ai ishte i vetmi që kënaqej kur e quanin poet. Ai e shqiptonte këtë fjalë pa asnjë ngurrim. Përkundrazi, ai e thoshte atë me një liri sfiduese. Më duket se kjo ishte kështu, nga që atij i kujtohej poshtërimi brutal që kishte përjetuar në rininë e tij. Në vende më fatlume, ku dinjiteti njerëzor nuk sulmohet me aq lehtësi, poetët gjakojnë, s'do mend, që të jenë të botuar, të lexuar dhe të kuptuar, por ata nuk bëjnë pothuajse asgjë që vihen mbi turmat e zakonshme dhe bluarjes ditore. Ndonëse, jo fort moti, në dekadat e para të këtij shekulli, poetët janë orvatuar të na tronditin me veshjen e tyre ekstravagante dhe sjelljen e tyre ekscentrike. Por, e tërë kjo është bërë vetëm për hir të shfaqjes publike. Erdhi momenti kur poetët u detyruan të mbyllnin derën pas tyre, të zhvishnin mentalitetin e vet, stringlat e tyre dhe takimet e tjera personale dhe të ballafaqoheshin - në heshtje, duke pritur me durim vetveten e tyre fletën akoma të



bardhë të letrës. Sepse, kjo është ajo që ka vlerë të vërtetë.

Nuk është e rastit që biografitë filmike të shkencëtarëve dhe artistëve të mëdhenj punohen me grumbuj. Regjisorët më ambiciozë mëtojnë të riprodhojnë në mënyrë bindëse procesin krijues që çon drejt zbulimeve të rëndësishme shkencore apo drejt lindjes së një kryevepre. Dhe, ju mund t'ia dilni deri diku me sukses të përshkruani disa lloje të punës shkencore. Laboratorët, instrumentet e ndryshme, makineria përpunuese që aplikohet në jetë: skena të tilla mund të mbajnë përqendrimin e publikut për një kohë. Por, ato momente të pasigurisë a do të sjellë eksperimenti, i përsëritur me mijëra herë me fare pak modifikime, rezultatin e dëshiruar? mund të jenë shumë dramatike. Filmata lidhur me piktorët mund të jenë spektakolare, pasi që merren me rikrijimin e secilës etapë të evolucionit të një pikturë të famshme, që nga vija e parë me laps deri tek rënia e fundit me brushë.

Muzika fryhet në filmat mbi kompozitorët: notat e para të melodisë që tingëllon në veshët e muzikantit më në fund dalin si vepër e pjekur në formë simfonike. Natyrisht, e tërë kjo është fare naive dhe nuk shpjegon gjendjen e pazakonshme mendore, të njohur në popull si frymëzim, por të paktën, është diçka që mund ta shikoni dhe ta dëgjoni. Por, poetët janë më të këqijë. Puna e tyre është pandreqshmërisht jofotogjenike. Dikush rri ulur pranë një tavoline, apo rri shtrirë në një divan pa lëvizur, me shikimin e tretur në ndonjë mur apo tavan. Herë pas herë, ky person shkruan në letër disa vargje vetëm sa për t'i fshirë prapë pas pesëmbëdhjetë minutash dhe pastaj kalon edhe një orë tjetër, gjatë së cilës nuk ndodhë asgjë... Kush do të mund të duronte ta shikonte këtë gjë?

Përmenda frymëzimin. Poetët bashkëkohorë përgjigjen me bishtnim sa herë pyeten se çfarë është ai dhe nëse ai ekziston në të vërtetë. Nuk është se ata nuk e dinë bekimin e cytjes së tyre të brendshme. Vetëm se thjesht nuk është lehtë t'i shpjegohet dikujt tjetër që nuk e kuptoni as vetë ju. Kur më pyesin për këtë më ndonjë rast, edhe unë vetë i ik përgjigjes. Por, përgjigja ime është kjo: frymëzimi nuk është privilegj ekskluziv i

poetëve apo i artistëve në përgjithësi. Ka pasur, ka dhe do të ketë gjithmonë një grup njerëzish të cilët i viziton frymëzimi. Atë e përbëjnë të gjitha ata, të cilët me vetëdije e kanë zgjedhur profesionin e tyre dhe që bëjnë punën e tyre me dashuri dhe imagjinatë. Në të mund të hyjnë mjekë, mësues, kopshtarë dhe unë do të mund të numëroja edhe qindra profesione të tjera. Puna e tyre bëhet një aventurë e vazhdueshme përderisa ata do të jenë në gjendje të vazhdojnë të zbulojnë sfida të reja në të. Vështirësitë dhe pengesat nuk e shuajnë kurrë kureshtjen e tyre. Një mizëri pyetjesh të reja dalin nga secili problem që ata zgjidhin. Çfarëdo që është frymëzimi, ai lind nga një "nuk e di" e vazhdueshme.

Nuk ka shumë njerëz të tillë. Shumica e banorëve të tokës punojnë sa për të bërë diçka. Ata punojnë nga që janë të detyruar. Ata nuk zgjedhin këtë apo atë punë nga pasioni; rrethanat e jetëve të tyre bëjnë zgjedhjen për ta. Punë pa dashuri, punë të mërziutshme, punë që vlerësohen vetëm nga që të tjerët nuk kanë as aq, sado pa dashuri dhe të mërziutshme - kjo është njëra ndër mjerimet më të ashpra njerëzore. Dhe, nuk ka asnjë shenjë se shikojt që do të vijin do të sjellin çfarëdo ndryshimi për të mirë a për të keq sa i përket kësaj.

Dhe, kështu, ndonëse unë mund t'ua mohojë poetëve monopolin e tyre mbi frymëzimin, unë akoma i vendos ata në një grup të përzgjedhur të mikluarve të Fatit. Në këtë pikë, ndërkaq, në mesin e auditorit mund të lindin dyshime. Të gjitha llojet e torturuesve, diktatorëve, fanatikëve dhe demagogëve, që luftojnë për pushtet përmes disa parullave të thëna me britmë, po ashtu janë të kënaqur me punët e tyre dhe ata gjithashtu kryejnë punët e tyre me zjarr inventiv. Po, por ata "dinë". Ata dinë dhe po ashtu të ri nën këtë diell, pasi që ata që kanë jetuar para teje nuk po e mundur ta lexojnë poezinë tënde. Dhe, ai qiparis, nën të cilin prehesh nuk është rritur që nga agui i kohës. Ai lindi siç ka lindur edhe ndonjë qiparis tjetër si yti, por jo plotësisht i njëjtë me të.

Dhe, Eklesiast, do të doja po ashtu të të pyesja se në ç' gjë të re nën diell ke ndër mend të punosh tani? Një plotësim të mëtejme të mendimeve që tashmë i ke shprehur? Apo, ndoshta, t'ua mbushur

mendja që t'i kundërshtosh disa prej tyre tani? Në veprën tënde të mëhershme, ti përmend gëzimin - po çfarë nëse ai është përfutur? Pra, ndoshta poezia jote e re nën këtë diell do të jetë për gëzimin? A ke mbajtur ende shënime, i ke skicat? Druaj se do të thuash, "kam shkruar çdo gjë kam pasur për të shkruar, nuk kam asgjë për të shtuar".

Nuk ka poet në botë që mund ta thotë këtë, aq më pak një poet i madh si ti". Bota, çfarëdo që mund të mendojmë kur tmerrohemi nga pafundësia e saj dhe nga paaftësia jonë, apo të hidhëruar nga indiferenca e saj ndaj vuajtjes individuale, të njerëzve, kafshëve, madje edhe të bimëve, pasi që pse të jemi të sigurt se bimët nuk ndejnë dhembjen; çfarëdo që të mendojmë për hapësirat e saj të shpuara nga rrezet e yjeve të rrethuar nga planetët që vetëm tani kemi zënë t'i zbulojmë, planete tashmë të vdekura? Akoma të vdekura? Ne nuk e dimë; çfarëdo që mendojmë për këtë teatër të pamasë për të cilin kemi tiketa të rezervuara, por tiketa jetëgjatësia e të cilave është në mënyrë qesharake e shkurtër, të kufizuara nga dy data arbitrare; çfarëdo tjetër që të mendojmë për këtë botë ajo është e mahnitshme. Por, "e mahnitshme" është një epitë që fshihet brenda një kurth logjik. Jemi të mahnitur, tek e fundit, nga gjëra që i shmangen ndonjë norme të njohur dhe universalisht të pranuar, nga një qartësi me të cilën jemi mësuar. Tani, çështja është se nuk ka botë të tillë aq të qartë. Mahnitja jonë ekziston vetvetiu dhe nuk mbështetet në krahasim me diçka tjetër. Vetvetiu, në të folurit ditor, ku ne nuk ndalemi për të shqyrtuar secilën fjalë, ne të gjithë përdorim fraza, si "bota e rëndomtë", "jeta e zakonshme", "rrjedha normale e ngjarjeve"... Por, në gjuhën e poezisë, ku çdo fjalë peshohet, asgjë nuk është e rëndomtë apo normale.

As një gur i vetëm dhe as një re e vetme mbi të. As një ditë e vetme dhe as një natë e vetme pas saj. Dhe, mbi të gjitha, asnjë ekzistencë e vetme në këtë botë. Duket sikur poetët do ta kenë gjithmonë punën që është bërë enkas për ta. (Përktheu Avni Spahiu)

P.S.
Visllava Simborska, fituesi e Çmimit Nobel, 1996

Profile: Elizabeth Tejlor

LINDJA E YLLIT TË PËRJETSHËM TË KINEMASË

Përtej botës së filmit dhe bukurisë, Elizabeth Tejlor ishte një grua me një shpirt bamirësie dhe guximi. Ajo ishte një nga figurat e para publike që u angazhua fuqishëm në luftën kundër HIV/AIDS në një kohë kur stigma ndaj sëmundjes ishte e lartë



Leonard VEIZI

Përpara viteve 90, emri i Elisabet Tejlorit - apo Lis Tejlorit siç njihet për më shkurt, - ishte gati një herezi në Shqipërinë Komuniste. Ajo dhe Merlini Monroe aq që mund të mendoheshin të shfaqeshin në ekranin e televizionit shtetëror. Por pas rrëzimit të Murit të Berlinit shqiptar, Televizioni me siglën "Tirana" nisi të transmetojë filmat e saj. Dhe telespektatori u mahnit kur pa Lis Tejlorin të portretizonte mbretëreshën egjiptiane të dashuruar me gjeneralin romak Mark Antonin tek filmi "Kleopatra". Ky ishte dhe një nga filmat më spektakolarë të karrierës së saj. Ndaj dhe sot, ajo vazhdon të jetë një figurë ikonike për dashamirësit e kinemasë në Shqipëri...

...Elizabeth Tejlor nuk ishte thjesht një aktore hollivudiane; ajo ishte një ikonë e pavdekshme, një grua me një prani të rrallë artistike dhe një jetë plot pasion, sfida dhe humanizëm. Me sytë e saj të purpur magjepsës dhe talentin e jashtëzakonshëm, Tejlor e shndërroi çdo rol në një vepër arti dhe çdo skenë në një moment të paharrueshëm të historisë së kinemasë.

Nisja

E lindur më 27 shkurt 1932 në Londër, Elizabeth Rosemond Tejlor u shpërngul në Shtetet e Bashkuara bashkë me familjen e saj në prag të Luftës së Dytë Botërore. Babai i saj ishte një tregtar arti dhe biznesi i tij e solli atë në kontakt me anëtarët e elitës së Hollivudit. Ndonëse nëna e saj, një ish-aktore e skenës, fillimisht kundërshtoi lejimin e Tejlor-it të ri të hynte në industrinë e filmit, një prezantim me kryetarin e "Universal Pictures" përmes një prej klientëve të babait të saj çoi në një test ekрани.

Karriera

Karriera e saj nisi që në fëmijëri. Në vitin 1942, Taylor realizoi filmin e saj të parë, "There's One Born Every Minute". Por në vitin 1944 u angazhua me filmin "National Velvet", ku spikati si një yll premtes. Ishte vetëm fillimi i një rrugëtimit artistik që do ta bënte një nga aktoret më të vlerësuara të të gjitha kohërave. Në vitet '50 dhe '60, ajo u bë një figurë e pashmangshme në kinematografi me role të paharrueshme në filma si "A Place in the Sun", në vitin 1951, "Cat on a Hot Tin Roof" në vitin 1958 dhe "Cleopatra" në vitin 1963. Për rolin e saj në "Butterfield 8" në vitin 1960 dhe "Who's Afraid of Virginia Woolf?" në vitin

1966, ajo fitoi dy çmime Oscar për aktoren më të mirë. Interpretimi i saj në këto filma nuk ishte vetëm një demonstrim i talentit të saj, por edhe një pasqyrë e emocioneve të fuqishme dhe kompleksitetit të karaktereve që portretizonte. Karriera e Taylor filloi të binte në fund të viteve 1960, megjithëse ajo vazhdoi të luante në filma deri në mesin e viteve 1970

Jeta

Elizabeth Taylor nuk ishte vetëm një aktore e jashtëzakonshme, por edhe një figurë e njohur për jetën e saj personale, e cila shpesh bëhej titull kryesor në media. Martesat e saj - tetë në total, përfshirë dy herë me Riçard Bërton - e bënë atë një simbol të dashurisë së madhe, pasionit të zjarrtë dhe dramës romantike. Ajo dhe Burton, përveçse ishin një çift ikonë, ndanë gjithashtu një dashuri të përbashkët për artin, poezinë dhe jetën luksoze. Të quajtur nga mediat si "Liz and Dick", ata luajtën së bashku në 11 filma. Pavarësisht nga skandalet dhe thashethemet që e rrethonin, Tejlor e mbajti gjithmonë dinjitetin dhe forcën e saj, duke u bërë një figurë e admiruar për vendosmërinë dhe sinqeritetin e saj.

Bamirësja

Përtej botës së filmit dhe bukurisë,

Elizabeth Tejlor ishte një grua me një shpirt bamirësie dhe guximi. Ajo ishte një nga figurat e para publike që u angazhua fuqishëm në luftën kundër HIV/AIDS në një kohë kur stigma ndaj sëmundjes ishte e lartë. Themeli i saj, "Elizabeth Taylor AIDS Foundation", vazhdon të ndihmojë pacientët edhe sot. Humanizmi i saj, së bashku me vendosmërinë për të ndihmuar ata që ishin në nevojë, e bënë atë jo vetëm një legjendë kinematografike, por edhe një simbol të dhembshurisë dhe guximit.

Trashëgimia

Elizabeth Tejlor iku nga kjo botë më 23 mars 2011, por trashëgimia e saj mbetet e paprekshme. Filmat e saj vazhdojnë të frymëzojnë gjenerata të tëra, ndërsa kontributi i saj në humanizëm dhe bukuria e saj e përjetshme e bëjnë atë një figurë të paharrueshme. Në vitin 1999, Instituti Amerikan i Filmit e quajti atë legjendën e shtatë më të madhe të ekranit nga aktoret femra. Në një epokë ku yjet lindin dhe shuhet shpejt, Elizabeth Tejlor mbetet një simbol i pavdekshëm i artit, elegancës dhe forcës njerëzore. Një yll që nuk do të shuhet më.

NUMRI I ARDHSHËM MË 15 PRILL

HEJZA

31 Mars, 2025

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shalë

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000